

Revistë edukative-kulturore

# E T I K A

Shqipëri: 150 Lek  
Kosovë: 1 Euro  
Maqedoni: 60 Den  
Europa: 2 Euro

Janar 2011 • Numri: 34 • E përnuajshme



# Allahu Ekber



## EDITORIAL

*N*emi hyrë në vitin e gjashtë të revistës “**Etika**”. Këtë vit menduam ta fillojmë me thënien “*Allahu Ekber*”, pasi kjo punë bëhet vetëm me ndihmën e Tij.

Shprehja “*Allahu Ekber*” na pëshpëritet në vesh në çastin kur lindim, gjatë tërë jetës, si dhe kur vdesim. “*Allahu Ekber*” është shprehja që na shoqëron, që kur hapim sytë në agim e deri në fundin e një dite. Prej kësaj vetëdije fillon transformimi dhe përsosja e çdo komunikimi me Zotin, me veten, me njerëzit e me gjithësinë.

Në fakt, Allahu është i vetëm dhe nuk ka si të garojë me të tjerë në madhështi, mirëpo gjatë jetës së tij njeriu krijon lidhje të ngushta me shumë gjëra, të cilat pa dashur i bëhen atij zot. Njeriu përhumbet, prandaj atij shpesh i duhet kujtuar, se përmbi çdo gjë është Allahu, Ai që e meriton dashurinë, përkushtimin dhe gjithçka tonën.

Kur themi “*Allahu Ekber*”, shkëlmojmë idetë dhe imazhet që ne kemi ndërtuar për Zotin, si rrjedhojë shkëlmojmë egon tonë, e cila tenton të na ofrojë një gjendje relative e të mangët në lidhje me Të. Sado që njeriu të dijë për Zotin, nuk ka për të arritur kurrë ta shterrojë njohjen për Atë. Allahu është më i madh se gjithë çfarë mund të arrijmë të mendojmë për Të mes shumë e shumë përpjekjesh të pareshtura. Rruga për tek Ai nuk mbaron kurrë, për shkak të të qenit tonë relativë e të mangët dhe kënaqësia fshihet pikërisht në kërkimin e Tij të pafund.

Në terminologjinë fetare këtë shprehje e hasim të emërtuar edhe si tekbir. Tekbiri duhet bërë me fjalë, me vepra dhe me zemër. Tekbiret janë disa llojesh: *Tekbiri farz*, si ai i fillimit të namazit, *Tekbiri vaxhib*, si për shembull tekbiri që këndohet pas namazeve farz në ditën e arefesë, për të vazhduar deri në ikindinë e ditës së katërt të Bajramit të Kurbanit, *Tekbiri nafile*, si fjala vjen ai që bëhet gjatë dhikrit që pason namazin.


Në këtë numër i është bërë një trajtesë e përsosur konceptit të modestisë nga hirësia e tij, *Osman Nuri Topbash*. Modestia është një ndër rrugët më të sigurta që shpien tek Allahu i Lartmadhëruar. Pa modestinë njeriu nuk mundet ta thotë kurrë me plot zemër shprehjen “*Allahu Ekber*”. Pa dëbuar nga vetvetja mendjemadhësinë dhe pa përjetuar asgjësimin e shkrirjen në dashurinë për Allahun, të gjitha përpjekjet janë të vogla e të pamjaftueshme.

Me ndihmën e Zotit, revistës “*Etika*” i shtohet edhe një suplement që do të kënaqë zemrat e fëmijëve tuaj. E kemi titulluar “*Etika për fëmijë*” sepse dëshirojmë të komunikojmë më shumë me botën e tyre të pastër, me botën e tyre të gjallë plot ëndrra e pasion. Një revistë e tillë i ka munguar fëmijëve shqiptarë. Tek kjo revistë e re, fëmijët do të gjejnë gjithçka u ka munguar deri tani. “*Etika për fëmijë*” ka në brendësinë e saj rubrika nga më të larmishmet, si: poezi, lojëra zbavitëse, tregime fetare e letrare, gjëgjëza etj.

E gjithë kjo përpjekje bëhet për të fituar kënaqësinë e Allahut e për t’i shërbyer të gjitha shtresave të shoqërisë...

Puna prej nesh e suksesi nga Allahu i Lartmadhëruar.

# Do të lexoni:



**Metin Izeti /**  
Allahu Ekber

10



**Prof. Dr. Hasan Kamil Jëllmaz /**  
Tekbiri me fjalë me vepër dhe me zemër

16



**Ma. Gilman Kazazi /**  
Rreth përkthimeve të Kuranit

18



- Ahmet Tashgetiren /4** Allahu Ekber
- Ma. Abdylkadër Durguti /6** Shembulli i Muhammedit (a.s.) ndaj lirisë së mendimit
- Nexhat Ibrahimimi /8** Uniteti i diversitetit të manifestimit të dhuratës së Zotit
- Metin Izeti /10** Njeriu në prespektivën e metafizikën kuranore dhe antropologjia e përsipirtshmërisë islame
- /14** Sheb-i Arus  
Nata e dasmës
- /15** Sëndyku i moçëm i Nuri Beut
- Hasan Kamil Jëllmaz /16** Tekbiri me fjalë me vepër dhe me zemër
- Ma. Gilman Kazazi /18** Rreth përkthimeve të Kuranit
- Fatmir Hadri /22** Teubeja e vrasësit të 100 vetave

Viti: VI | Numri: 34 | Janar 2011

**Administrator i Progresi botime:**  
**Shuajip Bashhan**  
bashan43@hotmail.com  
+355 69 20 76768

**Drejtor & Kryeredaktor:**  
**Alban Kali**  
albankali@yahoo.com  
+355 69 24 23989

**Përkthyesit:**  
**Alban Kali / Albert Halili**  
**Elvira Puka / Elona Sytari / Evans Drishti**  
**Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha**

**Redaktor letrar:**  
**Shpëtim Kelmendi**  
**Redaktor gjuhësor:**  
**Ma. Irida Hoti**

**Dizajn - Grafik:**  
**Bledar Xama**  
bledar\_xama@hotmail.com

**Për artikuj**  
e-mail: revistaetika@progresibotime.com  
e-mail: kosova@progresibotime.com  
e-mail: maqedoni@progresibotime.com

# Janar 2011

32

*Osman Nuri Topbash /*  
Modestia



40

*Mr. sci. Flamur Sofiu /*  
Prerja e shtazëve dhe mishrat e lejuara



46

*Ma. Artur Tagani /*  
Teknologjia e fizikës



*Sadik Dana/24* Domosdoshmëria e heshtjes  
/ 25 Natyra e të nxënit

*Ma. Zymer Ramadani / 27* Allahu Ekber - Pse bëjmë gjynah?  
/ 30-31 Një ajet - një hadith

*Osman Nuri Topbash / 32* Modestia

*Mr. sci. Flamur Sofiu /40* Prerja e shtazëve dhe mishrat  
e lejuara në sheriatin Islam

*Imam Adem Pizga / 44* Si ta shfrytëzojmë kohën  
siç duhet

*Mr. Artur Tagani / 46* Teknologjia e fizikës  
/ 48 Ebu Mansur Maturidiu

*Mag. Ermal Nurja / 51* Raporti i Ahmet Xhevdet pashës  
mbi Shkodrën, drejtuar  
sulltan Abdulhamidit II

*Familja / 54* Luanesha mëmë

*Shëndeti / 56* Fara e zeze dhe dobitë e saj

*Teknologji / 57* Roboti ndihmës infermier

*Aktualitet / 58* Pa viza në Evropë

**PROGRESI**  
BOTIME  
www.progresibotime.com

**Adresa:**

**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi**  
**Shkodër / Albania**  
**Tel: +355 22 254 634**  
**Fax: +355 22 254 633**

**Zyra e përfaqësimit Maqedoni**

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25  
Shkup / Maqedoni  
+389 71 956 271

**Zyra e përfaqësimit Kosovë:**

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin  
Prizren / Kosovë  
Tel: +381 29 222 795  
Fax: +381 29 222 797  
+377 441 63 651

**Çmimi:**

**Shqipëri: 150 Lekë**

**Abonim (një vjetor): 1500 Lekë**  
**Kosovë: 1 Euro**

**Abonim (një vjetor): 10 Euro**  
**Maqedoni: 60 DEN**

**Abonim (një vjetor): 720 DEN**  
**Europë: 2 Euro**

**Abonim (një vjetor): 24 Euro**

الله أكبر

# Allahu Ekber

Ahmet Tashgetiren

**H**

orizonti i lindjes po zbardhet dhe një zë po përshkon qiellin:  
“**Allahu Ekber, Allahu Ekber !**”

Allahu është më i Madhi. Më Madhështori. Madhëria i takon vetëm Atij.

Çdo ditë zgjoheni dhe fërkoni sytë. Ai zë mbush zemrën tuaj.

Pastaj edhe dy herë: “**Allahu Ekber, Allahu Ekber!**”

Më pas, “**Eshhedu en la ilahe illallah!**” – Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut!

Pastaj, “**Eshhedu enne Muhammeden Rasulullah!**” – Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut!

Pastaj dy herë:

“**Hajje ales-salah !**” – Ejani në namaz!

“**Hajje alel-felah !**” – Ejani në shpëtim!

“**Esselatu hajrun minen-neum!**” – Namazi është më i mirë se gjumi!

Pastaj përsëri dy herë: **Allahu Ekber!**

Dhe në fund: “**La ilahe illallah!**”

- Çfarë është kjo thirrje?

- Ezani i sabahut.

- Po ç'është?

- Kjo është thirrje për rigjallërimin e zemrës së një myslimani...

- Zgjohu, hapi sytë ndaj botës dhe gjëja e parë që thua le të jetë kjo fjali: “**Allahu Ekber**”.

Zemra e myslimanit pastrohet pesë herë në ditë në këtë ujëvarë. Pesë herë në ditë e në intervale kohe të ndryshme, thirrjet “**Allahu Ekber**” mbushin zemrën e myslimanit. Namazi nuk mund të fillohet pa thënë “**Allahu Ekber**”.

Tekbiri i parë është i domosdoshëm (farz) në çdo namaz...

Rri i përqendruar me gjithë zemër nga kibleja dhe me vetëdije të lartë thuaj: “**Allahu Ekber**”. “**Allahu është më i Madhi!**” Do të vëresh se çdo gjë tjetër do të largohet përballë kësaj Madhësie.

Thënia “**Allahu Ekber**”, e thënë me zemër në fillim të namazit, është krijuesja e të gjithë atmosferës së namazit. Duhet të dish që namazi duhet të falet duke qenë krejtësisht i vetëdijshëm për konceptin “**Allahu Ekber**”. Edhe kijami (qëndrimi në këmbë), rukuja (përkulja), sexhdja (vënia e ballit në tokë), kiraati (leximi i Kuranit), ulja dhe ngritja në namaz do të realizohen me po të njëjtën vetëdije.

Gjatë pesë namazeve të një dite, së bashku me tesbihatin, thuhet 447 herë “**Allahu Ekber!**”. (222 herë gjatë namazit, 60 herë gjatë ezanit dhe ikametit dhe 165 herë gjatë tesbihatit).

Namazin e fillojmë duke thënë **“Allahu Ekber!”**, edhe kur bëjmë ruku, edhe kur biem në sexhde, edhe kur ngrihemi, përsërisim këtë thënie, pra: **“Allahu Ekber!”**.

Tekbirët që thuhën në namaz, nuk janë fjalë që disiplinonjë veprimet e ndryshme të namazit si: *“përkulu në ruku, vendose ballin në tokë, ngrihu në këmbë ose ulu”* etj.

Padyshim që nuk është dhe nuk ka si të jetë. Prandaj është e drejtë të mendojmë kështu: Të gjithë këto tekbiere thuhën për të shprehur Madhësitinë e Zotit në çdo pjesë të namazit, në çdo përkulje dhe ngritje, në çdo ulje dhe në çdo qëndrim në këmbë, pra, në çdo veprim.

Nëse do të qëndrosh në kijam, qëndro përpara më të Madhit, nëse do të përkulesh, përkulu më të Madhit, nëse dëshiron të thuash diçka, thuaja më të Madhit, madje më mirë thuaj fjalën e Tij, e nëse do ta vësh ballin në tokë, vëre përpara më të Madhit...

Mos harro kurrë se në namaz po qëndron përpara më të Madhit. Mos harro se po rigjallëron lidhjen me më të Madhin. Pesë herë në ditë rishiko veten në kontekstin e Madhësisë Hyjnore, bëhu i qëndrueshëm, peshoje dhe jetoje një përtëritje të dijes e të shpirtit në lidhje me Madhësitinë e më të Madhit...

Pra, Islami ka bërë ç’është e mundur për të parandaluar shthurjen e njeriut përballë **“fuqisë”**. Fuqia absolute i takon Allahut, ndërsa të gjitha pretendimet e tjera për fuqi janë relative dhe të dënuara të ndryshojnë e të shuhën.

**“Allahu Ekber”** do të përsëritet 447 herë në ditë dhe fuqia hyjnore do të rrënjohet thellë në palcën e njeriut. Këtu duhet të nënvizojmë një element të rëndësishëm: Në fjalën **“Allahu Ekber”** ndodhet edhe një kuptim **“nefj”** (refuzues, mohues) i njëjtë si tek fjalia **“La ilahe illallah”**. Tek Kelime-i Teuhid, kjo kuptohet në një mënyrë më të hapur. Pra, Kelime-i Teuhid fillon me një **“nefj”**, **“La ilahe”**: **“Nuk ka zot”**. Kjo do të thotë: Shiko miku im, pastroje mendjen tënde prej kërkimit të hyjnive. Pastroje, me qëllim që aty të hapet vendi për sundimin e një Fuqie Absolute.

**Nxirri, dëboji të huajt nga gjuha, që të shfaqet Haku,**

**Pa u zbukuruar shtëpia nuk hyn në saraj padishahu.**

Pastaj, thuaj menjëherë **“ilallah”** – **“Përveç Allahut”**. Njësoj si kjo, edhe **“Allahu Ekber – Allahu është më i Madhi”** fshin çdo lloj mundësie të madhësisë që formohet në spiralet e mendjes tonë dhe na orienton tek **“Më i Madhi”**. Gjithmonë tek **“Më i Madhi”**...

Dhe këtë e bën me aq këmbëngulje, saqë ju e kuptoni shumë mirë se kjo do të thotë **“ndërtim i vetëdijes”**. Le të jetë ky një **“ndërtim i kuptimit”**.

Shprehja **“Allahu Ekber”** le të rrënjohet në palcën e njeriut, le të depërtojë në spiralet e vetëdijes në mënyrë të

atillë, sa ta bëjë njeriun të qëndrueshëm ndaj çdo lloj fuqie me të cilën mund të përballet në tokë, që të mos i errësohet vetëdija e të mos rrëzohet në tokë.

Njeriu nuk duhet të vrapojë në hyjnizimin e asnjë krijese. Nëse përhumbet në atë lloj gjendjeje, le t’i dalë përpara si mur shprehja **“Allahu Ekber”**, në mënyrë që të shpëtojë prej humbjes duke u kapur pas tekbitit.

- Le të thotë: Çështjen time ia dorëzova Atij. U strehova tek Ai. Ai më mjafton.

- **Ja ejjuhel muddeththir. Kum fe endhir. Ue Rabbeke fekkebbir!** (El-Muddeththir, 1-3)

Kjo është një thirrje hyjnore drejtuar të Dërguarit të Allahut. Shpallja ishte ndërprerë për pak kohë, arsye për të cilën Resulullahu (a.s.) ishte hidhëruar. Ai ishte shqetësuar nga mendimi: **“Mos vallë Zoti im më braktisi?”**.

Dhe ja ku vjen Xhebraili me thirrje në ato çaste hidhërimi: **“O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje.”** (El-Muddeththir, 1-3)

**“Ma uddeake rabbuke ue ma kala...”** – **“Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)”** (Ed-Duha, 3)

Resulullahu ngrihet duke u mbështetur tek ajo fuqi absolute dhe ecën...

Madhështia absolute i takon vetëm Atij.

Ai është vendi i vetëm i strehimit.

Ai është ndihmuesi i vërtetë.

Vetëm Atij duhet t’i bëhemi rob.

Të gjitha fuqitë e tjera e marrin fuqinë prej Tij. Edhe Faraoni, i cili pretendonte se ishte zot, Atij ia ka borxh jetën.

Prandaj, ka ardhur koha që të rivendosim rregull në botën tonë të brendshme.

Prandaj, ka ardhur koha që të formatojmë përsëri botën e mendimit tonë.

Prandaj, ka ardhur koha që të rindërtojmë botën e sjelljes sonë.

Prandaj, ka ardhur koha që t’i bëjmë një rivlerësim kësaj bote dhe tjetrës.

Prandaj, ka ardhur koha që të kuptojmë me të vërtetë tekbinin që rrjedh në damarët e adhurimeve tona...

- **Allahu Ekber!**

- **Ai është më i Madhi!**

- **La ilahe illallah!**

- **Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!**

سُبْحَانَ اللَّهِ

# Shembulli i Muhamedit (a.s.) ndaj lirisë së mendimit

Ma. Abdylkadër Durguti

Muhamedi (a.s.) është shembull absolut në çdo problematikë të jetës së njeriut. Ai na paraqitet një model i shkëlqyer në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirisë së mendimit. Ai formoi një shoqëri demokratike ideale, ku individit nuk iu cënua asnjëherë dhe në asnjë lloj mënyre e drejta e të menduarit dhe e shprehjes së opinionit. Në lidhje me çështjet kolektive, Profeti (a.s.) nuk mori asnjëherë vendime në mënyrë individuale, por u konsultua me sahabet dhe duke çmuar çdo ide e mendim që jepej mbi bazën e përvojës së gjithsecilit. Ai i dëgjonte propozimet dhe mendimet e të pranishmëve. Në fund, respektohej mendimi që konsiderohej më i saktë. Ky është shkaku kryesor që Profeti (a.s.) e pati në mënyrë të plotë besimin e njerëzve, aq sa fitoi autoritetin në shoqëri për formimin e një shteti modern dhe të civilizuar.<sup>1</sup> Këshillimi me sahabet ishte dispozitë hyjnore, sipas së cilës besimtarët duhet të konsultohen me njëri - tjetrin për çështje kolektive.<sup>2</sup>

Sa i takon periudhës së Muhamedit (a.s.), liria e mendimit mund të vlerësohet nga dy pikëpamje: nga pikëpamja e shpalljes dhe jashtë saj.

Sa i përket çështjes së shpalljes, këtu bëjnë pjesë obligimet e myslimanit, të cilat duhen respektuar ashtu siç shpallen dhe për të cilat nuk ka vend për diskutime apo dhënie mendimesh. Në lidhje me këto mund të bëhen vetëm interpretime ose komentime. Kjo për shkak se pa-

rimet e moralit, besimit e të adhurimit janë caktuar në mënyrë specifike, me dispozita të prera. Por ama kjo nuk nënkupton cënimin e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, sepse urdhrat e prerë që bazohen në urtësinë hyjnore janë në dobi të njeriut e kurrresi në dëmin e tij.

Pika e dytë ka të bëjë me çështjet jo të shpallura dhe që lidhen me krijimtarinë e Profetit (a.s.) si qenie njerëzore. Ekzistojnë shembuj të ndryshëm ngjarjesh historike, ku Profeti (a.s.) iu jepte sahabeve mundësinë për t'u shprehur e për të dhënë opinionet e tyre:

1. Kur Profeti (a.s.) u shpërngul nga Meka për në Medine, ai vendosi të këshillohej me shokët në lidhje me gjetjen e një mjeti të përshtatshëm për t'i thirrur besimtarët në faljen e namazit. Mendimi i parë që u dha ishte ndezja e zjarrit, e më pas u dhanë mendime të tjera se si të veprohej me mjetet e Çifutëve apo Krishterëve për thirrjen e besimtarëve në faljen e namazit. Më pas, një nga të pranishmit tha se kishte parë në ëndërr një njeri që thërriste zë të lartë duke i ftuar besimtarët për të falur namazin. Ky propozim i pëlqeu Profetit (a.s.) dhe shumicës së të pranishmëve, prandaj edhe u mor në konsideratë.<sup>3</sup>

2. Gjatë fushatës së Bedrit, myslimanët u informuan se mushrikët e Mekës po marshonin drejt Medinës për t'i luftuar myslimanët. Me të dëgjuar lajmin, Profeti (a.s.) bëri thirrje për një takim me sahabet. Të gjithë së bashku do të

1. Yunus Vehbi Yavuz, *Islam'da Düşünce ve İnanç Özgürlüğü*, Stamboll f. 64-65.

2. Shura, 42/38.

3. Muhammed Hamidullah, *İslam Peygamberi*, II, 892.

diskutinin nëse do t'iu kundërviheshin mushrikëve sulmues, apo jo. Pasi sahabet shprehën mendimin e tyre, në fund u aprovua mendimi i shumicës, sipas të cilit ata do të përballeshin me sulmuesit idhujtarë të Mekës.<sup>4</sup>

3. Në betejën e Bedrit, Profeti (a.s.) dëshironte të arrinte tek uji para idhujtarëve të Mekës, për të zënë pozicionin pranë një pusi. Sahabiu Habbab b. Mundhiri nuk ishte i mendimit se ky vend ishte i përshtatshëm për pozicion luftarak. Mirëpo, para se të shprehte mendimin e tij, ai i drejtua Profetin (a.s.) me këto fjalë: “O i Dërguar i Allahut, ky mendim është personal apo është dispozitë e shpalljes”? Profeti (a.s.) iu përgjigj se ishte mendimi i tij personal dhe nuk kishte të bënte me ndonjë dispozitë të shpalljes. Vetëm atëherë sahabiu iu drejtua Profetit (a.s.) për t'i thënë se ai vend nuk ishte i përshtatshëm për pozicionim. Ai mendonte se duhej të pozicionoheshin sa më afër armikut. Më pas, Profeti (a.s.) veproi sipas mendimit të Habbabit, ndërsa mendimin e tij personal e tërhoqi<sup>5</sup>, sepse mendimi i Profetit (a.s.) ishte një mendim që buronte qenia e tij njerëzore dhe nuk qe bazuar në shpalljen apo në dispozitën hyjnore.

4. Profeti (a.s.) mori mendimin e shokëve të tij për mënyrën e trajtimit të robërve të luftës së Bedrit. Mënyra e të shprehurit ishte e lirë dhe demokratike. Ai që e mori fjalën i pari ishte Ebu Bekri, i cili tha se shumica e robërve të luftës janë pjesëtarë të familjeve myslimane, arsye për të cilën ata duhet të ndëshkohen në mënyrë ekonomike duke paguar tatim, pastaj të liroheshin. Omeri (r.a.) nuk u pajtua me mendimin e Ebu Bekrit, duke thënë se robërit e luftës duhet të vriteshin. Ndërsa Profeti (a.s.) përkrahu mendimin e Ebu Bekrit, sipas të cilit për robërit e luftës duhej vendosur kundërshtpërbllim, veçse jo në mënyrë ekonomike, por edukative. Që të mund të fitonin lirinë, ata duhej t'u mësonin shkrim e lexim fëmijëve të besimtarëve.<sup>6</sup>

5. Profeti (a.s.) është konsultuar me shokët e tij edhe para daljes në luftën e Uhudit. Shumica kishte mendimin që armiku duhej të përballohet në periferi të qytetit të Medinës, e jo brenda në qytet. Mirëpo, Profeti (a.s.) bashkë me disa shokë të tjerë ishin të mendimit se qyteti duhej të fortifikohesh në caqe të rëndësishme, ndërsa me armikun të përballeshin pranë qytetit ose brenda në qytet.<sup>7</sup> Pasi përfundoi lufta me disfatën e myslimanëve, ata që kishin këmbëngulur në këtë ide fajësuan veten e tyre, por Profeti

(a.s.) u distanca nga ky mendim, ngase ishte fjala vetëm për një strategji luftarake dhe nga ajo disfatë duhej të nxirreshin mësim.

6. Profeti (a.s.) u këshillua me shokët për strategjinë që duhej ndjekur gjatë luftës së Hendekut. Myslimanëve nuk u mjaftonte koha për forcimin e gjendjes së tyre dhe ata nuk ishin në gjendje as të përballeshin me armikun, sepse të gjithë jobesimtarët ishin bashkuar kundër myslimanëve dhe numri i tyre ishte shumë i lartë. Profeti (a.s.) u këshillua me shokët e tij dhe pas diskutimeve mendimi më i pëlqyer rezultoi ai i Selman Farisiut, i cili tha: “O i Dërguar i Allahut! Ne, në Persi, kur frikësoheshim nga sulmet dhe bastisjet e kalorësisë armike, hapnim hendeqe përreth vendbanimit”<sup>8</sup>.

7. Një rast tjetër që mund të përmendim, sa i takon lirisë e shprehjes së mendimit, lidhet me këshillimet gjatë fuqizimit të paktit të Hudejbijes. Kur myslimanët ishin të bllokuar të vizitonin Qaben në vitin e VI-të Hixhri, ata u detyruan të bënin një marrëveshje me idhujtarët e Mekës. Omeri (r.a.) ishte i pari që shprehu shqetësimin e tij për nenet e paktit. Meqenëse në aktin e marrëveshjes ishin fshirë shprehjet “Në emër të Allahut”, “i Dërguari i Allahut”, sipas transmetimeve Omeri (r.a.) iu drejtua Profetit (a.s.) me fjalët: “A nuk jemi ne në rrugë të drejtë e ata në të gabuarën?”, “A nuk je ti i Dërguar i Allahut?”, “Përse atëherë të bëjmë kompromis në fe?”.

Profeti (a.s.) iu përgjigj: “Unë jam i Dërguar i Allahut, nuk mund t'i dal kundër Atij! Ai është ndihmësi im!”<sup>9</sup> Nga kjo vërehet se Omeri (r.a.) e shprehu mendimin e tij pa hezitim pranë Profetit (a.s.). Në fakt, kjo mënyrë të shprehuri e Omerit (r.a.) rrjedh nga liria e mendimit dhe e shprehjes që Profeti (a.s.) nxiste te shokët e tij.<sup>10</sup>

8. Ishte përsëri Omeri (r.a.) ai që shprehu mendimin e tij të lirë e të guximshëm edhe ndaj faljes së namazit të xhenazes së mynafikut Abdullah b. Ubejit, mendim i cili nuk përkonte me atë të Profetit (a.s.). Kjo situatë u krijua pasi i biri i Abdullahut erdhi duke u lutur për faljen e namazit të xhenazes së të atit.

Këto janë vetëm disa nga shembujt që nxjerrin në pah qëndrimin e Profetit (a.s.) në lidhje me lirinë e mendimit. Mund të thuhet se në shumicën e rasteve Profeti (a.s.) kërkonte edhe mendimin e shokëve të tjerë, me përjashtim të rasteve kur ishte fjala për shpalljen e ndonjë dispozite të shariatit. Liria e mendimit dhe e shprehjes është zbatuar nga Profeti (a.s.) rreth çështjeve të kësaj bote.

4. Ibn Hisham, *es-Siretu'n-Nebevije*, II, 233; Muhammed Hamidullah, *Islam Peygamberi*, II, 892.

5. Ibn Hisham, *es-Siretu'n-Nebevije*, II, 238.

6. Ibn Kajjim el-Cevzi, *Zadu'l-Mead*, II, 67; Muhammed Hamidullah, *Islam Peygamberi*, II, 893; Ahmet Özel, *Islam Devletler Hukukunda Savaş Esirleri*, f. 31-37.

7. Ibn Hisham, III, 58; Muhammed Hamidullah, *Islam Peygamberi*, II, 892-893.

8. Ibn Hisham, III, 231.

9. Muhammed Hamidullah, *Islam Peygamberi*, II, 893.

10. Ibn Hisham, III, 291.





# Uniteti i diversitetit të manifestimit të dhuratës së Zotit

Nexhat Ibrahim

**D**iversiteti është shumëllojshmëri, ndërsa shumëllojshmëria është ndryshim. Kur është fjala për njerëzit kemi të bëjmë me ndryshim mentalitetesh, kulturash, edukimesh. Kur është fjala për bimët kemi të bëjmë me ndryshim gjatësisht, ngjyrash e aromash. Kur është fjala për kafshët dhe shpendët kemi të bëjmë me ndryshim formash e funksionesh. Impoinimi i diversiteteve çon në kaos e shkatërrim, ndërsa ofrimi i diversiteteve si pasuri përbën formësimin e plotë të mozaiikut. Kopshti më i bukur s'është ai i njëtrajtshmi, me vetëm një lloj luleje, por ai që është i mbushur plot lule me ngjyra, me aroma e me madhësi të ndryshme. Një shembull të tillë duhet të ndjekin edhe njerëzit. Vetëm bashkimi sjell integritet e vëllazëri. Ndarja sjell varfëri, izolim, nënshtrim dhe shkatërrim. Një frymë të tillë na përcjell edhe ajeti kuranor:

*“Vallë, a nuk e sheh ti se si Allahu e lëshon ujin prej qiellit dhe nëpërmjet tij krijon fruta llojesh e ngjyrash të ndryshme?! Nëpër male gjenden shtigje të bardha dhe të kuqe, ngjyrash të ndryshme dhe krejtësisht të zeza. Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”<sup>1</sup> (Fatir, 27-28)*

## DIVERSITETI I DEKORIT TOKËSOR

Allahu i Madhërishtëm e lëshon (e zbret) ujin, bekimin e Tij nga qielli në Tokë. Uji mbulon sipërfaqen e tokës, por depërton edhe në thellësinë e saj. Nga ana tjetër, toka ia kthen

1. Shih: Muhammed El-Gazali, Komenti tematik i Kur'anit famëlartë, Shkup, 2007, f. 427.

dhuratën qiellit me tërë dashurinë e mundshme. Kjo dhuratë e kthyer manifestohet në bimë e lule të ndryshme, në ngjyra e aroma të shumta, në fruta e në plot dobi të tjera, – të gjitha nga një burim – dhuratë e Krijuesit të Lartësuar.

Ndonëse kanë të njëjtën nënë, tokën, disa filiza janë me ngjyrë të bardhë e disa me të zezë, disa me të kuqe e disa me të gjelbër, disa me të verdhë e disa me të kuqe, disa violetë e disa bojë hiri. Po ashtu edhe lëngu i tyre është i ndryshëm, pavarësisht se të gjitha bimët ushqehen nga një nënë e përbashkët: disa kanë lëng të trashë, disa të hollë, disa të ftohtë e disa të ngrohtë; disa lëngje shërojnë, disa jo, disa janë të ëmbël, disa të hidhët, disa të thartë e disa pa ndonjë shije të caktuar.<sup>2</sup>

*“E në tokë ka copa sipërfaqesh, të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte hardhish, të mbjella (të llojlojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe në shijen e frutave të tyre e kemi dalluar njërin prej tjetrit. Edhe kjo dëshmon për argumente për njerëzit e mençur.”* (Er-Rra'd, 4)

Krijimi i Allahut, ndonëse nëpërmjet së njëjtës nënë - tokës – ka qaq shumë llojlojshmëri, por në të njëjtën kohë tërë kjo llojlojshmëri sjell po aq unitet. Ato përbëjnë një pamje të mrekullueshme, një tërësi të jashtëzakonshme dhe një shkollë tejet udhëzuese: gjithë ky diversitet në botën e bimëve i shërben një uniteti madhështor që do të duhej të ekzistonte edhe mes njerëzve.<sup>3</sup>

2. Shih: [http://www.znaci.com/razumijevanje/art118\\_0.html](http://www.znaci.com/razumijevanje/art118_0.html).

3. Shih: Muhammed El-Gazali, Komenti tematik i Kur'anit famëlartë, Shkup, 2007, fq. 243.

## DIVERSITETI I PËRJETIMIT TË BESIMTARËVE

Në ajetin e cituar në fillim të tekstit nuk është përmendur rastësisht diversiteti njerëzor krahas atij bimor e shtazor, krahas atij të natyrës dhe dukurive të tjera që ekzistojnë në këtë univers. Ashtu si dhuron toka bimë me ngjyra e aromë të ndryshme, me gjatësi e fruta të ndryshme, e njëjta gjë ndodh edhe te njeriu: frymëzuar nga Shpallja, kemi njerëz me aftësi të ndryshme perceptimi, njohjeje, komunikimi dhe depërtimi.

Për shembull, për Ibn Abbasin shokët e tij kanë thënë se e kuptonte aq mirë thelbin e Shpalljes, sa që i mahniste të pranishmit: “Kur i lexohej ndonjë ajet, na shpjegonte si të shikonte në Pllakën e Ruajtur Mirë (Levhi Mahfudh)”.

Nga ana tjetër, ka disa njerëz sikurse beduini, i cili pati pyetur Muhamedin (a.s.) : “Nëse besoj në Zotin, melekët e Tij, librat e Tij, peygamberët e Tij, në Ditën Fundit dhe çdo gjë që më godet, e keqe apo e mirë, është nga Zoti; nëse e theksoj shehade-tin, e fali namazin, e ndaj zekatin, e agjëroj muajin ramazan dhe e kryej haxhin, dhe tërë kësaj nuk i mungoj e as nuk i pakësoj diçka, cili është fundi im?” Peygamberi (a.s.) iu përgjigj: “Ti je nga të shpëtuarit.”

Shembujt e sipërm tregojnë se diversiteti ekziston mirëpo ky fenomen nuk paraqet ndonjë problem para Krijuesit. Kushdo që i përmbahet këtyre kushteve të imanit dhe të islamit, ai njeri do të jetë në anën e të shpëtuarve.

Njeriu, edhe pse i lindur me natyrë të pastër (fitreh / islam), për shkak të rrethanave të ngatërruara në shoqëri sikur po e humb karakterin e tij burimor (fitreh). Kështu, duke mos u angazhuar në perceptimin e plotë të begative ai po shndërrohet në person të verbër. Ata e kanë të qartë se unite-ti mysliman, ndihma dhe mirëkuptimi i ndërsjellë është detyrim, por shpesh u shmangen detyrimeve të tyre dhe sillen në pajtim me ajetin kuranor:

“...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë, por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” (El-Haxhxh, 46).

Duke pasuar Udhëzimin si kriter, çdo person bën pjesë ose në jobesimtarët ose në besimtarët; ose në ata që shohin, ose në ata që nuk shohin. Diversiteti i mendimeve nuk është çështje individi, por çështje e dhuratës që Zoti i ka dhënë njeriut, që njeriu të mund të meditojë, të analizojë dhe në fund të nxjerrë përfundime. Gabimi nuk është pjesë e kësaj dhurate, apo e kësaj lirie mendimi, por qëndron në jokorrektësinë e perceptimit të ndonjë individi.<sup>4</sup>

## DEVOTSHMËRIA, SI KRITERI BAZË I NJERËZVE

Diversiteti i natyrave njerëzore është i drejtuar nëpërmjet hierarkisë cilësore në llojit të veçantë. Kjo hierarki konsiston në përparësitë e disa personave ndaj disa të tjerëve, mbi bazën e dallimeve reciproke sipas devotshmërisë. Kjo bën që në Tokë të kemi rend dhe manifestimin historik të mëvetë-

sisë së çdo njeriu. Për këtë arsye është thënë se nga të gjitha krijesat e Tij, Allahut i frikësohen të diturit. Kjo, sepse të diturit zotërojnë dijen e vetëdijen për fuqinë dhe madhësinë e Allahut. Njerëzit e ditur e besojnë më së shumti dhe më së miri Ditën e Gjykimit. Se kush janë të ditur, për këtë flet Ibn Abbasi, i cili thotë se janë “Ata, të cilët e dinë se Allahu është mbi çdo gjë” (enna’Il-llah e ala kul-li shej’in kadir).

### Kush janë ata “të ditur”?

Përgjigjen në lidhje me këtë pyetje na e jep Kurani:

“Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë. Allahu do t’ua plotësojë atyre shpërblimin dhe do t’ua shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Falënderues.” (Fatir, 29-30).

Në kontekstin e trajtimit tonë, do të themi se myslimanët duhen çmuar sipas besimit dhe veprimeve të tyre, në pajtim me kushtet imano-islame, e gjithashtu duhet të vlerësohen sipas devotshmërisë së tyre. Duhet hequr dorë nga deklaratat dhe shpalljet e urrejtjes ndaj tjetrit. Akuzat vehabiste kundër gjithë të tjerëve (hanefinjve, esh’arinjve, sufijnjve), të shi’itëve kundër sunitëve dhe anasjelltas, e të tjera, kryesisht pa argumente dhe plot me patetizëm e patriotizëm, janë she-një e adoleshencës dhe papjekurisë sonë. Jam i mendimit që secili grup duhet të flasë për vetveten e jo për tjetrin dhe secili të flasë në suazë të akaidit dhe sheriatit. Zemrat tona do të vlerësojnë dhe çmojnë çdo vlerë të mirëfilltë. Këta janë të ditur, e jo ata që përplasen, ata që sulmojnë, apo ata që anatemojnë dhe hartojnë lista heretikësh për ekzekutim.

Lidhur me këtë çështje, Ebu Hanife pohon të ketë dëgjuar Vathile ibni El-Eska’a (r.a.), i cili pati deklaruar se e kish dëgjuar Peygamberin (a.s.) të thoshte: “Mos i shpalos të metat e vëllait tënd. Është e mundur që Allahu ta falë atë, e ty të të vejë në provë”.<sup>5</sup>

Ibn Kethiri shënon se Ibn Mes’udi ka thënë:

“Dija nuk qëndron në njohjen e numrit të madh të haditheve, por në madhësinë e devotshmërisë.” (Ibn Kethir, Tefsir’ul-Kur’an’il-adhim, vëll. III, 730.)

Maliku i ditur ka thënë po ashtu:

“Dija nuk qëndron në njohjen e shumë transmetimeve. Dija është dritë që Allahu e vendos në zemër.”

Prandaj, le ta lejojmë Dritën t’i ndriçojë shpirtat tanë, që t’i mbushë me prehje zemrat tona. Le të dalim nga errësira e arbitraritetit që na largon nga myslimanët e edukuar tradicionalisht ndryshe. Ky mesazh në rrafshin praktik synon pajtimin e grupimeve myslimane. Ky mesazh nuk synon përjashtimin e të tjerëve, nuk synon rrënimin e atyre “ndryshe”, por synon të nxjerrë në pah gabimet, lajthitjet dhe mëkatet që nuk kanë të bëjnë me traditën islame dhe Islamin. Ky mesazh synon shtrirjen e dashurisë për të vërtetën dhe këmbënguljen në shtyllat e të vërtetës.<sup>6</sup>

5. Musnedi i Imam Ebu Hanifes, Prishtinë, 2009, fq. 91.

6. Shih: [http://www.znaci.com/razumijevanje/art118\\_0.html](http://www.znaci.com/razumijevanje/art118_0.html).

4. Shih: [http://www.znaci.com/razumijevanje/art118\\_0.html](http://www.znaci.com/razumijevanje/art118_0.html).



# NJERIU NË PERSPEKTIVËN E METAFIZIKËS KURANORE DHE ANTROPOLOGJIA E PËRSHPIRTSHMËRISË ISLAME

Metin Izeti

Lum zemra që nuk vrapon pas asaj  
që shohin sytë  
E s' shkon kudo që e thërrasin  
pa menduar fare.

H afiz Shirazi

**P**ërfaqësimi i një projekti përmbajtësor apo i një rrjeti qenësor për jetën e njeriut në tërësi, është diçka e domosdoshme, e cila bën që baza e tij të përqendrohet në përmasën ontologjike dhe esenciale. Përqendrimi i njeriut në një burim të caktuar mundëson formësimin e sistemit të vlerave të tij si individ apo si pjesëtar i grupit. Për rrjedhojë, vlerësimi i njeriut si qenie vetëm biologjike, pastërtisht lëndore, e shndërroi atë në qenie të papërkufizuar, pasi asgjësoi përpjekjen e kuptimit të realitetit tej lëndor që ndjente dhe përjetonte në mënyrë të pandërprerë. Një qasje e tillë e minimizoi njeriun,

duke e shndërruar në një mizë që është gati të futet në çdo vend, vetëm e vetëm për të jetuar orët e ekzistencës së saj të shkurtër.

Njeriu nuk është qenie e fshirë dhe e hedhur në arenën ekzistenciale, por përkundrazi është një transformator që e ka racionalizuar dhe e ka bërë të kapshme gjendjen e papërkufizuar e të paqartë. Si rrjedhojë, njeriu e ka bërë botën të kuptueshme. Për këtë arsye, me fundin e njeriut në këtë botë përfundon edhe jeta e botës në tërësi. Në elementet përmbajtëse dhe përfaqësuese të gjithësisë, që të mund të flitet për ekzistencën në përgjithësi duhet të ekzistojë njeriu. Nëse do ta kishim shprehur në gjuhën e teozofisë islame (irfan, marifet), do të thonim se njeriu është qenie që me veten e në vete ka kristalizuar bashkimin e botës së idesë dhe të formës.<sup>1</sup>

Njeriu dhe historia e tij vertikale e horizontale, gjegjësisht ajo e zbritjes së tij vertikale prej Zotit dhe e shtrirjes në relievin ekzistencial, është një pasqyrë e përfaqësimit të asaj që ekziston jashtë vetes së tij. Me praninë

1. Demirli, Ekrem, *Islam Metafiziginde Tanri ve Islam*, Istanbul, 2009, f. 246.

e tij, njeriu e bën të zëshëm heshtjen e ekzistencës në gjithësi, por njëkohësisht i jep zë edhe ekzistencës së Zotit. Do të thotë që qëllimi i krijimit të njeriut është përkushtimi dhe njohja e Fuqisë Krijuese dhe Edukuese të gjithësisë, në kuadër të shfrytëzimit të begatave që i janë dhënë në dorëzim.<sup>2</sup>

Kelamisti i njohur islam, Imam Maturidiu thotë: “Gjithësia është e përbërë prej elementeve që kundërshtohen dhe dallohen nga njëra-tjetra. Njeriu, i cili është emërtuar si mikrokozmos, bashkon ato që duhen bashkuar dhe ndan ato që duhen ndarë në qenien e tij”. Sipas vlerësimit të Imam Maturidiut, njeriu është përkufizuar si qenie që formëson një botë të kuptuar, krahas kundërshtive dhe dallimeve. Me këtë, Maturidiu ka koncentruar në një vend të vetëm elementet e vlerësimeve të shumta që i janë bërë njeriut nga ana e dijetarëve të ndryshëm. Njeriu është qenia e vetme që mendon dhe ka mundësi, që nëpërmjet gjuhës ta ndajë ose t’ua përcjellë të tjerëve mendimin e tij. Si rrjedhojë, njeriu është një qenie që ka mundësi të përkufizojë dhe përkufizimi është elementi që e bën atë njeri.

Një vlerësim i tillë i njeriut në historinë e mendimit islam, fillon të bëhet që nga momenti i përfaqësimit të dijes hyjnore në personalitetin e Ademit (a.s.) , në çastin kur ai doli në arenën paraiskonike me urdhërin e Zotit, dhe para melekëve i emërtoi, ose thënë ndryshe i konceptoi, i bëri të kuptimshme sendet e prezantuara. Si rrjedhojë, mund të themi se, meqenëse ka aftësi t’i dijë emrat, “konceptet”, njeriu ka mundësi t’i përkufizojë gjërat dhe të thellohet në njohjen e realitetit të tyre, arsye për të cilën është emërtuar edhe si halife (mekëmbës) i Zotit në faqen e dheut.

Me një qasje të tillë, Islami dhe Kurani e lidhin bazën e njeriut me një rrënjë të sigurt që mbin nga Fuqia Krijuese, por në të njëjtën kohë e bën atë shkak bazë për njohjen dhe dijen e koncepteve dhe gjërave në ekzistencë. Në lidhje me këtë çështje Kurani thotë kështu:

**Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë”, ata thanë: “A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e**

2. Kjo përmasë e vendzënies në arenën e qenësisë nga ana e njeriut, është subjekt dhe temë diskutimi e veprës së njohur të dijetarit dhe sufiut të madh të historisë së mendimit islam, Muhjuddin Ibn Arabiut. Në lidhje me perlat e urtisë dhe komentit të tyre, shiko: Abdullah Efendija Bosnjak, *Tumacenje Dragulja Poslanicke Mudrosti*, përkthet nga arabishtja në boshnjakishte: Prof. Dr. Resid Hafizovic, Sarajevë 2008.



**do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini”. Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve dhe u tha: “Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” “Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.” “O Adem, - tha Ai - ua trego atyre emrat e gjërave!” Kur ai ua tregoi emrat e tyre, Allahu tha: “A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiellit e të Tokës dhe vetëm Unë e di çfarë tregoni hap-tazi dhe çfarë fshihni?!” (Bekare,2:30-33)**

Në tekstin e mësipërm, Allahu (xh.sh.) dhe krijimi si proces janë të vendosur në linjë të drejtë. Si rrjedhojë, dija dhe urtia (ilmi dhe hikmeti) janë dy dyert nëpërmjet të cilave njeriu ka mundësi ta ndjejë veten në qendër të ekzistencës dhe vetëm nëpërmjet tyre të mund të përfitojë aftësinë e kuptimit të përmasës së vërtetë të përkuljes ndaj Fuqisë Krijuese. Dhe është kështu ngaqë Emri i Allahut dhe përfaqësimet e Fuqisë Krijuese na hapin dyert e dijes e të urtisë dhe na e kujtojnë në çdo



çast se dija dhe urtia e kanë fillesën në atributet hyjnore. Pikërisht për këtë arsye, përgjigjja e drejtë e pyetjes në lidhje me qëllimin e krijimit të njeriut, është përkushtimi ndaj Allahut, pranimi i Realitetit të Përjetshëm, ndjenja për ekzistencën e Tij, emocionimi me afërsinë e Tij...

Nga njëra anë, një vetëdije dhe një pranim i tillë e mban Unin njerëzor shumë afër Allahut, ndërsa nga ana tjetër i mundëson që ta dallojë përmasën relative të qenësisë së njeriut. Në këtë përmasë, krijesa e ndjen Krijuesin më afër se ekzistencën individuale. Ai ndjen se Njëshi Absolut ka vend në mënyrë të drejtpërdrejtë në qenësinë e tij. Kjo është një afërsi pa distancë, por me një dallim të qartë mes krijesës dhe Krijuesit. Ose, thënë me gjuhën e Kuranit: “ *Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç’pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (që rrah) i qafës së tij.*” (Kaf,50:16)

Nëpërmjet këtij ajeti, Allahu i Lartmadhëruar e përcakton realitetin e përbotshëm dhe nduarsinë e tij me njohjen e Qenies Absolute. Çështja e realitetit është e li-

dhur ngushtë me çështjen e njohjes së Qenies dhe anasjelltas, sepse njohja e qenies inkuadron automatikisht edhe problemin e realitetit të qenies. Siç thotë edhe Ibn Arabiu, nuk mund të konceptohet e as të vërtetohet realiteti i ekzistencës, nëse nuk tejkalohet pika ku shndrit realiteti i Qenies që ndriçon çdo arsye dhe çdo qenie relative, nëse në aktin e të menduarit nuk përfshihet çdo hollësi që ndërlihet me Qenien.<sup>3</sup>

Në pjesën e *Fususul-Hikem’it*, kur flet për logosin (kelimen) e Ademit (a.s.), që njëkohësisht përfaqëson edhe gjininë njerëzore, sikundër shënon edhe Abdullah Bosneviu në komentin e kësaj vepre, Ibn Arabiu thotë: Në perlën e logosit të Ademit përfaqësohen dy kuptime të rëndësishme: e para është perla e urtisë hyjnore, e cila në logosin e Ademit është vatëruar në zemrën e Ademit si vend i gdhendjes së urtisë hyjnore, pasi në platformën shpirtërore Njeriu i përsosur është Vula, ndërsa zemra e tij është perla e kësaj vule. Ibn Arabiu e përmend logosin me qëllim që të përkujtojë zemrën si vend i gdhendjes së kësaj urtie. Kuptimi i dytë përqendrohet në faktin se Ademi (a.s.), gjegjësisht njeriu, paraqet objektin ku është gdhendur perla e urtisë hyjnore. Si rrjedhojë, në përmasën shpirtërore Ademi (a.s.) është në pozitën e perlës, ndërsa gjithësia në përmasën shpirtërore të Vulës, ndaj pikërisht për këtë gjithësia është e vulosur me qenësinë njerëzore. Ademi (a.s.) është për botën ashtu siç është perla për vulën.<sup>4</sup>

Sipas kësaj që u tha, njeriu është qenia e vetme, e cila në një kontekst është masë e realitetit të dhënë; ai është i aftë të zbulojë rrjedhën e këtij realiteti. Mirëpo, që të pranohet një realitet dhe të lejohet ekzistimi i tij ashtu siç është në të vërtetë, duhet që së pari të përqendrohemi në atë se çka ai është përnjëmend, jo në atë çka ne dëshirojmë të jetë. Ibn Arabiu, e në tërësi koncepti kuranor mbi realitetin dhe njohjen e saj nga ana e njeriut, priret të theksojë njësinë e realitetit e të qenies, dhe jo ndarjen e dallimin e tyre në njohje. Për Ibn Arabiun, realiteti dhe qenia ecin bashkë, të pandarë, sepse nuk ka realitet nëse nuk ka qenie.

Tradita bazë e tesavvufit islam e konsideron njeriun si objekt të vetëm të përfaqësimit dhe reflektimit të In-

3. Krahaso : Lasic, Hrvoje, *Covjek u Svjetlu Transcedencije & Nadnaravno odredjenje ljudskog Bica*, Zagreb, 1994. Fq. 45-74.

4. Bosnjak, Abdullah, *Tumacenja Dragulja Poslanicke Mudrosti*, f. 209.

telegjencës primare. Përderisa disiplinat e tjera islame janë të vatëruara më tepër në librin e gjithësisë, gjegjësisht në makrokozmosin dhe në traditën e përhershme të shkruar, qoftë në zbulesën hyjnore apo në porositë themelore fetare të Pejgamberit (a.s.) , tesavvuft islam është përqendruar më tepër në njeriun dhe në ndërtimin e tij lëndor e metafizik si pranues dhe transformator i zbulesës dhe gjithësisë. Në vazhden e traditës së tesavvufit, njeriu është mikrokozmos dhe zberthimi i të panjohurit, njeriut, përbën sukses në rrugën drejt Krijuesit dhe Ekzistencës së vetme reale.

Një prej poetëve të njohur sufi të periudhës osmane, Nijazi Misriu e ka shprehur shumë bukur dhe qartë këtë përmasë të kuptimit të ekzistencës reale dhe qasjes ndaj nëpërmjet transformatorit të vetëm të fjalës dhe të ngjarjes, gjegjësisht njeriut. Ja si e shpreh ai këtë realitet:

*Derman i kërkova dertit tim,  
derti qenka derman për mua  
Provë i lypa origjinës sime,  
origjina qenka provë për mua  
Vështrova djathtas e majtas,  
fytyrën desha t'ia shoh të dashurit  
Unë e kërkova larg në provinca,  
Ai qenka shpirt brenda shpirtit.  
Mendoja që jam i ndarë,  
i dashuri tjetër e unë tjetër  
Mësova që ajo që shihet e dëgjohet prej meje,  
qenka i Dashuri e asgjë tjetër.  
Nga gjaku të vjen rruga,  
në gjak ke vendstrehimin  
Kafshë është ai që nuk kupton vendin e ardhjes  
dhe të vajturit.  
Dëgjo fjalën e Nijaziut,  
lënda nuk e mbulon fytyrën e Hakkut  
S'ka lëndë më të qartë se Realiteti,  
ndërsa për të verbrit është sekret.*

Njohja reale e metafizikës së njeriut nga vetë individi, e lidh njeriun me rrënjët e tij dhe nëpërmjet të tyre me Zotin, pra e bashkon gjegjësisht me realitetin e përjetshëm e të pafundmë. Kjo energji e dëshirës dhe dashurisë ndaj Krijuesit, që përvijohet nëpërmjet metafizikës

individuale njerëzore, është shumë e fuqishme e përfshirëse deri te Zoti, që është përtej kohës e hapësirës dhe mund të arrihet vetëm nëpërmjet kësaj përmase. Ky emocionim ekzistencial, ky vlim i vetëdijes dhe ky kurorezim i inteligjencës që është i përfaqësuar në përjetësinë dhe esencën e ekzistencës nëpërmjet njeriut, mbush edhe kohën edhe hapësirën. Ose thënë ndryshe, çdo gjë në këtë botë formësohet dhe përfiton domethënie përrreth njeriut.

Nëse ka dëshirë të vendosë unin dhe mëvetësinë e tij, njeriu duhet ta ngrohë shpirtin e tij, i cili në përmasën e tij lëndore rrezikon shpesh të ngrijë. Për këtë, njeriu duhet të niset prej arsyes drejt dashurisë, prej lëndës drejt kuptimit, prej shkencës së ngushtë drejt poezisë metafizike. Si rrjedhojë, ai ka mundësi të vendosë harmoninë e tërësisë së realiteteve të dukshmërisë dhe përshtatshmërisë.

Në Preludin e veprës së tij madhështore *Mesnevi*, Mevlana Xhelaluddin Rumi flet për këtë origjinë të njeriut. Në bisedën e naj'it ai përqsas vajin e shpirtit të njeriut me mallin për kthimin në vatanin e tij të vërtetë. Ja si thotë Mevlana:

*Vërja veshin këtij naji si vajton,  
Melodi e tij për ndarjet tregon.  
Qysh kur më prenë nga kallamishtja,  
Të prekur qajnë për mua burra e gra!  
Veç zemra e bërë nga ndarjet copë-copë  
Vojtjen e dëshirës mund ta thotë!  
Kush largohet nga vatani larg,  
Kërkon të kthehet e ta shohë prapë.  
Qava e rënkova gjithë për të tjerë,  
Ndenja bashkë me të këqij e të mirë.  
Gjithkush m' u bë mik siç e mendoj,  
Por askush s' ma pyeti brengën, s' ma kuptoi.  
Sado e fshehta ime vetë të vajtojë,  
Jo çdo sy e vesh mund ta dallojë.  
Trupi nga shpirti, s' është i fshehtë,  
Por askush s' mund ta shohë shpirtin e vet.<sup>5</sup>*

*vijon numrin tjetër...*

5. Rumi, Mevlana Xhelaleddin, *Mesnevi*, shqipëroi Mithat Hoxha, I, Shkup 2010.

# Sheb-i Arus

## Nata e dasmës

“Vdekja është lindje në botën e vërtetë”

Kanë kaluar 737 vjet që kur Mevlana (Xhelaledin Rumi) ka ndërruar jetë. Në përvjetorin e tij të vdekjes që përkon me datën 17 Dhjetor, edhe në qytetin e Konjës, edhe në të gjithë Turqinë, por edhe në çdo cep të botës, u përkujtua kjo ditë e cila ndryshe nga përvjetorët e vdekjeve që zhvillohen në çdo popull dhe çdo kulturë, konsiderohet si ditë feste. Në asnjë vend të botës vdekja e dikujt nuk festohet në këtë mënyrë, me muzikë dhe hare. Dhe për më tepër askush nuk e konsideron vdekjen e dikujt si “Sheb-i Arus” që do të thotë “Nata e dasmës, Nata e takimit të të dashuruarve”.

Ja pra, kjo është ajo që e bën Mevlanën të ndryshëm dhe unik. Ai ishte një njeri i cili jetoi me dëshirën e madhe për t’u takuar me Allahun e Madhëruar të cilin e ka konsideruar gjithmonë si Mikun dhe të Dashurin e vërtetë dhe të përjetshëm. Ai kurrë nuk ka pranuar të jetë i ndarë prej Allahut, jeta e tij përbëhej vetëm prej Tij dhe këtë botë e konsideronte si një vend internimi. Në kohën kur ishte në prag të takimit me të Dashurin e tij, ai kërkoi që askush të mos derdhte lot për të, por përkundrazi të përcillej për në banesën e fundit me gëzim të madh, me muzikë dhe sema.

Mevlana Xhelaledin Rumi lindi më 6 Rabiulevel 604 (30 shtator 1207) në qytetin Belh brenda kufinjve të Afganistanit të sotëm dhe u bashkua me të Dashurin e tij kur ishte qytetin e Konjës në Turqi në vitin 672 Hixhri, në të dielën e pestë të muajit Xhemadijel-Ahire, pra në 17 Dhjetor 1273. Jetoi 66 vjet në këtë botë të përkohshme, por i dashuruar me zemër në Dashurinë e përherëshme... Ishte dijetar, teolog, filozof, mistik dhe në veçanti poet i veçant, poet i zemrës.

*Përmes dashurisë gjithçka që është e hidhur, dëshmohet*

*se do të ëmbëlsohet.*

*Përmes dashurisë gjithçka që është bakër i thatë do të bëhet dukat.*

*Përmes dashurisë gjithçka që është llum, fundërrinë do të shndërrohet në venë të kthjelltë që ruan pastërtinë.*

*Përmes dashurisë të gjitha dhembjet që sjellin vështirësi do të kthehen në ilaçe, që sjellin lehtësi.*

*Përmes dashurisë të vdekurit do të ngjallen.*

*Përmes dashurisë mbreti do të bëhet shërbëtor i njerëzisë...*

Me mënyrën e jetesës së tij, Mevlana na paraqet shembullin e një miku të Allahut (veli). Nga jeta e tij kuptojmë se miqësia e vërtetë me Allahun (velajeti) nuk është e ndarë nga dashuria. Në fakt dashuria nuk ka qenë asnjëherë e shkëputur prej bukurive hyjnore, prej përkushtimit në Islam e as prej udhëzimit të saktë. Pasuria e tij e thellë dhe shpirti i

pastër, do ua largojë urinë udhëtarëve të kësaj udhe dhe do ua zbukurojë jetën e tyre shpirtërore. Mevlana në poezit e tija thotë:

*Unë jam Shërbëtor i të Madhërueshmit Kuran, derisa shpirt kam.*

*Unë jam pluhur nën këmbët e Muhamedit Alejhiselam...*

Mevlana vazhdimisht i tërheq vëmendjen, i bën vërejtje njerëzve, që të mos jetojnë si një makineri, të mos bëjnë pazar me Allahun. Nëse nuk jemi të pasionuar pas bukurisë së Allahut, nuk mund ta realizojmë kaderin tonë, s'mund të arrijmë në gradat e pastërtisë, ndriçimit shpirtëror dhe dashurisë. Nëse nuk do jemi kuësharë dhe të mahnitur për pafundësinë mahnitëse të Zotit tonë, do ta kemi të vështirë ta kuptojmë Atë. Xhelaleddin Rumi bën një shpjegim të tillë:

*"Dervishi dëshiron të jetë si një peshk në tokë. Faktikisht në formën e një peshku është, por i largohet detit. Allahun e do për ta fituar pëlqimin e Tij. Shpirti i tij nuk është brenda dashurisë së përkryerjes dhe bukurisë së Allahut. Turp atyre që janë mbi tokë! Pa shihni këta hajdutë injorantë të jashtënjëzores, kur shihni pamjen e tyre të bukur, i mendoni asketë, por brenda tyre nuk ekziston Allahu!"*

Nëse njeriu bëhet pre i imagjinatave të veta, nëse mashtrohet pas pamjes së jashtme të botës, nëse njeriu nuk interesohet të ngritet sa më lart, nëse njeriu nuk e tërheq përkryershmëria dhe bukuria hyjnore e Krijuesit të tij, ai do ngelë larg dashurisë, mëshirës dhe dhuntive të Zotit.

Mevlana na ushqen mendjet tona me një perceptim të lartë, ai edhe zemrën tonë na e ngop me perla urtësie në një mënyrë të bukur. Ai gjithnjë thekson rëndësinë e unitetit të botës së brendshme me atë të jashtme. Të bashkosh të përsjertshmen me formën, shpirtin me trupin, gjë të cilën kush e realizon, atij i thonë "veli". Ja, kjo është gjëja për të cilën ka nevojë bota e sotme, sepse për arsye të shkëputjes nga bota shpirtërore po ndizen llampat e alarmit.

# Sënduku i moçëm i Nuri Beut



Nuri Beu ishte një shqiptar i urtë dhe i nderuar, i cili qe martuar me një grua shumë më të re se ai vetë. Një mbrëmje, kur u kthye në shtëpi më shpejt se zakonisht, një shërbëtor i tij besnik shkoi tek ai dhe i tha:

-Gruaja juaj, zonja jonë, sillet në mënyrë të dyshimtë. Rri në dhomën e saj pranë një sënduku të moçëm që i përkiste dikur gjyshes suaj, e që është mjaft i madh sa për të nxënë brenda një burrë. Ai sënduk nuk duhet të ketë pasur brenda gjë tjetër veç ndonjë stolie të vjetër, por besoj se tashmë mund të ketë brenda diçka më tepër. Gruaja juaj nuk më lejon të shoh brenda sëndukut as mua që jam shërbëtor i juaj më i vjetër.

Nuri Beu hyri në dhomën e gruas së tij dhe e pa që po rrinte mërzitshëm ndanë sëndukut prej druri të fortë.

-A mund të ma tregoni se çfarë ka brenda ai sënduk?.

-Për shkak të dyshimeve të një shërbëtor i, apo sepse nuk keni më besim tek unë?

-A nuk do të ishte më e thjeshtë sikur ta hapje pa e zgjatur shumë, e kësaj t'i japim fund një herë e mirë fjalëve që qarkullojnë?

-Nuk besoj se kjo gjë është e mundur.

-Është i mbyllur me çelës? Ku është çelësi?

Gruaja ia tregoi dhe tha:

-Nxirreni jashtë shërbëtorin dhe do t'ua jap.

Kur shërbëtor i doli, gruaja ia dorëzoi çelësin, dhe u tërhoq e tronditur në mënyrë të dukshme.

Nuri Beu u mendua gjatë. Pastaj thirri katër nga kopshtarët e tij dhe, të gjithë së bashku, me të rënë muzgu, e mbartën sëndukun, pa e hapur fare, deri në sinorët e fundëm të tokave të tij, dhe e groposën.

Aty e mbrapa, nuk u fol kurrë më për këtë çështje.

\*\*\*

Kjo histori provokuese, për të cilën thuhet me ngulmim se mbart një domethënie të brendshme, përtej kuptimit të dukshëm moral, i përket regjistrimit të urtakëve endacakë, prijësi i të cilëve është Jusufi i Andaluzisë, i cili ka jetuar në shek. XIII.

Përktheu: Shpëtim Kelmendi





# Tekbiri me fjalë me vepër dhe me zemër

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Tekbir do të thotë të pranosh dhe të deklarojsh se Allahu është më i Madh se çdo gjë tjetër. Së pari, në tekbir përçmohet dynjaja, pastaj refuzohet çdo gjë tjetër përveç Allahut, ndërsa në fund madhërohet Allahu. Tekbiri, i cili përmendet në fillim të çdo namazi, në ditët e Bajramit të Kurbanit dhe gjatë dhikrit në fund të namazit, është një nga simbolet dhe shenjat më të rëndësishme që tregon marrëdhënien Allah-njeri. Qenia e tekbitit si fjalë e parë dhe e fundit në Ezan, tregon se tekbiri është një nga simbolet e Islamit, sepse edhe vetë ezani është një nga simbolet e Islamit.

Kur bëhet fjalë për një krahasim midis Allahut dhe çdo krijese në këtë botë, tekbiri, i cili shprehet me fjalinë “Allahu Ekber”, tregon se Allahu është më i madh se çdo gjë. Tekbiri është tre llojesh: *farz* (i obligueshëm), *vaxhib* (i domosdoshëm) dhe *nafile* (vullnetar).

## 1. TEKBIRI FARZ (I OBLIGUESHËM)

Ky tekbir bëhet në fillim të çdo namazi. Sipas të gjitha medhhebeve, ky tekbir duhet të thuhet pasi të jenë ngritur duart në nivelin e supeve. Kjo do të thotë se tekbiri duhet të shprehet me gjuhën e trupit, me gjuhën e zemrës si edhe me fjalë. Në të gjithë botën, ngritja e duarve në nivelin e supeve konsiderohet në gjuhën e trupit si diçka që shpreh refuzim dhe negativitet. D.m.th; një njeri, i cili kthehet nga kibla për të filluar namazin, e shi-

kon për herë të fundit dynjanë rreth e rrotull dhe me t’u kthyer nga kibla, thotë me gjuhën e trupit: “*Jo, jo nuk ka tjetër më të madh*”, ndërsa me fjalë thotë: “*Allahu Ekber – Allahu është më i Madhi*”. Sigurisht që në këtë çast, në zemër nuk duhet të ketë asgjë më të madhe se Allahu, me qëllim që në sajë të Madhësisë së Tij, shqetësimet e njeriut në lidhje me këtë botë ose me tjetrën të zhduken dhe adhurimi të jetë vetëm për Atë.

Ky tekbir është në nivelin e një kontrate (marrëveshjeje) që e lidh robin me namazin. Nëse kjo kontratë është në rregull, asgjë e kotë nuk mund ta pakësojë vlerën e këtij namazi. Atij që falet, i mbetet të realizojë qëllimin dhe kontratën, sepse të qëndrosh në namaz do të thotë të qëndrosh përpara Allahut dhe të flasësh me Të pa përkthyes, do të thotë të kthehesh nga Ai dhe t’i përgjrohesh. Kur robi bën tekbir, Ai (Allahu) e sheh robin e Tij dhe zemra e robit e ndjen këtë. Në të djathtë ka xhenetin dhe në të majtë ka xhehenemin. Nëse robi thotë “*Allahu Ekber*” dhe në zemrën e tij ka ende diçka më të madhe se Allahu, fjalët e tij nuk mund të jenë të vërteta.

Fillimi i namazit me një tekbir të tillë, shkakton në zemrën e njeriut një tronditje, e cila do ta zhveshë atë prej gjendjes ku ndodhet dhe do të bëjë që ai të përqundrohet me seriozitet në prani të Allahut, sepse njeriu nuk është qenie, e cila mund të zhvishet lehtë nga gjendja fizike apo sociale në të cilën ndodhet. Vetëm një

mendim i thellë dhe një vetëdije e lartë mund ta nxjerrë atë nga gjendja në të cilën ndodhet. Kjo duhet të jetë edhe urtësia e përsëritjes së shprehjes “*Allahu Ekber*” disa herë brenda namazit. Mirëpo, shprehja e tekbitit prej njeriut nuk duhet të jetë e thatë e thjesht një fjalë, por duke sunduar mbi nefsin (egon) dhe dëshirat e tij duhet t’u bindet urdhrave të Allahut. Në këtë rast tekbiti realizohet me gjuhë, me zemër, por edhe me organet e tjera. Por nëse nuk është kështu, tekbiti ngelet vetëm një fjalë e thatë.

Prej robërve të Allahut ka të atillë, të cilët kur thonë “*Allahu Ekber*”, mbushen me dritë dhe në zemrën e tyre gjithësia zvogëlohet e bëhet sa një kokërr gruri që hidhet në shkretëtirë, e kështu nuk tremben prej dyshimeve dhe tundimeve të nefsit. Ata nuk i frikëson as fakti që dynjaja ka dalë jashtë nga zemra e tyre. Kështu, për shkak të vetëdijes së tyre ndaj Madhësisë Hyjnore zemrën e tyre e kaplon një ndjenjë butësie. Kështu që tekbiti dhe qëllimi i tij forcohet me Allahun, për Allahun dhe prej Allahut.

## 2. TEKBITI VAXHIB (I DOMOSDOSHËM)

Ky tekbit që thuhet pas namazeve farz, fillon në ditën e arefesë dhe vazhdon deri në ikindinë e ditës së katërt të Bajramit të Kurbanit, pra nga data 9 e deri në datën 13 të muajit Dhilhixhe, i cili njihet edhe si muaji i haxhit. Koha e kurbanit është një kohë, kur robi e jeton sakrificën përpara Madhësisë Hyjnore në dimensionin shpirtëror. Është shumë e rëndësishme që edhe gjatë prerjes së kurbanit, bashkë me besmelenë të thuhet edhe tekbitët. Gjatë këtyre ditëve, Madhështia Hyjnore duhet perceptuar në një mënyrë sa më të dendur dhe, gjithashtu duke madhëruar Allahun Teala, duhen thyer idhujt që kanë zënë vend në zemër.

Për atë që arrin të kuptojë faktin se Allahu ka krijuar gjithçka për njeriun dhe që beson se Allahut i takon çdo lloj falënderimi, kurbanit është tregues i plotësisë së devotshmërisë së tij. Faktin se tek Allahu nuk arrin as mishi dhe as gjaku i kurbanit, por vetëm devotshmëria e njerëzve, e vërteton më së miri edhe ajeti 37 i sures El-Haxh në Kuranin Famëlartë: “*Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj...*”.

## 3. TEKBITI NAFILË (VULLNETAR)

Ky lloj tekbiti ka forma të ndryshme. Një prej tyre

është dhikri që bëhet pas namazit. Pra, 33 herë “*subhanallah*”, 33 herë “*elhamdulillah*” dhe 33 herë “*Allahu Ekber*”. Këtë dhikër, të cilin na e ka mësuar Profeti (a.s.) dhe që myslimanët e përsërisin pas namazit bën pjesë në llojin e tekbitit sunnet/nafile. Edhe tekbitët që thuhet në namaz, në ezan dhe gjatë therjes së kurbanit bëjnë pjesë në këtë lloj tekbiti.

Sipas një transmetimi, thuhet se kur Resulullahu (a.s.) ngjiste një malore me ushtrinë e tij, të gjithë së bashku bënë tekbitë (Allahu Ekber), ndërsa kur zbrisnin bënë tesbihe. (Ebu Daud, Xhihad)

Edhe gjatë udhëtimit për në haxh, kur Resulullahu (a.s.) po ngjiste një malore bëri tekbitë, ndërsa në zbritje bëri tesbih. Gjithashtu, dihet se edhe Profeti (a.s.) e ka këshilluar një gjë të tillë.

Madhështia i takon vetëm Allahut. Ngjitja nëpër malore mban në vetvete një kuptim të ngjashëm me madhësinë. Njeriu që ngjitet në maja të larta mundet që ta kaptojë egoizmi dhe mund të harrojë dobësinë e tij. Për këtë arsye tekbiti në ngjitje është bërë sunet për njeriun, gjë që duket sikur i jep njeriut një mesazh të tillë: “*O bir i njeriut, mos u mburr me lartësinë në të cilën gjendesh!*”. Kjo do të thotë se, ndonëse ngjitja në maja të larta është diçka materiale, në çështjen e madhësisë dhe lartësisë Allahu është më i Madh se çdo lloj gjëje që njeriu mund t’i bëjë ortak. Ndërsa bërja e tesbihëve gjatë zbritjes shpjegohet më së miri në këtë ajet: “*...Ai është me ju kudo që të gjendeni...*” (El-Hadid, 4)

Përveç ndikimit shpirtëror ushtron në shuarjen e pretendimeve të egos në zemër, tekbiti shpreh edhe ndjenjën e lumturisë dhe të emocionit. Për këtë arsye, gjatë ceremonive të xhenazeve bërja e tekbitëve nuk është e pëlqyeshme dhe është konsideruar si mekruh.

Myslimani njihet për herë të parë me tekbitin nëpërmjet ezanit që i thirret në vesh ditën kur lind. Prandaj, nëse ky tekbit i qëndiset në zemër dhe i bëhet qendër e jetës, atëherë jeta e tij do të fitojë kuptimin e vet dhe ai do të arrijë ëmbëlsinë e devotshmërisë. Mjafton të sjellim ndërmend faktin se shejtani ngriti krye për shkak të mendjemadhësisë dhe do të kuptojmë më së miri se çfarë kuptimi dhe çfarë rëndësie ka për njeriun tekbiti i bërë me fjalë, me vepër dhe me zemër.

Allahu Ekber uelillahi'l-hamd...



# Rreth përkthimeve të Kuranit

Ma. Gilman Kazazi

**P**ërkthimi i Kuranit është një temë delikate dhe e rëndësishme, sepse jo vetëm që mbart në mënyrën më të mirë të mundshme kuptimet, mrekullitë dhe konceptet kuranore tek myslimanët joarabë, po aq është edhe i rrezikshëm, sepse nëpërmjet përkthimit të gabuar dhe jo të saktë deformohet e vërteta kuranore dhe njerëzit mund ta keqkuptojnë Islamit. Shumë njerëz e kanë pranuar Islamit të ndikuar nga leximi i përkthimeve të Kuranit, shumë të tjerëve u është shtuar besimi dhe dituria rreth Islamit duke medituar në kuptimet e Kuranit sipas përkthimeve të bëra në gjuhët e tyre, ndërsa disa të tjerë janë larguar nga e vërteta si shkak i keqpërkthimeve të citateve kuranore. Shkaqet dhe arsyet e një përkthimi të gabuar janë të shumta. Mundet që përkthyesi të jetë qëllimmirë, mirëpo nga ana tjetër mund të ndodhë që nuk njeh në mënyrë të shkëlqyer gjuhën arabe ose gjuhën e tij amtare. Po ashtu, mundet që përkthyesi të jetë edhe qëllimkeq, joobjektiv dhe jo i drejtë në bartjen e kuptimeve kuranore.

## DOMETHËNIA E PËRKTHIMIT DHE LLOJET E TIJ

Përkthimi i Kuranit do të thotë: *bartja dhe shprehja e kuptimeve të ajeteve kuranore nga gjuha arabe në një gjuhë të dytë.*

Përkthimi ndahet në dy lloje:

**1. Përkthim tekstual, i fjalëpërfjalshëm.** Ky lloj përkthimi nuk lejohet dhe është i pamundur, sepse në këtë lloj përkthimi humbasin shumë kuptime esenciale të Kuranit dhe deformohen kuptimet e tij kryesore.

**2. Përkthim kuptimor.** Ky lloj përkthimi është i domosdoshëm dhe i mundur brenda kufijve të aftësive njerëzore.

Për të qartësuar dy llojet e lartpërmendura të përkthimeve, po paraqesim shembujt në vijim.

1. Në suren El-Isra, ajeti 29, sipas përkthimit të fjalëpërfjalshëm Allahu thotë:

**"Dhe mos e bëj dorën tënde të lidhur për qafe, e as mos e shtrij tërësisht, se do mbetesh i qortuar dhe duarthatë."**

Përkthimi tekstual i ajetit të ndalon ta lidhësh dorën për qafe, ose ta shtrish atë shumë, kurse kuptimi dhe qëllimi i ajetit është: *mos u bëj koprac dhe dorështërnguar, gjithashtu mos u bëj shpërdorues.* Islami nxit për mesatarizëm në shpenzime. Në suren El-Furkan, ajeti 67, Allahu thotë:

**"(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështërnguar, por mbajnë mesataren e janë të mbajtur."**

2. Në suren El-Kehf, ajeti 11, sipas përkthimit të fjalëpërfjalshëm Allahu thotë:

**"Ne u vumë (mbulojë) mbi veshët e tyre në shpellë për disa vite."**

Qëllimi i ajetit dhe kuptimi i tij i saktë është: *Ne i vumë në gjumë në shpellë për disa vite.*

## DOMOSDOSHMERIA E PËRKTIMIT KUPTIMOR

Kur themi se përkthimi i kuptimeve të Kuranit është i domosdoshëm, kemi parasysh faktin se Kurani është shpallje universale e Allahut drejtuar të gjithë popujve të botës, arabëve dhe joarabëve. Kështu, nuk mund të **bar-ten mesazhet e sakta kuranore** tek popujt joarabë, nëse kuptimet e Kuranit nuk përkthehen siç duhet. Në këtë mënyrë, jomyslimanëve perëndimorë u jepet mundësia të njihen me të vërtetën Islame.

Gjithashtu, myslihanët joarabë nuk mund ta **mbrojnë të vërtetën kuranore** prej mashtrimeve, deformimeve e dyshimeve të sajara nga misionarët dhe orientalistët jomyslimanë në të ashtuquajturat "përkthime të Kuranit", nëse nuk u ofrohet një përkthim i saktë i kuptimeve kuranore.

Po ashtu, nuk mund t'u **zbulohet bukuria dhe mrekullia e kuptimeve kuranore** popujve joarabë, që atyre t'u shtohet besimi dhe madhështia ndaj Kuranit, nëse nuk u mundësohet leximi i kuptimeve të Kuranit në gjuhën e tyre.

Çdo thirrës islam në një vend joarab, kur mban një ligjëratë apo një hutbe në gjuhën e tij dhe argumentohet me një ajet kuranor, e ka të domosdoshme të tregojë dhe përkthejë kuptimet e ajetit në gjuhën e dëgjuesve.

Profeti Muhamed (a.s.) ka dërguar misionarët e tij me shkresa për sunduesit e ndryshëm të asaj kohe, duke i ftuar ato në Islam. Këto shkresa përmbanin fragmente nga ajetet kuranore, të cilat përktheheshin në gjuhët përkatëse. Nëse përkthimi ishte kategorikisht i ndaluar, Muhamedi (a.s.) nuk do të shkruante në ato shkresa fragmente ajetesh të përkthyer në gjuhë të dyta. Përderisa lejohet përkthimi i pjesshëm i ajeteve, lejohet edhe përkthimi i plotë i Kuranit. Në letrën dërguar mbretit bizantin Hirakliut, thuhet:

*"Nga Muhamedi i Dërguari i Allahut, për Herakliun, Sunduesin e Bizantit; Paqja qoftë mbi atë që ndjek Udhëzimin. Të ftoj të dëgjosh thirrjen Islame (monoteizmin Islam). Nëse bindesh, do të shpëtosh, e Allahu do të shpërblejë dy herë."*

Pastaj ka përmendur fragmentin e ajetit 64 të sures Ali-Imran:

**"... O ithtarë të librit, ejani të bashkohemi te një fjalë që është e njëjtë mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë përveç Allahut, të mos i bëjmë shok Atij, të mos konside-**



**rojmë njëri-tjetrin zotër përveç Allahut. E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: dëshmoni pra, se ne jemi myslihanë."** (Buhariu)

Profeti Muhamed (a.s.) ka lejuar t'i lexohen fragmente nga Tevrati në gjuhën arabe, ndonëse të shpallura në hebraisht. Nëse Muhamedi (a.s.) ka lejuar që atij t'i përktheheshin në arabisht citate nga Tevrati, atëherë është krejtësisht logjike të lejonte që edhe Kurani të përkthehej në gjuhë të tjera, për më tepër kur Kurani është fjalë universale e Allahut drejtuar të gjithë popujve të botës.

### **Nga historiku i përkthimeve**

Të interesuarit e parë për përkthimin e Kuranit kanë qenë orientalistët, turqit dhe persët.

Përkthimi i parë i Kuranit ka qenë në gjuhën **latine**, në vitin 1143, i realizuar nga përkthyesi anglez Robert. E. K.<sup>1</sup> Përkthimi më i vjetër në gjuhën **turke** që është ruajtur, është ai i vitit 1333 - (734 h.), i përkthyer nga Muhamed ibn el-Haxh Deuletu Shah esh-Shirazij, në dialektin e vjetër turk: urguzijeh (urguca). Vlen të përmendim se edhe autori i himnit turk, **Mehmet Akif Ersoj**, që është me origjinë shqiptare, ka përkthyer Kuranin në gjuhën turke gjatë kohës kur ka qenë në Egjipt, por ky përkthim nuk ka mbërritur në Turqi dhe nuk është botuar.<sup>2</sup>

Po ashtu edhe **Shemsetin Sami Frashëri** pati tentuar

1. Shih: Muhamed Abdul-Adhim ez-Zerkani, Menahilul-Urfan, Bejrut, 1999, 2/89. Ali ibn Najif, el-Mufasal fir-rred ala shubuhati a'dail-Islam, 10/285.

2.. Shih: Dr. Nexhdet Ramadan, Terxhemetul-Kur'ani ve etheruha fil-meani, Da - ask, 1995, f. 133.



ta përkthente atë në gjuhën turke, por botimi i këtij përkthimi u ndalua nga qeveria osmane, ndërsa pjesët e përkthyer u asgjësuan.

Përkthimi i parë në **frëngjisht** është botuar në vitin 1648, në gjuhën **italiane** më 1513, në gjuhën gjermane më 1616, ndërsa në gjuhën **angleze** përkthimi i Kuranit është bërë më 1840 nga Xhorxh Seil (George Sale) dhe është ribotuar 34 herë. Në gjuhën **ruse** është botuar përkthimi i parë, i realizuar më 1716 nga Posnikov, por duke qenë se është përkthyer nga frëngjishtja dhe jo nga origjinali arabisht, ky përkthim konsiderohet i dobët dhe me mangësi. Deri në vitin 1980 kanë ekzistuar 1380 përkthime të plota të Kuranit, në dhjetra gjuhë të ndryshme. Madje në disa gjuhë është përkthyer disa herë, si për shembull: në gjuhën serbokroate është përkthyer 4 herë, në anglisht më se 60 herë, ndërsa në turqisht më se 100 herë.<sup>3</sup>

Edhe në gjuhën shqipe ekzistojnë disa përkthime të plota ose të pjesshme, prej të cilave mund të përmendim:

- Përkthimet e para të pjesshme të Kuranit në gjuhën shqipe datojnë nga mesi i viteve 20-të të shekullit të kaluar. Mund të duket si e çuditshme, por e vërteta është se përkthyesi i parë i Kuranit, i njohur deri më sot, është atdhetari korçar dhe i krishteri ortodoks **Ilo Mitkë Qafëzezi**. Ai bëri përkthimin e parë të pjesshëm në gjuhën shqipe të këtij libri, duke u mbështetur në përkthimin anglisht të bërë nga George Sale. Nga gjithë libri ai arriti të botonte pjesën e parë në Rumani më 1921. Këtë botim autori ua

dedikon, siç shprehet vetë, “*Bashkatdhetarëve kombëtarë të Shteteve të Bashkuara t’Amerikës*”. Ndërsa fashikullin e dytë të këtij botimi ai arriti ta shtypte në Korçë, pas gjashtë vjetësh, më 1927.

Motivet nga të cilat ai u nis në përkthimin dhe botimin e Kuranit të shenjtë i bëri të qarta në parathënien e botimit të parë, ku shkruan: “*Le të bëjmë nga librat fetarë çështje të kulluar kombëtare. S’është nevoja të dobësojmë ndjenjat e shpirtit. Nga këjo nuk e gjen fare dëm Shqipërin’ e sotme. Vetëm fanatizmi fetar duhet ndjekur edhe luftuar, gjer të shduket nga zemrat e Shqiptarëve që e duan Shqipërinë e lirë ndë radhë qytetërimi. Tjetrazi jemi të humbur.*”

Pavarësisht se përkthimi i parë i Kuranit në gjuhën shqipe i realizuar nga Ilo Mitkë Qafëzezi më 1921 dhe 1927 është një botim pa shumë pretendime në fushën e tekstopologjisë kuranike në gjuhën shqipe, ai ka meritën jo vetëm pse është i pari, por edhe sepse është ndërmarrë nga një kristian.

- Në krye të përpjekjeve për përkthim ndeshim emrat e klerikëve të shquar si **Hafiz Ali Korça** dhe **Hafiz Ibrahim Dalliu**. I pari, pothuajse njëkohësisht me Ilo Mitkë Qafëzezin, botoi përkthimin e 37 ajeteve dhe të dy sureteve të Kuranit, në Shkodër më 1926.

- Po në Shkodër, më 1929 botohet dhe Sureja e Jasinës në përkthimin e **Shefqet Mukës**, me pseudonimin “Shkodrani”.

- Pa kaluar shumë kohë nga këto përkthime dhe botime të pjesshme, sheh dritën e botimit një përkthim mjaft i plotë, së bashku me komentin, i bërë nga **Hafiz Ibrahim Dalliu** nën titullin “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit”, botuar në tre vëllime dhe disa fashikuj midis viteve 1929, 1930, 1931 dhe 1942. Ky është jo vetëm një përkthim më i plotë, por është bërë nga një njohës shumë i aftë i teologjisë islame. Fakti që ky botim i parë i Kuranit në gjuhën shqipe zgjati afro 15 vjet flet për seriozitetin dhe përgjegjësinë e ndjerë nga përgatitësi i tij.

- Krahas përpjekjeve të Hafiz Ibrahim Dallit për një përkthim të plotë të Kuranit vazhdojnë dhe përkthime të tjera të pjesshme si ato të **Abdullah Zemblakut** në Korçë, më 1930 e 1934.

- **Ferit Vokopola**, na ka dhënë në gjuhën shqipe përkthimin e disa vargjeve kuranore, të realizuara përmes frëngjishtes.

- Përkthimi i prof. dr. **Feti Mediu** (Prishtinë, 1985) njihet si përkthimi i parë i plotë i Kuranit. Në vitin 1999 doli botimi i dytë i përkthimit të Kuranit nga prof. dr. Feti Mehdiu, i plotësuar edhe me tekstin original të Kuranit

3. Shih: Prof. Hasan I. Nahi, Kurani i Madhëruar, Prizen, 2000, f. 640.

në gjuhën arabe, me titull: "Kur'ani dhe hija e tij shqip". (Faqe 604.)

- Përkthimi i **H. Sherif Ahmetit** (Prishtinë, 1988) përkthim, i cili ka njohur disa ribotime: në Romë më 1990, në Kajro më 1992, në Islamabad më 1993 dhe së fundi në Medine. (Faqe 903.)

- Përkthimi i prof. **Hasan I. Nahit** (1988), teolog i diplomuar në universitetin el-Az'har, në Kajro. Ky përkthim është bërë nga origjinali arabisht dhe është rezultat i punës shumëvjeçare të përkthyesit. (Faqe 720.)

- Përkthimi anonim i një grupi përkthyesish në Rijad, Arabi Saudite, i botuar nga shtëpia botuese "Darussalam". (Botimi i dytë: Shtator 2000. Faqe 956.)

### ÇFARË DUHET TË KIHET PARASYSH NË NJË PËRKTHIM TË KURANIT?

1. Përkthimi nuk ka të njëjtat dispozita me origjinalin, nuk mund ta zëvendësojë atë dhe nuk quhet Kuran. Çdo përkthim në cilën do gjuhë tjetër, nuk është asgjë më shumë se domethënie e përafërt e Kuranit, por jo edhe vetë Kurani.

2. Përkthimi e humbet përsosshmërinë e kuptimeve, bukurinë dhe melodinë e shprehjeve të origjinalit.

3. Përkthimi nuk konsiderohet mrekulli në të gjitha aspektet ashtu siç është origjinali.

4. Leximi i përkthimit nuk ka të njëjtin shpërblim me leximin e origjinalit.

5. Përkthimi nuk mund të lexohet në namaz siç mund të lexohet origjinali.

6. Përkthimi bart stilet dhe metodat e ndryshme të përkthyesve, bart formimet e ndryshme të tyre si dhe keqkuptimet ose keqinterpretimet e tyre.

### KUSHTET E PËRKTHIMIT TË KURANIT

Dijetarët bashkëkohorë<sup>4</sup> kanë kushtëzuar një sërë kushtesh që duhet të plotësojë përkthyesi ose përkthimi, në mënyrë që të jetë i pranueshëm:

1. Qenia e përkthyesit mysliman, njeri i besueshëm dhe i drejtë. Në rast se përkthyesi është jomysliman ose mysliman me bindje të devijuara, përkthimi i tij nuk pranohet.

2. Njohja shumë e mirë e gjuhës arabe dhe e gjuhës së dytë.

3. Njohja e ligjeve të sheriatit, njohja e arsyeve të zbritjes

4. Shih: Prof.dr. Nurud-din Itr, Ulumul-Kur'anil-Kerim, Damask, 1996, f. 119.

së ajeteve kuranore dhe haditheve të Pejgamberit (a.s.). Kjo, duke qenë se treguesi më i saktë i kuptimeve të Kuranit është vetë Pejgamberi (a.s.).

4. Pëlqehet botimi i përkthimit me tekstin origjinal të Kuranit Famëlartë.

Së fundi, nëse hasim në literaturën islame mendimin e disa dijetarëve, të cilët e ndalojnë përkthimin e Kuranit<sup>5</sup>, atëherë arsyetimi i tyre në këtë qëndrim është:

1. Përkthimi i largon njerëzit nga origjinali dhe njëkohësisht ia humbet atyre interesin e të mësuarit të gjuhës arabe. Gjuha arabe është një nga faktorët kryesorë për unitetin e myslimanëve.

2. Kuptimet e Kuranit janë mrekulli e pashtershme dhe fjalët e përkthimit nuk mund të bartin kuptimet e plota të origjinalit. Në çdo kohë, Kurani i zbulohet dhe shfaqen kuptime të reja dhe thesarë të rinj, duke bërë kështu që ai të mbetet i pashtershëm.

3. Përkthimi e humbet fjalën e zbritur dhe të shpallur nga Allahu dhe ruan vetëm një pjesë të kuptimeve, por në të njëjtën kohë përkthimi përmban edhe keqkuptimet e përkthyesit. Mund të thuhet se nuk ka përkthim pa gabime.

4. Sikur të kishte qenë përkthimi i rëndësishëm, do ta kishte praktikuar profeti Muhamed (a.s.) dhe shokët e tij. Letrat e dërguara tek mbretërit e asaj kohe nga Profeti nuk kanë përmbajtur ajete të plota, por fragmente ajetesh.

5. Thëniet e shumë studiuesve të huaj, sipas të cilëve Kurani nuk mund të përkthehet në ndonjë gjuhë tjetër me tërë fuqinë letrare të shprehjeve që zotëron ai. Një nga përkthyesit e famshëm të Kuranit, orientalisti anglez Mar-noduk Pichhall, ka thënë: "Kurani nuk mund të përkthehet. Andaj, edhe nuk them se kam arritur ta përkthej Kurantin, por unë, vetëm jam përprjekur dhe munduar që t'i transmetoj kuptimet kuranore."<sup>6</sup>

I dashur lexues, nuk ka dyshim se leximi i Kuranit dhe studimi i tij nga arabishtja, gjuha e Kuranit, është ëndërr e çdo myslimani. Kënaqësitë që përjeton lexuesi nga arabishtja nuk kanë të përshkruar e as të krahasuar. Kështu, mënyra e vetme e shumë myslimanëve për të shijuar sado-pak aromën e këndshme të kuptimeve kuranore mbetet përkthimi kuptimor.

5. Shih: Prof. dr. Muhamed Ebu Shuhbeh, el-Med'hal lidirasetil-Kur'an, Kajro, 1992, f. 394.

6. Sadri Prestreshi, Parathënie e përkthimit të Kuranit të Madhëruar nga Prof. Hasan I. Nahit, Prizren, 2000, f. 6.

# Teubeja e vrasësit të 100 vetave

Fatmir Hadri

**N**ga Ebi Seid El-Huderiu transmetohet se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: “Një nga paraardhësit tuaj kishte vrarë 99 veta. Një ditë ai vendosi të vihej në kërkim të njeriut më të ditur në sipërfaqe të tokës, me qëllim që t’i shprehte pendesën e tij. E këshilluan të takonte një prift. Ai shkoi tek prifti dhe e pyeti:

-A ka mundësi teubeje (pendese) për një njeri që ka vrarë 99 veta? Përgjigjja që mori ishte:

“Jo.”

Atëherë ai e mbyti edhe priftin, duke e çuar kështu në 100 numrin e njerëzve të vrarë nga dora e tij. Pas kësaj ai u vu sërish në kërkim të njeriut më të ditur në sipërfaqe të tokës. E këshilluan të shkonte te një tjetër i urtë, të cilin e pyeti:

-Një njeri që ka vrarë njëqind veta a mundet të bëjë teube?

I dituri iu përgjigj:

“Po, e kush mund ta ndalojë atë nga të bërit teube?!”

Pastaj vazhdoi:

-Shko në filan vend, ku ka njerëz që i bëjnë ibadet Allahut dhe adhuroje Atë së bashku me ta, por mos u kthe në

vendin tënd, sepse atje ka vetëm përçarje e fesad.

Burri u nis të shkonte te vendi ku i tha i dituri, mirëpo gjatë rrugës i erdhi çasti i vdekjes. Pasi ai iu dorëzua vdekjes, melaiket e rahmetit dhe melaiket e dënimit ranë në dilemë, sepse s’po e vendosnin dot se kujt i përkiste ai njeri. Melaiket e rahmetit thanë: “*Ai u pendua dhe u drejtua me zemrën e tij nga Allahu.*” Ndërsa melaiket e dënimit thanë: “*Ai nuk ka bërë kurrë vepra të mira.*” Atëherë, atyre u erdhi një melek në formën e një njeriu, të cilin ata pranuan ta bënin ndërmjetësues në këtë çështje. Ai u tha: “*Mateni largësinë mes dy vendeve. Ai duhet t’i përkasë atij vendi ndaj të cilit ka qenë më afër në çastin e vdekjes.*” Kur i matën distancat, panë se ai njeri ishte më afër vendit ku dëshironte të shkonte, se sa afër vendit prej të cilit ishte larguar. Kështu, burrin e morën melaiket e rahmetit e të mëshirës.

Transmeton Buhariu, Muslimi:

Në një transmetim të vërtetë thuhet: “*Vrasësi ka qenë më afër fshatit të mirë për një pëllëmbë, prandaj u konsiderua prej të mirëve*”, kurse në një transmetim tjetër të vërtetë thuhet: “*Allahu urdhëroi njërin fshat të largohej, ndërsa tjetrin të afrohej. Pas kësaj, Ai i urdhëroi melaiket: “Mateni largësinë e të*

dyve!". MelaiKET vërejtën se gjynahqari ishte një pëllëmbë më afër fshatit, banorët e të cilit ishin të mirë e kësisoj atij njeriu iu falën gjynahet."

Por, kush mund ta ndalonte atë nga teubeja?!

O ti që dëshiron të pendohesh, a mos të duken gjynahet e tua më të mëdha se të këtij personi të cilit Allahu ia fali?! Kurrsesi, atëherë përse dëshpërohesh?!

Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin famëlartë ka thënë:

**"Dhe ata që, pos Allahut, nuk adhurojnë zot tjetër, nuk vrasin njeri, gjë që Allahu e ka ndaluar, përveçse me të drejtë dhe që nuk bëjnë kurvëri. E kush i bën këto, do të marrë gjynahe. Ndëshkimi do t'i dyfishohet në Ditën e Kiametit dhe ai do të qëndrojë përherë në këtë fatkeqësi i poshtëruar. Përjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë."** (Furkan: 68:70)

Le t'i hedhim një shikim Fjalës së Tij: **"Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira."** Këtu shihet shumë qartë se sa i mëshirshëm ndaj nesh është Allahu. Dijetarët thonë se në lidhje me këtë pikë ndërrimi i veprave është dy llojesh:

**I pari:** Shndërrimi i vetive të këqija në veti të mira, ashtu siç shndërrohet shirku në iman, zinaja (imoraliteti) në nder e pastërti, gënjeshtria në drejtësi, tradhëtia në besueshmëri, e kështu me radhë.

**I dyti:** Shndërrimi i të këqijave në të mira Ditën e Kiametit. Mendo pak Fjalën e Allahut: **"Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira"**. Ai nuk ka thënë: "Çdo të keqe do ta ndërrojmë me çdo të mirë që do të bëjnë, sepse ato mund të jenë më pak, baraz apo më shumë në numër a në peshë. E gjithë kjo matet sipas sinqeritetit të të penduarit dhe sipas vlerës së pendimit të tij." Po a ka nimet (mirësi) më të madh se ky? Tani shiko sqarimin që i bëhet kësaj dhuntie hyjnore në këtë hadith të bukur:

Nga Abdur-rahman bin Xhubejri transmetohet se Ebi Tavi Shatb el-Memdudi ka shkuar tek Pejgamberi alejhi selam, kurse në disa versione të tjera thuhet: "Tek Pejgamberi ka shkuar një plak aq i shtyrë në moshë, saqë vetullat i kishin rënë mbi sy. I mbështetur në bastunin e tij, ai i është afruar Pejgamberit alejhi selam dhe i ka thënë: "Çfarë mund të më thuash për një njeri që i ka bërë të gjitha llojet e gjynaheve, qofshin ato të vogla apo të mëdha, pra që nuk ka lënë gjë pa bërë?" Në një version tjetër thuhet: "...ka bërë çdo gjë që i ka ardhur ndoresh, madje aq sa sikur gjynahet e tij të shpërndaheshin në mes banorëve të tokës, njerëzit do të shkatërroheshin prej atyre gjynaheve."

A ka mundësi pendimi për këtë?



Alejhi selami tha:

-A je bërë mysliman?

Njeriu u përgjigj:

-Sa më përket mua, unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Allahut.

Atëherë Resulull-llahu i tha:

-Bëj vepra të mira dhe lëri të këqijat, në mënyrë që Allahu të t'i shndërrojë të gjitha në të mira.

I mahnitur, plaku pyeti sërish:

-Edhe tradhëtitë, edhe krimet e mia?!!!

Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj:

"Po!"

Atëherë njeriu filloi të brohorasë:

"Allahu Ekber!", dhe vazhdoi kështu derisa humbi nga shikimet tona".

(Transmeton Taberaniu dhe Bezzari)

Tani disa nga të penduarit mund të pyesin: Unë, sa isha në rrugë të shtrembër, nuk kam falur asnjëherë namaz, sepse isha jashtë çdo bazamenti islam, por ama disa vepra të mira i kam bërë. A më llogariten ato të mira edhe pas pendimit, apo i ka marrë era?!

Përgjigjja e kësaj është hadithi. Transmetohet nga Urve ibni Zubejri se Hakim ibni Hazami e ka lajmëruar që i ka thënë Pejgamberit alejhi selam: "O Resulull-llah, ç'thua për disa punë me të cilat doja të arrija sevap në xhahilijet, siç është sadakaja, lirimi i robërve dhe vizita e farefisit. A ka shpërblim për to?" Pejgamberi alejhi selam iu përgjigj: "Kur je bërë mysliman i ke marrë të gjitha të mirat që ke bërë më parë."





# Domosdoshmëria e heshtjes

Sadik Dana

Allahu Teala në Kuran ka thënë:

**“S’ka kurrfarë të mire në shumë prej bisedave të tyre të fshehta, përveç rastit kur ndokush kërkon që të jepet sado daka ose të kryhet një vepër e mirë apo paqësim ndërmjet njerëzve.”** (en-Nisa 114)

I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

-Lum ai që lë fjalët e tepërta për më vonë, lum ai që jep shumë pasuri, pra lum ai që zgjidh lidhësen e trastës së parave e me të lidh gjuhën e tij!

Në lidhje me të njëjtën temë Profeti (a.s.) ka thënë:

**“Nuk ka gjë më të keqe për njeriun se sa të flasë tepër.”**

Një herë tjetër ai është shprehur:

-Për njeriun, i cili kur flet nuk kundërshton, nuk mbjell armiqësi dhe nuk thotë asnjëherë fjalë të pavërteta, do të ndërtohet një saraj në xhenet. E nëse hesht edhe kur ka të drejtë, atij do t’i dhurohet një saraj në xhenetin më të lartë.

Më poshtë do të japim vetëm disa prej fjalëve të të Nderuarit të Gjithësisë, të sahabeve të nderuar dhe të të urtëve të nderuar në lidhje me të folurit e pakët:

Krijesa më e nderuar e njerëzimit, Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë:

-Vepra që do më shumë Allahu i Lartmadhëruar është mbrojtja e gjuhës prej gjërave të padobishme e të ndaluara.

-Sadakaja më e mirë është mbrojtja e gjuhës prej fjalëve të ndaluara.

- Heshtja është pika kulmore e moralit të lartë.

- Njeriu që hesht dhe nuk flet gjëra të kota ka shpëtuar prej rreziqeve të kësaj bote dhe botës tjetër.

- Heshtja ndaj së kotës është adhurimi më i rëndësishëm.

- Ka shpëtuar ai njeri, i cili heshtjen e ka të mbushur me

meditim, që shikimin e ka të pajisur me aftësinë e të nxjerrurit mësim dhe që ka shumë istigfare në librin e veprave të tij.

- Qëndroni sa më afër atij që është i përkorë e fjalëpak, sepse ai njeri ia ka arritur urtësisë me siguri.

- Heshtja është urtësi dhe njerëzit që e kanë një virtut të tillë janë të paktë. Ai që flet gjëra boshe bën detyrimisht shumë gabime.

- Shumë gabime njerëzore burojnë nga gjuha.

- Ai që do të ketë më shumë gjynahe Ditën e Kijametit është ai që flet shumë fjalë boshe.

Krenaria e Gjithësisë (a.s.) ka thënë gjithashtu:

- Braktisja e fjalëve të tepërta e të panevojshme dëshmon për moralin e bukur të njeriut.

- Lum ai që ka nën kontroll (sundim) gjuhën e tij, ai të cilit shtëpia e vet i duket e gjerë dhe e rehatshme e që përlohet për gabimet e tij.

- Ajo që i ka hije një njeriu të mençur është të mos flasë për diçka tjetër përpos çështjeve të jetesës (çështjeve ekonomike për të siguruar ekzistencën), çështjeve që lidhen me Ahiretin dhe çështjeve familjare.

Umeri (r.a.) ka thënë:

- Heshtja është rroba më e bukur e njeriut.

- Atij që qesh shumë i pakësohet madhështia. Ai që flet shumë gabon shumë dhe një njeriu të tillë i pakësohet ndjenja e turpit.

Hazreti Ali – kerremallahu vëxhheh – ka thënë:

- Njeriu është fshehur nën gjuhën e tij. Bëjeni të flasë dhe atëherë do të kuptoni se sa shumë e sa shpejt ka për t’i humbur vlerat e tij.

Përsëri i Dërguari i Allahut sallallahu – alejhi ve sellem

– ka thënë:

*- Ushqeji të uriturit, jepu ujë të eturve, urdhëro për mirë dhe ndalo të keqen. Nëse nuk ke mundësi t'i bësh këto, atëherë ruaje gjuhën tënde prej fjalëve të padobishme.*

*- Për sa kohë zemra e njeriut të mos jetë e drejtë, as besimi i tij nuk mund të jetë i drejtë. Për sa kohë gjuha e tij të mos jetë e drejtë, as zemra e tij nuk mund të jetë e drejtë.*

Hirësia e tij, Hazreti Mahmud Sami –kuddise sirruhkishte raste që nuk fliste fare me orë të tëra, sigurisht në ato raste kur e folura nuk ishte e nevojshme. Kur heshte, ai përkushtohej gjithmonë me dhikër e me thellimin e botës së tij shpirtërore. Allahu e di më së miri, këto zhytje në mendime ishin prej meditimeve të Ebu Bekrit radijallahu anh, prej ashabeve të nderuar e prej të mëdhenjve dhe miqve të Allahut. Ata që gjendeshin pranë tij përjetonin të njëjtën gjë, por kur largoheshin nuk ishin më të zotët të qëndronin në të njëjtën gjendje.

Kalonin ditë e javë të tëra nëpër udhëtimet e Hixhazit e të Anadollit dhe nga goja e tij dilnin vetëm tetë ose dhjetë fjalë që duheshin thënë domosdoshmërisht, me përjashtim të bisedave shpirtërore e të kuvendimeve të ngrohta fetare. Kur e lypte nevoja ai fliste me orë të tëra plot kënaqësi dhe nuk ndjente në vetvete as lodhjen më të vogël. Në fjalët e tij nuk vërehej as tepri e as mangësi.

Ai i donte shumë ata që heshtnin e që kishin moral të lartë. Ulej pranë tyre dhe i lavdëronte. Kujdesej shumë për edukatën e tyre, dëshironte që edhe ata të zbukuroheshin me cilësi të vyera si të tijat dhe për realizimin e kësaj i lutej Allahut të Lartmadhëruar.

Kur shkante në Medinen e ndritur vizitonte Hazreti Mevlana Ziyaeddin El-Kadirin, të cilin e donte shumë. Takimi me të ishte krejtësisht shpirtëror dhe zakonisht zgjaste vetëm gjysmë ore. Gjatë kësaj kohe thuhej vetëm “*Esselamu alejkum*” në hyrje dhe “*Esselamu alejkum*” në dalje.

## Natyra e të nxënimit

Ibrahim Khauuas tregon se, qysh në moshë të re, vendosi të ndiqte mësimet prej një mësuesi. Ai u vu në kërkim të këtij urtaku, e gjeti dhe i kërkoi që të pranonte ta merrte si nxënësin e tij. Mësuesi u përgjigj:

- Nuk je ende gati.

Duke parë se nxënësi këmbëngulte, urtaku i tha:

- Shumë mirë, do të të mësoj diçka. Kam ndërmend të nisem për haxhillëk në Mekë. Eja me mua.

Nxënësit i gufoi zemra nga gëzimi.

- Meqë tashmë jemi shokë udhëtimi, -tha mjeshtri, është e nevojshme që njëri të udhëheqë dhe tjetri të bindet. Zgjidh rolin që të pëlqen.

- Urdhëro ti, kurse unë do të bindem, -tha nxënësi.

- Unë do mund të urdhëroj nëse ti do të dish të bindesh, -tha mjeshtri.

Udhëtimi filloi.

Një natë, ndërsa ishin duke pushuar në shkretëtirën e Hejazit, nisi të binte shi. Mësuesi u çua dhe, që ta mbronte nxënësin nga shiu, i hodhi përsipër një velenxë.

- Por ti po bën atë që, në të vërtetë, duhet ta bëj unë për ty, -kundërshtoi nxënësi.

- Unë të urdhëroj të më lejosh të të mbroj, -tha mjeshtri.

Kur zbardhi dita, djali i tha mjeshtrit:

- Sot është një ditë e re. Lermë që të jem unë prijësi, dhe bindmu.

Mjeshtri pranoi.

- Po shkoj të mbledh shkarpa për të ndezur një zjarr, vendosi djali.

- As që bëhet fjalë; shkoj unë për t'i mbledhur, -tha mjeshtri.

- Të urdhëroj të qëndrosh këtu, ndërsa shkarpat do shkoj t'i mbledh unë!, -kundërshtoi Ibrahim.

- Kurrsesi, -u përgjigj mjeshtri, sepse rregullat e të nxënimit nuk lejojnë që nxënësi të pranojë shërbime prej mësuesit.

Duke vepruar kështu, mjeshtri nuk humbte kurrë asnjë rast për t'i treguar nxënësit të tij, me shembuj praktikë, se cili ishte kuptimi i vërtetë i nxënësisë.

Me të arritur në portat e Qytetit të Shenjtë, u ndanë nga njëri-tjetri. Kur, më vonë, e takoi mjeshttrin, nxënësi nuk mundi të përballonte vështrimin e tij.

- Ajo që ke mësuar, -tha plaku, bën pjesë në natyrën e të nxënimit.

\* \* \*

Ibrahim Khauuas (Endësi i fijeve të palmës) e përkufizonte kështu rrugën sufi: "Pranoni që të tjerët të bëjnë atë që duhet të bëjnë për ju. Bëni për veten tuaj atë që duhet të bëni për veten tuaj".

Përktheu: Shpëtim Kelmendi



# Allahu Ekber

## Pse bëjmë gjynah?

Ma. Zymer Ramadani

**K**ur dimë se Allahu (xh.sh.) është krijues i gjithçkaje që ekziston në këtë gjithësi, se është mbi të gjithë e mbi çdo lloj fuqie tjetër, se Ai është Më i Madhi, atëherë pse bëjmë mëkate me sjelljet e me veprat tona?

Për të parë gabimet që bëjmë, do të ndalemi në shpjegimin e mëkatit: si na largon mëkati nga Allahu dhe si na afrojnë drejt Tij, veprat e mira. Në Kuranin fisnik, Allahu (xh.sh.) thotë: **“Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t’ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t’i themi): “Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”**”<sup>1</sup>

Nga Ebu Hurejre (r.a.) transmetohet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: **“Shpejtoni në vepra të mira, sepse në një të ardhme të afërt do të paraqiten fitnet (përçarjet), sikurse terri i natës. Kështu që atëherë njeriu do të gdhijë si besimtar, e do të flejë si qafir dhe anasjelltas; do të flejë si besimtar e do të gdhijë si qafir. Ai, fenë e tij do ta shesë për interesat e kësaj bote.”**<sup>2</sup>

Bota në të cilën na ka krijuar Allahu i Madhëruar është

e stolisur me aq shumë bukuri mahnitëse, sa njeriut nuk i mjafton koha as t’i mësojë, t’i shikojë apo t’i shijojë ato. Në Kuranin fisnik, Allahu (xh.sh.) thotë: **“...edhe në qoftë se përpigjeni t’i numëroni të mirat e Allahut nuk do të mund të arrini t’i përkufizoni (në numër)”**.<sup>3</sup>

E si mundet njeriu t’ia arrijë kësaj, kur ai është i mangët për të zbuluar edhe sekretet e tij trupore. Megjithatë, ai është krijesa më e mirë në rruzullin tokësor. Për këtë shkak, egoja e çdo njeriu anon gjithmonë nga ajo që i pëlqen, drejt gjërave prej të cilave përfton prehje e kënaqësi. Ai nuk dëshiron të mundohet me obligime e të merret me punë të rënda, të cilat i shkaktojnë lodhje dhe nuk e lejojnë të arrijë atë çka dëshiron me shpirt, sepse njeriu kështu është krijuar. Egoja e tij është i atillë, sa anon gjithmonë nga gjërat e këqija, gjë e cila shkaktohet nga ajo që quhet **“nefsu’l-emmâre”**. **“Unë nuk e shfaqësoj veten, sepse epshi (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirë-plotë”**.<sup>4</sup> Një gjë tjetër që e nxit njeriun në kryerjen e veprave të këqija është edhe fakti se shumë njerëz, duke qenë se kanë dyshime apo nuk besojnë në jetën tjetër, mendojnë se kjo botë

1. Surja Isrà, 17/13,14.

2. Rijadu’s-Sâlihîn, Hadithi nr. 87. Erkam yay.

3. Ibrâhîm, 13/34

4. Jûsuf, 12/53.

është gjithçka e se këtu duhet vepruar lirshëm. Në këtë mënyrë këta njerëz bien shumë lehtë në mëkat. Sipas terminologjisë kuranore ky quhet *“nfsu'l-levvâme”*. Përveç kësaj, është edhe një lloj tjetër egoje, që u kundërvihet dëshirave e pasioneve të kota të njeriut, e cila quhet *“nfsu'l-mutmeinne”* - pra i edukuar, i qetë dhe që dëshiron të arrijë kënaqësinë e Allahut; ***“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai i kënaqur me ty!”***<sup>5</sup> Janë të paktë njerëzit që i përmbahen rregullave të kësaj bote apo kushtetutës hyjnore të zbritur nga Allahu.

Një nga gjërat që e trazon njeriun, që e mundon dhe e zbratë në nivel të ulët e të dobët, është edhe i ashtuquajti mëkat i madh e i fshehur: ***“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t'i bëhesh mbrojtës atij?”***<sup>6</sup> Përkufizimi është aq i lehtë, sa edhe vetë emri na mundëson të kuptojmë se çfarë do të thotë. Termi gjynah rrjedh nga arabishtja e nga persishtja e është përfshirë edhe në terminologjinë tonë fetare me kuptimin *“mëkat, dëm, shkelje, faj”*.<sup>7</sup> Domethënë, personi që shkel një normë fetare, që shkel ndonjë urdhër apo bën ndonjë gjë të ndaluar, ai ka bërë faj, quhet mëkatar e për këtë do të japë llogari para krijesit apo ligjit fetar - shëriatit. Në ajetet kuranore dhe hadithet e ndryshme, këtë fjalë e vërejmë të trajtuar me termat: *ithm, dhenb, xhunanah, hûb, kebire, kufr, isjan, hatie, xhurm, dhulm*, etj. Të gjithë këto terma e marrin kuptimin e vet mbi bazën e veprave, duke i gjykuar nga ajetet kuranore. Kurani fisnik ndjek trajta të ndryshme në raste të ndryshme, për t'i njohur njerëzit në lidhje me mëkatin. Zakonisht, në fillim të ajetit apo edhe në fund, thuhet se kryerja e kësaj apo e asaj vepre është mëkat. Por ka edhe raste tjera kur hasim ajete në të cilat, përmes mënyrës mohore Allahu i Madhëruar na lejon ose na ndalon kryerjen e një veprimi: *“Nuk është mëkat për ju të veproni kështu...”*. Po ashtu, në ajetet kuranore vërejmë se përveç se na e ndalon kryerjen e një vepre, Allahu i Madhëruar na i mbyll edhe rrugët që çojnë te ajo vepër. Pra afrimi tek ajo vepër është mëkat, ndërsa kryerja e saj është një tjetër mëkat i ndëshkueshëm. Për shembull: *“Mos iu ofroni prostitucionit”, “mos e hani mallin e jetimit”, “mos u thoni prindërve of”*. etj.

Mëkatet janë të llojeve të ndryshme. Ato ndahen në

5. Fexhr, 89/27,28.

6. Furkân, 25/43.

7. DIA, “Günah” maddesi, vëll. 14.



mëkate të mëdha, që quhen *“el-kebire”* dhe në mëkate të vogla, që quhen *“es-sagire”*. Shkalla e dënimit varet nga fakti se sa i rëndë është mëkati. Ndëshkuesi i këtyre mëkateve si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër është Allahu. Po ashtu, në Kuran janë përmendur mëkatet e mëdha dhe në çdo rast është kërkuar që robi të ruhet prej tyre, se përndryshe e pret një dënim i dhimbshëm e i rëndë. Në një hadith, Pejgamberi (a.s.) na tregon për disa mëkate të mëdha, të cilat janë:

1. T'i bësh shok Allahut (shirk) apo të futësh edhe dikë tjetër në adhurimin ndaj Tij.
2. Të merresh me magji e me gjëra që turbullojnë mendjen e njeriut dhe e hedhin atë në mosbesim, duke ia humbur shpresat për jetë.
3. Të zbatosh kamatën e të merresh me sisteme bankare që janë me interes, të cilat nuk e ndihmojnë njeriun, por përkundrazi e dëmtojnë.
4. Mbytja e njeriut pa të drejtë.
5. Ngrënia e pasurisë së jetimit.
6. Dezertimi nga lufta.
7. Shpifja për imoralitet ndaj një gruaje të ndershme myslimane.<sup>8</sup>

Mes këtyre shtatë mëkateve që ka përmendur Pejga-

8. Buhâri, “Vesâjâ”, 23, “Hudûd”, 44; Muslim, “Imân”, 144, Ebû Dâvûd, “Vesâjâ”, 10.



mberi (a.s.) , dy janë edhe më të rënda, aq sa nëse njeriu vdes pa u penduar për to, **ebedijjen** – ai mbetet përgjithmonë në xhehenem. Këto mëkate janë: *shirku* – pra t'i bësh shok Allahut, dhe *kufri* – mohimi i Tij. Sa u përket të tjerave, robi i ka të hapura dyert e pendimit, arsye për të cilën nuk duhet të vdesë pa u penduar, se përndryshe do të ndëshkohet. Mirëpo, edhe nëse vdes pa u penduar ka dënim me zjarr, por jo të përhershëm.

Ndëshkimet e mëkateve mund t'i ndajmë në dy pjesë:

a) Ndëshkimet që bëhen në këtë botë – *dunjevijj*. Ka mëkate që mund të fshihen nëpërmjet keffaretit. Për shembull, nëse dikush prish një ditë agjërimi dhe më vonë pendohet, si ndëshkim ai ka të drejtë që të bëjë zgjedhjen e njëres nga këto mundësi: 1) Lirim e një robi. 2) Agjërimitin e dy muajve pa e ndërprerë. 3) Ushqyerja e gjashtëdhjetë të varfërve<sup>9</sup>. Mund të përmendim edhe ndëshkimin që quhet **el-haddu** – ndëshkim, i cili parashikon tetëdhjetë apo njëqind të rëna (varësisht nga pesha e mëkatit).

b) Ndëshkimet që bëhen në botën tjetër – *uhrevijj*: Këto ndëshkime mbeten në kompetencën e Allahut, i Cili fal ose e ndëshkon nëse do.<sup>10</sup>

9. Prof. Vehbi Zuhejli, vëll. III, f. 210 (verzióni në turqishtë); Prof. Dr. Hamdi Döndüren, "Delilleryle İslam İlmihali", f. 557, İstanbul 2007.

10. Për më shumë në gjuhën shqipe, shih; Mr. Flamur Sofiu, "Fikhu 4"; Këtu janë cekur detajisht gjërat që kanë të bëjnë me gjendjen e mëkatarit dhe me dënimet.

Me gjithë këto masa ndëshkimore që vijnë si kundërpërgjigje ndaj mëkateve, Krijuesi ynë ua ka lënë të hapura dyert e pendimit robërve të Tij- "**et-tevbetu**". Çdo mysliman që gabon dhe dëshiron të kërkojë falje tek Mëshiruesi, mund ta bëjë këtë në çdo kohë, me shpresën se Allahu do ta falë. Pendimin duhet ta kemi të përditshëm, ngase edhe Pejgamberi (a.s.) është penduar më shumë se shtatëdhjetë apo edhe njëqind herë në ditë. Në këtë kontekst Allahu (xh.sh.) thotë: "**O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t'ju shlyejë gabimet e t'ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, Ditën, kur Allahu nuk do ta turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me atë. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: "O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë."**<sup>11</sup> Pastaj vjen ajeti tjetër që na jep shpresa edhe më të mëdha: **Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti."**<sup>12</sup> Pasi lexon këtë përgëzim mahnitës, besimtari mysliman duhet ta kuptojë rëndësinë e pendimit, duhet ta kuptojë të keqen që i sjellin mëkatet, haramet e të gjitha veprat e liga. Por duhet pasur kujdes se edhe pendimi i ka ca kushte që duhen plotësuar, se përndryshe asnjë pendim nuk do mund të jetë efektiv. E edhe më keq akoma, kur njeriu mendon se është penduar, teksa çështja mund të qëndrojë ndryshe. Kështu, njeriu duhet të pendohet sinqerisht, të mos e kryejë më veprën për të cilën ka shprehur pendesë, por njëkohësisht të mos kryejë as mëkate të tjera.

Pejgamberi (a.s.) i ka këshilluar gjithmonë shokët e tij që të kenë kujdes nga mëkatet, por të mos afrohen as afër njerëzve që janë mëkatarë, ngase njeriu mund të ndikohet shpejt nga veprat e liga. Mëkati e zbeh fuqinë krijuese e personalitetin e njeriut, dhe e hedh atë në një humnerë aq të errët, sa nëse ai nuk i kthehet Allahut, nuk do të mund të gjejë asnjëherë shpëtim. Kurani ynë Fisnik është kushtetuta më e mirë e jetës sonë, sepse vë në mbrojtje të gjitha të drejtat dhe interesat njerëzore. Ai i kushton një rëndësi të veçantë pesë gjërave kryesore: jetës, mendjes, pasurisë, fesë dhe brezit.<sup>13</sup> Të gjitha

11. Tahrîm, 66/8.

12. Zumer, 39/53.

13. Prof. Dr. Hajreddin Karaman, "Lamtumira e Udhëtarit të Përhershëm" përkth. Z. Ramadani. Stamboll 2008. f. 17.

këto kanë lidhje të ngushtë me mëkatën e bërë, sepse me kryerjen e mëkateve edhe këto pesë parime të rëndësishme zbehen dalëngadalë.

Besimtari mysliman duhet të tregojë kujdes ndaj sjelljeve të përditshme në çdo hap të tij. Ai ka lindur i pastër si loti dhe duhet ta pasurojë jetën e tij me vepër të shëndosha që i sjellin dobi. Kur vjen në këtë botë, njeriu është pothuajse si një kasetë boshe. Çdo çast i jetës shënohet në atë kasetë. Përmes urdhërit *“Ikre’ Kitâbeke – Lexoje librin tënd”*, ajo kasetë do të hapet para teje dhe do të shfaqë tërë skenarin njerëzor. Kështu, çdo njeri që mundohet të fitojë lumturinë e kësaj bote e të botës tjetër, është i obliguar ta mbushë shpirtin me begatitë pjellore të Kuranit. Sepse, nëse gatuhet me Kuran, shpirti fiton shkallën më të bukur të krijimtari-së, pra *“Ahsenu’t-Takvîm”*. Nëse do që të kesh dobi të pafundme nga Kurani, duhet të fillosh të jetosh si një Kuran i gjallë. Atëherë, për shkak të saj njeriu i shemb dhe i verbon gjërat negative. Duke zbuluar vështirësitë, ai vjen në një gjendje të shëndoshë që i është dhuruar nga Allahu mëkatfalës.<sup>14</sup>

Gjatë të gjitha lëvizjeve që bën njeriu, në krahun e djathtë e të majtë ai i ka dy melekë që shënojnë vazhdimisht veprat e tij të mira e të këqija. Këta melekë – engjëj janë të urdhëruar nga Allahu (xh.sh.), që të jenë shoqëruar të çdo njeriu në çdo kohë e vend, si dhe ta paraqesin gjendjen e tij tek Ai. Këta janë *“kirâmen kâtibîn”*; *“Kurse ndaj jush kanë përcjellësit! Janë shkruar të ndershëm te Allahu. Ata e dinë se çka punoni”*.<sup>15</sup> Nga kjo kuptojmë se ne jemi gjithmonë në përcjellje të Allahut (xh.sh.), andaj syri ynë, veshi ynë, këmba jonë etj., të gjitha këto do të mbajnë përgjegjësi për atë që kanë vepruar. Mirëpo Allahu me mëshirën e Tij të madhe i lë njerëzit të lirë: *“Sikur Allahu t’i dënonte njerëzit sipas veprave që bëjnë, nuk do të mbetej në sipërfaqen e Tokës asgjë e gjallë, por Ai i shtyn ata deri në afatin e caktuar dhe, kur t’u vijë afati i tyre, ata do ta dinë se Allahu i mbikqyr mirë robërit e Vet.”*<sup>16</sup> Ai i mbron ata nga të ligat, u jep afat që të kenë mundësi të drejtohen në rrugën e shenjtë, rrugë e cila vlerëson të drejtin, jo të pasurin e të fortin. Ndërsa, nëse një rob futet në mëkate, ai do ta hidhërojë Allahun. Në lidhje me këtë Pejgamberi (a.s.) thotë:

14. Osman Nuri Topbaş, *“Gönül İkliminden Damladan Deryaya”* f. 29. Stamboll 2008.

15. Infitâr, 82/10-12.

16. Fâtir, 35/45.




*“Allahu i Madhëruar hidhërohet dhe ka zili. Zilia e tij është për shkak të veprimit të haramëve që bën robi i Tij.”*<sup>17</sup>

### *Përmbyllje*

Është e nevojshme të bëjmë të ditur se, meqë theksuam më sipër se islami është një fe, e cila në radhë të parë mbron dinjitetin e njeriut, po ashtu ai ka në thelbin e tij ligje që përbëhen prej normash e vendimesh të nxjerrra nga Kurani. Kjo është shkence e Usul-i Fikhu-t. Në kuadër të kësaj shkence, si degë e rëndësishme që ndalon mundësinë dhe mbyll rrugët e mëkatit është edhe *“Seddu’dh-Dheria– Parandalimi i ardhjes deri tek e keqja”*. Mund të japim përsëri rastin e zinasë – prostitucionit, në lidhje me të cilën, Allahu, përveç se e ndalon një veprë të tillë të shëmtuar, thotë *“Mos iu afroni asaj”*. Si përmbyllje për gjithë sa thamë, të gjitha mëkatet e bëra, qofshin të vogla apo të mëdha, të fshehta apo të hapura, ato e largojnë njeriun nga krijuesi, nga Allahu i Madhëruar. Në të kundërtën e kësaj, çdo veprë e mirë, çdo lutje që i bëhet Allahut (xh.sh.), çdo hap i yni që është në përputhje me vullnetin e krijuesit tonë, e afron njeriun edhe më shumë drejt Tij. Në këtë mënyrë, njeriu i hapet edhe më tepër horizonti, në mënyrë që të mund ta shohë të vërtetën e ta shijojë dhuntinë e Allahut.

17. Buhârî, *“Nikâh”*, 107; Muslim, *“Tevbe”*, 36. etj.



# Një Ajet

*Me emrin e Allahut,  
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

**“Atë, xhenetin ua kemi përcaktuar atyre që nuk dëshirojnë madhështi dhe nuk bëjnë arrogancë në tokë. Përfundimi i këndshëm u takon atyre që i frikësohen Allahut.”** (Kasas /83)

*Mendjemadhësia* është vlerësimi i tepruar i aftësive personale, ndërsa *mendjemadh* është ai të cilit i pëlqen shumë mendja e vet dhe nuk pranon e nuk përfill mendimin e të tjerëve, por shfaq sjellje arrogance ndaj tyre. Përkundrajt kësaj qëndron *përvullësia*, *butësia* dhe *modestia*. Mendjemadhësia mund të shfaqet në forma të ndryshme, si për shembull origjina, përkatësia fisnore, pasuria, fuqia, forca fizike, bukuria, të mësuarit e dituria, statusi social e arritjet personale. Madje mendjemadhësia mund të shfaqet edhe në shërbimin e tepruar ndaj Zotit. Tipi më i keq i kryelartësisë është ajo që shprehet ndaj Zotit, ndaj të Dërguarit të Tij dhe ndaj fesë.

Në ajetin e mësipërm shprehet qartë se një nga kushtet për të fituar xhenetin është të mosqenit mendjemadhënj e arrogantë ndaj njerëzve. Kjo arrihet duke besuar Allahun në mënyrën më të sinqertë dhe duke iu bindur pa asnjë mëdyshje urdhërave dhe vullnetit të Tij, duke mos shpalosur as më të voglën shenjë madhështie ndaj Allahut dhe krijesave të Tij. Ishte pikërisht kjo ndjenjë madhështie ajo që shfaqti shejtani, i cili për këtë arsye meritoi mallkimin e Allahut, duke e humbur kështu njëherë e përgjithmonë mundësinë për t’u përfshirë nga mëshira e Allahut. Në një ajet tjetër, duke na urdhëruar që të mos mburremi, Allahu thotë:

**“Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet.”** (Lokman/18)

Kur njeriu e zbraz zemrën nga ndjenja e besimit që ekziston në mënyrë të natyrshme në zemrën e tij, ai fillon të pushtohet nga ndjenja e madhësisë dhe kryelartësisë, aq sa çdo të mirë që zotëron, si fjala vjen pasuria, fuqia, pushteti, bukuria, ia dedikon aftësive të veta personale. Sikur të arrinte të kuptonte se të gjitha ato të mira i janë dhënë nga Allahu, në mënyrë që të bëhej i vetëdijshëm për pafuqinë dhe dobësinë e tij përballë fuqisë së Allahut, do të sillej në mënyrë modeste me njerëzit, pa treguar as shenjë më të vogël të mendjemadhësisë. Kush e harron këtë fakt të rëndësishëm, nuk bën gjë tjetër vetëm se përsërit gabimet që kanë bërë faraoni dhe Karuni, të cilët jepen si modele dhe shembuj të këqinj sa i përket shfaqjes së mendjemadhësisë dhe të arrogancës në tokë. Allahu i dha Karunit begati të shumta, si pasuri dhe pushtet, por në vend që të falënderonte Allahun për mirësitë e dhëna dhe t’i shpenzonte për bamirësi, ai u përfshi nga ndjenja e madhësisë dhe arrogancës.

Por si ishte përfundimi i tij? Allahu thotë në Kuran:


**“Dhe për këtë arsye, Ne e fundosëm thellë në tokë atë edhe pallatin e tij, dhe nuk pati askënd që ta ndihmonte dhe as veten e tij nuk mundi të mbronte përballë Allahut.”** (Kasas, 81)

Përfundimi i këndshëm dhe i lumtur është për ata që janë modestë dhe të sjellshëm me njerëzit.

Allahu ka thënë në Kuranin famëlartë: **“...e s’ka dyshim se te Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)....”** (el-Huxhurat, 13)

# Një Hadith

## Resulullahu sallallahu alejhi ve sellem ka thënë:



*“Kush ka në zemër qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie, ai nuk do të hyjë në xhenet”.* Pas kësaj, një i pranishëm e pyeti: *Po personi që dëshiron të vishet bukur dhe të duket bukur? Pejgamberi iu përgjigj: “Allahu është i bukur dhe e do të bukurën, kurse mendjemadhësia është mohimi i së vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve të tjerë”.* (Muslimi)

Mendjemadhësia është kryelartësi dhe shfaqje e ndjenjave të madhështisë, mirëpo madhështia i takon vetëm Allahut. Ai është më i madhi. Të pretendosh një cilësi që i takon vetëm Atij, kjo nuk është gjë tjetër veçse tejkalimi i kufijve të përcaktuar. Mendjemadhësia është një prej mëkateve që shkaktojnë hidhërimin e Allahut.

Njeriu duhet të kultivojë thellë në ndërgjegjen e tij ndjenjën se përpara Allahut është një qenie e dobët, e krijuar prej balte. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm që Allahu na ka krijuar për të jetuar në tokë, por çdo gjë që gjendet në të i përket vetëm Atij. Nëse Allahu na ka dhënë ndonjë të mirë, ajo nuk duhet të bëhet shkak për mendjemadhësi, duke ia mvëshur meritat aftësive personale, përkundrazi duhet të bëhet shkak për ta falënderuar më shumë Allahun për të mirat që na ka dhuruar.

Në hadith theksohet se ai, i cili ka mendjemadhësi qoftë edhe sa një grimcë e vogël, nuk do të hyjë në xhenet. Mendjemadhësia është dy llojesh: mendjemadhësi që bëhet pengesë për besimin në një Zot, dhe mendjemadhësi që nuk e pengon besimin në zemrën e njeriut. Personi që i përket llojit të parë të mendjemadhësisë është në mënyrë absolute në xhehenem, ndërsa ai që i përket llojit të dytë të mendjemadhësisë do të dënohet deri sa të shërohet plotësisht nga kjo sëmundje e keqe, për t’u futur pastaj në xhenet; ose nuk do të dënohet fare, duke u mëshiruar nga Allahu për besimin që ka pasur. Muhamedi (a.s.) ka thënë:

*“Nuk do të hyjë në xhehenem, ai i cili ka në zemrën e tij qoftë edhe një grimcë besimi.”*

Nga hadithi mësojmë gjithashtu se veshja e bukur e me sharm nuk është shenjë mendjemadhësie, sepse Allahu i Lartmadhëruar është i bukur dhe e do të bukurën. Sahabiu e pyeti të Dërguarin (a.s.) për të mësuar nëse veshja bukur buron nga mendjemadhësia apo jo. Pejgamberi (a.s.) e informoi që veshja e bukur nuk buron nga mendjemadhësia, sepse Allahu e do të bukurën, duke qenë se edhe vetë është i bukur dhe dëshiron t’i shikojë gjurmët e begatëve e të mirësive që i ka dhënë robit të Vet. Por, edhe këtu duhet që të kemi kujdes që të mos devijojmë nga qëllimi kryesor. Jo të vishemi bukur për t’u dukur më ndryshe, apo për të tërhequr vëmendjen e njerëzve, por të vishemi bukur që ta mbajmë gjithmonë gjallë ndjenjën e falënderimit për mirësitë që na ka dhënë Allahu i Lartmadhëruar.

### Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nëse mendjemadhësia arrin në atë shkallë sa personi të kundërshojë urdhërat e Allahut, atëherë ai person e ka humbur mundësinë për të hyrë në xhenet.
2. Ata që mburren dhe nënçmojnë të tjerët kanë bërë gjynah të madh.
3. Çdo njeri mund të vishet bukur, me kusht që të mos vishet për mburrje.



# Modestia

**“Moral i bukur”**, i cili lind e gjallohet nga vlerat e besimit, është sekret i që e bën njeriun njeri duke e njohur atë me thelbin e qenies dhe duke e çuar drejt qëllimit final të krijimit të tij.

Pjekuria, virtytet dhe vlerat e vërteta të njeriut janë në përputhje me nivelin e moralit të tij. Për të qenë shërbëtor i Zotit në këtë dynja, në mënyrë që të fitohet kënaqësia e Tij, është e domosdoshme që njeriu të piqet në aspektin kuptimor. Por, në të njëjtën kohë pjekuria kuptimore lidhet ngushtë me **“Edukimin shpirtëror”**.

## MIQTË E ALLAHUT

Ashtu si çdo mjeshtri ka nevojë për një udhërrëfyes, po ashtu edhe mjeshtëria e ndërtimit të një personaliteti të bukur e të fortë ka nevojë për një shembull konkret e të qëndrueshëm, i cili të shndërrohet në pikë orientimi për njeriun. Në rastin konkret, këtë funksion e kryejnë **“Miqtë e Allahut”**. Në krahasim me të tjerët, ata kanë këto epërsi:

- Kanë skalitur në karakterin e tyre gërshetimin e ditu-

rive të dukshme e të padukshme.

- Kanë rrugëtuar në aspektin shpirtëror, duke kaluar shumë stacione të zuhdit e të takvasë, duke u përsosur në veprimet e tyre.

- Shikimin e tyre konceptual e kanë shtrirë në të dy botët, duke arritur kështu në lumturinë e të shijuarit të imanit e në thellimin emocional.

- Të gjitha përpjekjet e tyre janë në shërbim të shpëtimtë njerëzimit nga veset e këqija dhe kurthet e egos. Pra, ata janë të plotësuar në besimin e tyre, duke u bërë vepërmirë e besimdrejtë dhe me plot cilësi të tjera që e lartësojnë njerëzimin në moralin e bukur e në qiejt e dritës.

Ata e kujtojnë Allahun e Lartmadhëruar, sepse bota e tyre shpirtërore është vazhdimisht në kontakt me Atë. Ata që ecin në gjurmët e tyre pajisen me urtësinë e me marifetin e të shikuarit të jetës dhe ngjarjeve të ndryshme nëpërmjet dritares së Ahiretit.

Gjendjet dhe veprimet e miqve të Hakut janë tërësisht në përputhje me vullnetin dhe dëshirën e Tij. Në lidhje me këtë, Hazreti Pejgamberi (a.s.) na bën të ditur se Allahu i Lartmadhëruar ka thënë:

**“...Pasi unë e dua robin Tim, atëherë Unë bëhem gjuha me të cilën ai flet, zemra me të cilën ai mendon, veshi me të cilin ai dëgjon, syri me të cilin ai shikon, dora me të cilën ai bart dhe këmba me të cilën ai ecën...”** (Buhari, Rikak, 38; Mexhmau’z-Zevaid, II. 284)

Moral i njerëzve të Hakut mbart në vetvete rrezatimet shpirtërore të Hazreti Pejgamberit- sallallahu alejhi ve sellem –, i cili ishte edhe komentuesi praktik (me veprime konkrete) i Kuranit Fisnik.

Miqtë e Zotit, të cilët përpiqen me mish e shpirt të

**“Në të vërtetë,  
atyre që besojnë dhe  
bëjnë vepra të mira,  
i Gjithëmëshirshmi do t’u  
dhurojë dashuri.”**

**(Merjem, 96)**

sendërtojnë në mënyrë sa më të përpiktë Sunetin e Diellit të Shpalljes, të Dërguarit të Allahut (a.s.) janë si drita e hënës. Ata janë si pasqyra që reflektojnë qartazi bukuritë e moralit të të Dashurit të Allahut. Prandaj, ata që lidhen me miqtë e Hakut nëpërmjet dashurisë, duke vërejtur me zemër e kujdes të veçantë veprimet dhe gjendjet e tyre do të mund të bëhen dëshmitarë të manifestimeve të holla të moralit profetik.

Si rezultat i sinqeritetit që ata kanë, Allahu i Lartmadhëruar u dhuron në zemra, miqve të Tij, fuqi ndikuese dhe mrekulluese. Kjo sepse ata tregojnë qëndrueshmëri në të jetuarit e asaj që predikojnë. Kështu, me gjendjet dhe veprimet e tyre ata rezultojnë pashmangshmërisht rrezatues e ndikues tek të tjerët, duke u bërë ngado përfaqësuesit më të denjë të mirësjelljes dhe delikatesës islame.

Fjalët që nuk jetojnë, ashtu si dhe veprimet sipërfaqësore që janë larg sinqeritetit, u ngjajnë dhuratave me ambalazh të bukur, por që brenda janë krejt bosh. Përballë furtunave të jetës, këto fjalë e vepra humbin e shuhën, duke mos lënë asnjë gjurmë pas. Sekretet e gjurmëve të pashlyeshme, që miqtë e Allahut lënë në zemrat e njerëzve, është sinqeriteti dhe dashuria e pamatë.

Prandaj, siç shprehet poeti i madh turk, Junus Emre, tasavvufi nuk qëndron tek taxhja, hërka apo në disiplinat e ndryshme të dhikrit, por thelbi i tij është vrapimi për tek Allahu, duke u thelluar shpirtërisht në manifestimet plot urtësi që na ofron universi dhe jeta. E tërë kjo është e mundur vetëm në sajë të perceptimit të të qenit një hiç përballë rrezatimeve të fuqishme e të madhërishtme të Allahut, duke jetuar në çdo frymë me përgjërimin ndaj Tij e duke thënë: **“Të lutem o Zoti im” (Aman ya rabbi).**

Miqtë e Allahut janë gjithandej burim mëshire dhe mi-

rësie. Janë një prehër dhembshurie dhe dashurie për të gjitha shtresat shoqërore. Gjithashtu, ata i tërheqin njerëzit si magnetet nga e vërteta, duke u shndërruar në qendër ndikimi pozitiv. Allahu i Lartmadhëruar i ka pajisur me moralin e Tij, duke i dashur dhe duke i bërë po kaq të dashur edhe tek të tjerët. Në një ajet kuranor thuhet:


**“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.”** (Merjem, 96)

Prandaj miqtë e Allahut nuk harrohen edhe pasi ndërrojnë jetë, sepse vazhdojnë të jetojnë në zemrat e dashamirësve të tyre. Kjo dashuri që Allahu i Lartmadhëruar ua dhuron shpirtërave fatlumë, është një nderim i madh, i cili bëhet shkak për arritjen e të shpëtimit. Hazreti Pejgamberi (a.s.) ka premtuar se në botën tjetër njeriu do të jetë së bashku me atë që do. Përpjekjet për t’iu gjendur afër këtyre njerëzve të veçantë e për t’i dashur për hir të Allahut, e afrojnë njeriun me Zotin e tij.

Në qoftë se ndjejmë dashuri për të dashurit e Allahut dhe nëse dëshirojmë që në botën tjetër të jemi së bashku me ta, atëherë duhet të punojmë që të pajisemi me moralin e tyre të bukur, sepse një nga shenjat e dashurisë është shkrirja e njeriut në gjendjet shpirtërore të atij personi që dashuron. Për t’u pajisur me moralin e të dashurve të Allahut, është e domosdoshme t’i vëzhgojmë me kujdes manifestimet e moralit të bukur tek këta njerëz. Një nga tiparet më dallues të rrezatimit të moralit të bukur tek miqtë e Hakut është:

### **MODESTIA – NJË EDUKATË E LARTË E ROBËRISË NDAJ ALLAHUT**

Robëria ndaj Allahut është para së gjithash çështje vetëdije. Të kuptosh që je një hiç përballë rrezatimeve madhështore e të fuqishme



hyjnore, ashtu siç hymë me dëshirën e Allahut nga mosekzistenca në ekzistencë, duhet të dimë se vetëm me dashjen dhe me ndihmën e Zotit është e mundur që qenia jonë të vazhdojë ekzistimin. Ne i jemi nevojtarë Atij në çdo frymëmarrje, e kjo përbën esencën e robërisë ndaj Allahut. Thënë ndryshe, robëria ndaj Allahut, kjo shkallë kaq e lartë shpirtërore, është e lidhur ngushtë me mundësimin e perceptimit të pozitës sonë të brishtë përballë pushtetit të Allahut të Lartmadhëruar, si dhe me vetëdijësimin në lidhje me kufijtë tanë. E te një njeri që mund ta vërejë me sytë e zemrës këtë të vërtetë, nuk mund të shfaqet mendjemadhësia, egoja, uni dhe dëshirat e tepruara të materiales, por nderimi, respekti dhe edukata. Te ai shfaqet një gjendje falënderimi dhe pëlqimi për gjendjen e robërimit ndaj Zotit, ashtu si një nga miqtë e Allahut, Hydaji, i cili mbështetej tek Allahu duke thënë *"Ti je ai që merr, Ti je ai që jep, Ti je ai që vepron! Çfarë na ke dhënë atë kemi, përtej saj asgjë!"*

Prandaj, themi se ata që nuk kanë modesti nuk mund ta perceptojnë fuqinë dhe madhësinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Hazreti Mevlana këshillon uljen e kokës, për të shprehur modestinë e vërtetë dhe të jetuarit së brendshmi, për të përjetuar ndjenjën e të qenit një hiç përballë fuqisë e pushtetit të Allahut. Ai është shprehur kështu:

*"Unë u bëra rob, u bëra rob, u bëra rob. Unë jam një rob i dobët, pata turp që nuk mund të kryeja tërësisht obligimet e robërisë, prandaj e ula kokën poshtë. Të gjithë robërit gëzohen kur fitojnë lirinë. Ndërsa unë o Zot gëzohem që jam rob – skllavi Yt."*

Njëherë, nipi i Hazreti Pejgamberit, Hazreti Hasa-



ni, pasi bëri tavaf Qaben dhe pasi fali dy rekat në Makamin Ibrahim, iu lut Allahut me gjithë shpirt:

*"Ja Rabbi (o Zoti im)! Të erdhi në derën tënde rob i dobët! O Allahu im! Të erdhi në derë shërbëtori Yt i pafuqishëm! Ja Rabbi! Të erdhi në derën Tënde lypsari Yt! Të erdhi në derën Tënde i varfëri Yt!.."*

Pasi Hazreti Hasani u largua prej aty, hasi në rrugë disa të varfër që përpiqeshin të ngopeshin me një copë bukë. Ai u dha atyre selam! Ata e ftuan Hazreti Hasanin që të ndanin me të ushqimin që Allahu u kishte bërë rrisht për të ngrënë atë ditë. Nipi i Hazreti Pejgamberit, Hazreti Hasani u ul pranë tyre dhe u tha: *"Sikur ta dija që kjo që ju po hani nuk është sadaka, do të haja së bashku me ju."*

Më pas atyre u tha: *"Ngrihuni të shkojmë në shtëpinë tonë!"*

Pasi i ushquu ata njerëz të varfër, u dha rroba e një shumë të hollash. Pastaj i përcolli përzemërsisht." (Ebshih, *el-Mustatraf*, Bejrut 1986, I, 31)

Ja pra, kjo është një modesti e vërtetë, një edukatë e lartë robërie që e bën besimtarin të jetojë me dashuri të thellë për Zotin e për krijesat e Tij. Ata që do të mund ta skalisin mirë në personalitetin e tyre këtë edukatë, do të jenë shumë të matur dhe të kujdesshëm në çdo gjendje dhe në çdo veprim të tyre. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë në Kuranin famëlartë:

*"Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë..."* (el-Furkan, 63)

*"Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve."* (el-Isra, 37)

*"Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendje-*

**“Mos ec nëpër tokë  
me mendjemadhësi, se ti,  
në të vërtetë, nuk mund  
ta çash tokën e as të arrish  
lartësinë e maleve.”**

**(el-Isra, 37)**

***mëdhenjtë e mburracakët!***” (Lukman, 18)

Në këto ajete kuranore është ndaluar të ecet në tokë me mendjemadhësi e me sjellje të ndryshme që tregojnë sadopak kryelartësi. Hazreti Pejgamberi (a.s.) ecte shpejt si të ishte në një tatëpjetë, por kokëulur, e kështu ai zotëri tregonte edukatën e tij të modestisë.

Të ecësh duke parë majat e gishtave të këmbës tregon modesti, edukatë, maturi, ruajtje të syrit nga harami, lidhje të besimtarit me urdhëresat e Allahut të Lartmadhëruar dhe ato të të Dërguarit të Tij (a.s.).

Jo vetëm në ecje, por edhe shprehja e modestisë në çdo gjendje e veprim bëhet shkak për të fituar dashurinë e Allahut.

Në një hadith, Hazreti Pejgamberi është shprehur:

*“...Allahu do ta lartësojë atë që tregon modesti për hir të Tij dhe do ta poshtërojë atë që tregohet mendjemadh...”* (Hejsemi, X, 325)

Një nga miqtë e Allahut, Hazreti Mevlana, me siguri pasi kishte kuptuar sekretin e modestisë, në lidhje me të na këshillon të bëhemi si dheu:

*“Allahu urdhëroi: ‘O njeri, shiko me kujdes e vëre në trupit tënd, që e krijova nga dheu mbolla një farë nga shpirti im, e kështu e lartësova. Ti ishe pluhur i kësaj toke e mbi të gjitha krijesat, të lartësova ty. Të dhurova mendjen e të dhashë dashuri. Ti bëj një përpjekje e në vetvete mbill modestinë që Unë ta vë çdo gjë nën urdhrin tënd.’”*

Kurse Sadi-i Shiraziu, për të na tërhequr vëmendjen drejt modestisë, si një ndër sekretet e lartësimit shpirtëror, na flet për urtësinë e ujit:

*“Përmbytjes nga vërshimi i saj mendjemadh i imponohet të ulë kokën e të ecë duke u zvarritur përtokë! Ndërsa pikën e vesës, prej se është e vogël dhe e pafuqishme,*

*dielli e lartëson me dashurinë e tij.”*

Modestia që Allahu i Lartmadhëruar dëshiron të shohë tek njeriu është shkak i shumë mirësive. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë në një ajet kuranor:

*“Dhe jepu lajme të mira atyre që janë të përlulur, atyre, zemrat e të cilëve frikësohen, kur përmendet Allahu, që (janë) të durueshëm për gjithçka që i godet, që falin namazet dhe që ndajnë nga ajo, që Ne ua kemi dhënë.”* (El-Haxh, 34-35)

Prandaj, sinqeriteti dhe modestia janë të një rëndësie themelore për plotësimin deri në përsosje të përgjegjësive tona të robërimit ndaj Hakut.

### **SHPATA PRET QAFËN E KRYELARTIT**

Njerëzit që qëndrojnë larg egos dhe unit, pra modestët, janë të siguruar nga shumë rreziqe shpirtërore. Këtë të vërtetë Hazreti Mevlana na e shpjegon nëpërmjet kësaj ngjashmërie:

*“Shpata pret qafën e kryelartit..., ndërsa hijen nuk është e zonja ta presë asnjë shpatë, sepse është shtrirë për tokë dhe është bërë njësh me të.”*

Modestia e vërtetë që e lartëson njeriun, bëhet shkak për urtësimin dhe për thellimin shpirtëror të tij. Në Methnevi thuhet shprehimisht:

*“Si rezultat i modestisë, edhe nëse së jashtëmi zvogëlohesh, Allahu të rrit së brendshmi e t’i hap sytë e zemrës, duke të të dhuruar mundësinë të shohësh thelbin e çdo gjëje. Kështu ia arrin fatlumësisë së hadithit, që thotë: «O Zoti im, na i shfaq të vërtetat e gjërave ashtu siç janë në të vërtetë!»”*

Modestia bën të mundur të lindet mëshira, shërbimi dhe bujaria. Një njeri modest është hyzmeqar, i më-



shirshëm e i dhembshur. Në të kundërt, ata që nuk kanë modesi janë mendjemëdhenj, kopracë dhe të privuar nga mirësitë e Allahut.

Në veprën *“el- Bahru’l-Mevrud”*, Imam Sharani është shprehur:

*Në kuvendimet shpirtërore përfitojnë më tepër njerëzit modestë e të thjeshtë. Kjo sepse mëshira hyjnore zbrit në zemrat e atyre që janë modestë e të thjeshtë. A nuk i shihni që ujërat e shiut mblidhen vazhdimisht nëpër gropa e fusha dhe rrjedhin në përrenj!”*

## MODESTIA E PEJGAMBERIT TONË TË DASHUR

Hazreti Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

***“Allahu i Lartmadhëruar më shpalli: ‘Jini deri në atë masë modestë ndaj njeri tjetrit, sa asnjëri nga ju të mos i kalojë kufijtë e tij duke i bërë vëllaut të vet ndonjë padrejtësi. Gjthashtu, asnjëri prej jush të mos mburret para të tjerëve duke e parë veten mbi të tjerët”*** (Muslim, Xhenet, 64)

Hazreti Pejgamberi (a.s.) , i cili ishte dërguar për të përsosur moralin e bukur, i përgjigjej ftesës së skllëvërve, i mbante afër, pranonte dhuratat e tyre, qofshin ato edhe edhe dy pika qumësht, e dhuratave të tyre u përgjigjej po me dhurata. Ai tregojte shumë kujdesshëm ndaj kërkesave dhe nevojave të individëve që i përkisnin shtresave të lodhura të shoqërisë.

Kur Hazreti Pejgamberi (a.s.) u nis bashkë me sahabet e tij drejt Bedrit, numri i deveve në dispozicion nuk ishte i mjaftueshëm, prandaj ata ishin të detyruar që të përdornin një deve të vetme për tre persona, duke hipur e zbritur me radhë. Hazreti Pejgamberi – sallahu alejhi ve sellem - udhëtoi me të njëjtën deve me Hazreti Aliun dhe Ebu

**“Mos m’i rritni vlerat mbi atë që meritoj! Allahu i Lartmadhëruar, përpara se të më bënte të “Dërguarin e Tij” më ka bërë “Robin (shërbëtorin) e Tij”.**

(Hejsemi, IX, 21)

Luhabe – radijallahu anhum - . Kur i erdhi radha Hazreti Pejgamberit (a.s.) të ecte në këmbë dy shokët i tij i thanë

*“O i Dërguari i Allahut! Ju lutem mos zbrisni! Ne dëshirojmë të ecim edhe për ty”,* Pejgamberi (a.s.) u përgjigj:

*“Ju nuk do të mund t’i rezistoni ecjes më shumë se unë. Pastaj, unë nuk është se kam më pak nevojë se ju të fitojë sevape.”* (Ibn-i Sa’d, II, 21)

Ngadhënjimi i Mekës ishte fitorja më e madhe që Allahu u dhuroi myslimanëve pas 20 vitesh vuajtjesh e padrejtësish. Mirëpo, i Dërguari i Allahut (a.s.) për të mos i lënë asnjë grimce të egos së tij mundësi zhvillimi, i bëri menjëherë sexhde Allahut, e duke qenë mbi deve u shpreh:

*“O Allah! Jeta e vërtetë është vetëm ajo e Ahiretit!”* (Vakidi, II, 824; Buhari, Rikak, 1)

Në ditën e çlirimit të Mekës tek Hazreti Pejgamberi (a.s.) , tërë frikë dhe duke u dridhur nga emocioni, erdhi një bashkëvendës i Profetit dhe e pyeti:

*“O i Dërguari i Allahut! Më mëso si mund të hy në islam!”*

Për ta qetësuar, Hazreti Pejgamberi (a.s.) i tha me modesti:

*“Qetësohu o vëllai im! Unë nuk jam mbret apo sundimtar! (Duke pasur për qëllim nënën e vet) Jam jetimi i komshies tënde, e cila i përkiste fisit të kurejshëve dhe që gjatë jetës së saj ka ngrënë mish të tharë në rreze të diellit!..”<sup>1</sup>*

Ditën ku Hazreti Ebu Bekri kishte sjellë mbi kurriz baibain e tij, shumë të shtyrë në moshë, që ai të pranonte islam në prezencën e Hazreti Pejgamberit (a.s.) , ky i

1. Shih Ibn Maxhe, Et’ime, 30; Taberani, el-Mu’ xhemu’l-Evsat, II, 64.



fundit i pati thënë Hazreti Ebu Bekrit, mikut të tij më të ngushtë:

*“O Ebu Bekër! Po pse ia dhe rrugën deri këtu babait tënd të moshuar? A nuk mund të shkonim ne tek ai?!”*

Të gjithë atyre që tregonin respekt të tepruar ndaj tij, Hazreti Pejgamberi (a.s.) u thoshte:

*“Mos m’i rritni vlerat mbi atë që meritoj! Allahu i Lartmadhëruar, përpara se të më bënte të ‘Dërguarin e Tij’ më ka bërë ‘Robin (shërbëtorin) e Tij’.”* (Hejsemi, IX, 21)

## MODESTIA E SAHABEVE

Brezi i sahabeve që u edukua nga Hazreti Pejgamberi (a.s.), mori hisen e vet nga gjendjet e modestisë së të Dërguarit të Allahut.

Kur Hazreti Ebu Bekri (r.a.), në lidhje me të cilin jo më Hazreti Pejgamberi (a.s.) ka thënë: *“Ebu Bekri është prej meje, e unë jam prej tij...”*, u zgjodh halife, edhe pse nuk i mungonin aftësitë e plota për të kryer këtë detyrë të vështirë, në hutben e tij të parë u shpreh: *“O njerëz, mua më zgjodhën halife edhe pa qenë më i miri në mesin tuaj.”* Kështu, ai u tregua modest, duke shpresuar tek Allahu i Lartmadhëruar dhe te mirësia e Tij.

Një ditë, kur Selmani (r.a.) ishte vali në Median, nga Shami erdhi një tregtar. Tek po kërkonte një hamall që t’ia lëshonte ngarkesën, ai takoi rastësisht në rrugë Selmanin (r.a.). Duke mos e njohur Selmanin, ai iu drejtua me fjalët: *“Eja e ma mbaj pak këtë ngarkesë!”*

Selamani (r.a.) e vuri menjëherë mbi shpinë barrën e tregtarit. Duke parë se ngarkesën e tregtarit po e mban-te mbi shpinë vali i zonës, njerëzit nxituan menjëherë t’ia shpjegonin situatën tregtarit.

Tregtari nga Shami i kërkoi të falur valiut dhe deshi

t’ia merrte ngarkesën, por Selmani (r.a.) iu përgjigj:

- Nuk ka asnjë problem. Nuk do ta ul këtë ngarkesë nga shpina, derisa ta kem çuar në shtëpinë tënde.

Muezini i Hazreti Pejgamberit, Bilali (r.a.) ishte i zi në ngjyrë. Ebu Zer (r.a.) në një çast acarimi iu drejtua me fjalët: *“O ti, i biri i të zezës!”*. Hazreti Pejgamberi (a.s.) u zemërua shumë kur dëgjoji këto fjalë. Transmetohet se Ma’rur bin Suvejd ka thënë kështu në lidhje me ndryshimin e madh që Ebu Zer (r.a.) ka bërë më pas:

*“Unë pashë një ditë Ebu Zerrin të veshur me një rrobë shumë të mirë. Të njëjtën rrobë kishte edhe hyzmeqari i tij. E pyeta për arsyen e kësaj. Ai më sqaroi se një ditë ai kishte ofenduar nga nëna një person dhe e kishte e bërë atë të ndihej keq. Pas kësaj, Hazreti Pejgamberi (a.s.) ishte shprehur:*

*“Ti je një njeri, tek i cili akoma vazhdojnë të jenë të pranishme veset e periudhës së injorancës. Ato janë hyzmeqarët tuaj e në të njëjtën kohë vëllezërit tuaj. Allahu i Lartmadhëruar jua ka besuar juve strehimin e tyre. Kush ka nën përkujdesje ndonjë nga vëllezërit e tij, duhet ta ushqejë atë me çka ushqehet edhe vetë dhe gjithashtu t’ia sigurojë veshmbathjen ashtu si vetes së tij. Mos t’i ngarkojë ata me më shumë detyrime nga ç’janë të aftë të bëjnë. E nëse janë të detyruar ta bëjnë këtë, atëherë duhet t’i ndihmojnë praktikisht ata.”*

## MATURIA NË MODESTI

Teprimi në modesti e shpie njeriun në shkatërrim, indirekt në mendjemadhësi. Modestia e vërtetë është kapitali i njerëzve të urtë e me nivel të lartë shpirtëror. Të paraqiturit si modest pa qenë i tillë, është

2. Shih Ahmed, VI, 349; Hejsemi, VI, 174; Ibn Sa’d, V, 451.

rroba ku fshihet mendjemadhësia dhe servilizmi.

Sa bukur e ka thënë Shejh Sadiu në veprën e tij:

*“Ai që pandeh se ka diçka në thelbin e tij, duke u krahasuar me lajthinë, është si qepa prej së cilës dalin vetëm lëvzoha.”*

Shprehjet e atyre që nuk kanë vlera të vërteta modestie janë shembuj tipik të hipokrizisë.

Ashtu si degët e pemëve, frutat e pjekura të cilave bien poshtë dhe ushqejnë me bujari njerëzit, ashtu edhe njerëzit e ditur, të urtë, të zgjuar e të zgjedhur janë modestë e bujarë ndaj njerëzve. Kështu që njeriu duhet ta shndërrojë veten në një thesar prej të cilit përfitojnë të gjitha krijesat, e jo të përpiqet të bëjë famë me madhështi artificiale.

Ka prej atyre që, për të ngopur egon e tyre sillen në atë formë sa të tjerët të thonë: “Sa njeri modest është filani”. Ky veprim kaq sipërfaqësor nuk është gjë tjetër veçse mendjemadhësi e shprehur nëpërmjet modestisë. Për shembull, fjalë të tilla si: *Unë jam një fakir e nevojtar, por kam mundur të bëj këto vepra të mira, bëj çdo ditë këto adhurime etj.*, janë mirëfilli manifestime të egos nën perden e modestisë. Hazreti Hasan Basriu ka thënë:

*“Ai që qorton së tepërmi veten e tij mes të tjerëve, në të vërtetë e ka lëvduar veten, e kjo është një ndër shenjat e dyftyrësisë.”*

Prandaj, mund të themi se edhe modestia e tepëruar është e rrezikshme. Mendjemadhësia është një ngjitje lart në mënyrë ireale, që miklon egon dhe mbytet shpirtin e njeriut. Në lidhje me këtë temë, Hazreti Mevlana na tërheq vëmendjen kështu:

*“Ji modest si një skllav dhe*



*ec në tokë si një kalë. Mos u përpiq të ngjitesh duke ecur si një arkivol mbi supet e njerëzve. Nefsi yt u faraonizua prej lëvdatave të tepërta. Bëhu njeri i thjeshtë; sado i madh që të jesh, mos u paraqit si i tillë!”*

Modestia e vërtetë qëndron në makamin e robërisë së plotë ndaj Allahut dhe në të qenit i arsyeshëm e i drejtë përballë njerëzve. Pra, të pranosh vogëlsinë tënde dhe të metat tuaja duke iu përkushtuar me sinqeritet të plotë zbatimit të urdhrave të Allahut të Lartmadhëruar, por gjithashtu të tregohesh i kujdesshëm ndaj të drejtave të njerëzve e t'i pranosh fjalët e tyre kur janë të vërteta, pa rënë në debate të kota, të mbushura me inate e mendjemadhësi. Fudajl bin Ijaz – rahmetullahi alejh – ka thënë:

*“Modesti do të thotë të përkulesh e ta pranosh të vërtetën, edhe nëse e dëgjon atë nga një fëmijë apo nga një injorant (xhahil).”*

## MODESTIA NË EDUKIMIN SHPIRTËROR

Një fjalë e urtë thotë: *“Modestia i ngjan një gjuetari që gjuan nder.”* Me të vëtetë për t'u lartësuar shpirtërisht, për të fituar nder dhe për të ngjitur shkallët e lartësisë nuk ka asnjë mjet më të efektshëm se modestia. Të kundërtën e kësaj, kultivimin e mendjemadhësisë dhe egos, Allahu i Lartmadhëruar e dënon. Hazreti Ebu Bekri – radjallahu anhu – ka thënë:

*“Njeriun që krenohet me një gjë të kësaj bote, Allahu i Lartmadhëruar e urren deri sa ajo gjë t'i ikë duarsh.”*

Edukimi shpirtëror fillon së pari me pastrimin e egos. Veset që shqiten më me vështirësi nga karakteri i njeriut janë mendjemadhësia dhe egoja. Një nga sufijtë e parë, Ebu Hashim es-Sufi ka thënë:

*“Të gërmosh në mendjemadhësinë që ka mbirë te një zemër, është njësoj si të gërmosh me një mal duke për-*

*dorur gjilpërën.”*

Megjithatë, kjo nuk duhet kuptuar si një gjë e pamundur për t'u bërë, sepse përndryshe qëllimi i fesë për të realizuar njeriun e përsosur do të ishte i kotë. Hazreti Mevlana ka thënë:

*“Nëse një njeri kapërcen veten duke arritur në gjendjen e të qenit një hiç dhe kjo gjendje hiçi e zbukuron shpirtin e tij, atëherë as atij, sikundër dhe Hazreti Muhamedit (a.s.) , nuk i mbetet asnjë hije. Kjo do të thotë se ai shpëton nga realiteti imagjinar dhe realiteti i hijeve.”*

Sa fatkeqësi e madhe është për qenien njerëzore të pretendojë egoizëm dhe mendjemadhësi, ndërkohë që vjen nga asgjëja e nuk është tjetër veçse një hiç. Të gjitha sukseset materiale dhe kënaqësitë egoiste janë vetëm kurthe që e shtyjnë njeriun drejt pavetëdijes. Njerëzit mendjemëdhenj që bien në këto kurthe u ngajnë peshqve të cilët, për shkak të kënaqësisë së çastit të një karremi bien në grep dhe bëhen viktimë të përjetshme. Sa bukur e shpjegon Hazreti Mevlana këtë:

*“Qenia dhe egoja (uni) e dehin shumë njeriun; ia marrin edhe mendjen edhe turpin. Shejtani ra në të tillë dehje, prandaj u shpreh: ‘Pse Ademi të jetë më i madh se unë, pse ai të jetë shefi im?’ Kështu ai meritoi mallkimin.”*

Prandaj, fatkeqësia e mendjemadhësisë dhe e egoizmit duhet të shqitet nga thellësitë e njeriut. Kjo detyrë është themelore në jetën e kësaj bote. Hazreti Hasan Basriu ka thënë:

*“Modesti do të thotë të pranosh çdo mysliman me të cilin takohesh si më të mirë se veten tënde.”*

Në vitet e para të rrugëtimit të tij shpirtëror, mbreti i arifëve, Hazreti Nakshibendi ka pastruar rrugët ku kalonin njerëzit, u ka shërbyer të sëmurëve, të pafuqishmëve, madje edhe kafshëve të plagosura (që kishin ndonjë plagë në trup). Ai ka pohuar se shumë grada të larta shpirtërore i ka arritur gjatë kësaj rruge, duke u bërë hiç dhe duke kultivuar modestinë. Sa bukur i ka shprehur ai përjetimet e tij shpirtërore përmes këtyre vargjeve plot kuptim:

*Gjithësia është grurë, ndërsa unë kashtë  
(Çdo gjë është grurë, ndërsa unë i shkreti kashtë.  
Gjithësia është e plotë e unë i mangët.  
(Çdo gjë është e përsosur, ndërsa unë i mangët).*

Nëse një person arrin në këtë nivel perceptimi, atëherë mund të thuhet se ai ka hyrë në rrugën e zhvillimit shpirtëror. Ato që kanë arritur në këtë nivel shpirtëror, Hazreti Mevlana u flet kështu:

*“Nëse do të rrëzohesh rrugës, do të ta hapin atë. Nëse*

*arrin të bëhesh hiç, do të të japin qenie ty.”*

*“Çfarë është pasqyra e qenies? Pasqyra e qenies është mosqenia. O ti i dashuruari pas Hakut! Nëse nuk je budalla, te Zoti yt shko si mosqenie.”*

Me peshën e rëndë që ka mendjemadhësia dhe indiferenca, është e pamundur të bëhet përpara në aspektin kuptimor e shpirtëror. Hazreti Haxhi Bajram Veliu ka thënë:

*“Mendjemadhësia është si një gur i lidhur në bel. Më të as nuk mund të notohet e as nuk mund të fluturohet.”*

Kjo është arsyeja pse miqtë e Hakut, që të mund të pastronin nefsën e tyre, janë zhveshur fillimisht nga petku i qenies dhe i unit, për të veshur më pas rrobën e hiçit e të mosqenies. Më pas kanë mundur të lartohen në majat e kuptimeve shpirtërore.

Si përfundim, për të arritur pjekurinë shpirtërore është e domosdoshme të mos zhvishet asnjëherë petku i modestisë. Një robëri pa modesti është robëri e mangët. Uni dhe mendjemadhësia janë armiqtë më të rrezikshëm të njeriut, sepse rrezikojnë ta çojnë atë deri në kufër (mosbesim).

Pasi e kanë shkruar modestinë në jetën e tyre, miqtë e Hakut kanë arritur mirësitë e shumta të Allahut të Lartmadhëruar, kanë arritur të bëhen yje në qiejt shpirtëror, si dhe udhërrëfyes për të tjerët si në gjallje ashtu edhe pas vdekjes së tyre.

***Allahu na dhuroftë në zemrat tona atmosferën e modestisë dhe asgjësisë së miqve të Hakut. Na e bëftë të lehtë që të kryejmë detyrimet tona të robërisë ndaj Tij, me ndjenjën e përgjegjësisë, të edukatës, disiplinës dhe moralit të përsosur.***

**Amin...**





Ma. sci. Flamur Sofiu

## Prerja e shtazëve dhe mishrat e lejuara në sheriatin islam

**N**ë kuptimin etimologjik termi الذكاة - do të thotë diçka e mirë, رائحة ذكية, aromë e mirë, zgjuarsia, aftësi, si për she-mbull فلان ذكي -njeri i zgjuar (i aftë). Në sheriatin Islam, me fjalën الذكاة kuptohet therja dhe prerja e shtazëve, të cilat janë lejuar për t'u ngrënë.

Me الذكاة nënkuptohet therja e shtazës në fyt, duke ia prerë gabzherrin dhe dy damarët e qafës.

### KUSHTET E PRERJES SIPAS SHERIATIT

Kushtet e prerjes sipas shariatit janë:

1. Përmendja vetëm e emrit të Allahut (xh.sh.). Nëse emri i Allahut (xh.sh.) nuk përmendet qëllimisht, mishi i asaj shtaze konsiderohet haram, i ndaluar. Në lidhje me këtë kemi argument fjalën e Allahut (xh.sh.):

*“Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e Allahut, sepse kjo është gjynah! Në të vërtetë, djajtë i nxi-*

*sin miqtë e vet që t'ju kundërshtojnë ju. E nëse ju u bindeni atyre, me siguri që edhe ju do të ishit idhujtarë.”* (El-Enam: 121).

Në qoftë se emri i Allahut (xh.sh.) nuk përmendet nga harresa, mishi i shtazës së tillë lejohet të hahet.

2. *Therësi.* Therësat mund të jenë në tri kategori:

a. Therësi, i cili është jobesimtar, si politesit, idhujtar, re-negat apo i pafë. Mishi i shtazës së prerë nga personat e sipërpërmendur është haram- i ndaluar, gjë për të cilën të gjithë dijetarët kanë mendim unanimit. Sa i takon kësaj, ata mbështeten në këto ajete:

*“...(u është ndaluar) ajo që theret jo në emrin e Allahut...”* (El-Maide:3)

*“...(u është ndaluar) ajo që është therur për idhuj...”* (El-Maide:3)

b. Therësi, që është mysliman, madhor, i mençur dhe mashkull. Mishi i shtazës së prerë nga një person i tillë, sipas miratimit të dijetarëve është i lejuar-hallall.

c. Therësi, që është ithtar i librit (ehli kitab), zjarrputist (mexhusij), që beson në yje (sabi'i), femër, fëmijë, i çmendur, i dehur, vjedhës dhe grabitës. Për të mbështetur faktin se ngrënia e mishit të prerë nga ithtarët e librit është e lejuar, kemi argument ajetin:

*"...edhe ushqimi i ithtarëve të librit është i lejuar për ju, dhe ushqimi i juaj është i lejuar për ta..." (El-Maide:3)*

Për këtë çështje, Ibn Abbasi (r.a.) ka thënë: *"Ju është lejuar mishi i shtazës së prerë nga çifuti dhe i krishteri, sepse ata kanë besuar në Tevrat dhe në Inxhil"*.

Nëse ithtari i librit e pret shtazën në emër të Mesihut apo në emër të Uzejrit, ngrënia e një mishi të tillë konsiderohet haram. Mbështetje për këtë janë ajetet:

*"...(u është ndaluar) ajo që është prerë jo në emër të Allahut..."* dhe në ajetin:

*"Dhe mos hani nga ajo që (para therjes së saj) nuk është përmendur emri i Allahut, vërtet ajo (ngrënia) është mëkat..."*

Shtaza e prerë nga një zjarrputist e po ashtu edhe gjahu, nuk janë të lejuara për t'u ngrënë, ngase ata janë politeistë e jo ithtarë të librit. Për këtë kemi mbështetje fjalët e Pejgamberit (s.a.v.s.):

*"Trajtojini ata (mexhusijet) ashtu siç trajtoni ithtarët e Librit, por mos u martoni me gratë e tyre dhe as mos e hani mishin e shtazëve që kanë prerë ata."*

Shtaza e prerë nga adhuruesit e yjeve (sabi'inet, të cilët pëlqehen në bazat e besimit me ithtarët e Librit, lejohet të hahet. Në të kundërtën nuk lejohet. Hanefitët mendojnë se ngrënia e mishit të therur nga adhuruesit e yjeve (sabi'inet) është e lejuar.

### **Shtaza e prerë nga gruaja dhe fëmija**

Lejohet të hahet mishi i shtazës së prerë nga femra, edhe nëse ajo është me menstruacione, por më e pëlqyshme është të prehet nga mashkulli, ngase ai është më i fuqishëm fizikisht se sa femra. Po ashtu, lejohet të hahet mishi i shtazës së prerë nga fëmija i moshës shtatëvjeçare.

### **Pjesët që duhen prerë:**

Të gjithë dijetarët janë të një mendjeje se gjatë therjes, shtazës duhet t'i prehen dy damarët e gjakut, gabzheri dhe vendi i frymëmarrjes.



### **ÇFARË ËSHTË E PËLQYSHME TË BËHET GJATË PRERJES?**

1. Shtaza të prehet ditën.
2. Therësi të drejtohet nga kibla.
3. Shtaza të rrëzohet ngadalë në krah të majtë, ndërsa koka t'i ngrihet.
4. Këmba e djathtë t'i lihet e lirë, në mënyrë që pas prerjes kafsha ta lëvizë atë këmbë e kështu të ndjejë dhimbje më pak.
5. Të mprehet mjeti i therjes përpara se kafsha të jetë shtrirë për therje.
6. T'i prehen kafshës të gjithë damarët në mënyrë sa më të shpejtë.
7. Të tregohet mëshirë ndaj kafshës, që ajo të mos mundohet para therjes.

### **ÇFARË ËSHTË E PAPËLQYSHME TË BËHET GJATË THERJES?**

Si mekruhe gjatë therjes mund të përmendim:

1. Është mekruh që gjatë kohës së therjes, therësi të thotë: *"O Zot prano këtë prej filanit"*.
2. Të kthyerit e shtazës jo në drejtim të kiblës.



## MISHI I SHTAZËVE QË JANË TË LEJUARA TË HAHEN

Tekstet (النصوص) që rrahin një tematikë të tillë ndahen në tri grupe:

1. Mishi i shtazëve që lejohen me tekst. النص على المباح.
2. Mishi i shtazëve që ndalohen me tekst. النص على الحرام.
3. Mishi i shtazëve që është lënë në heshtje nga Ligjdhënësi.

**Mishi i shtazëve që lejohet me tekst (النص على المباح)** janë:

a. **Gjallesat e detit:** gjallesat e detit janë të gjitha të ndaluara (haram)<sup>1</sup>, me përjashtim të peshkut, i cili lejohet të hahet pa u prerë e i ngordhur. Të gjitha gjallesat e tjera përveç peshkut konsiderohen si ushqime të fëlliqura. Dijetarët e mbështesin këtë mendim në ajetin:

“...dhe ua ndalon juve ushqimet e fëlliqta...” (El-A’raf:157)

Si argument për këtë marrin edhe hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.): “Janë të lejuara prej cofëtinave dy gjallesa, ndërsa prej gjakut dy lloje. Prej cofëtinave janë të lejuara: peshku dhe karkaleci, ndërsa prej gjakut mëlçia dhe shpretka”.

b. **Gjallesat e tokës.** Me gjallesat e tokës nënkuptohen të gjitha gjallesat që jetojnë vetëm në tokë. Këto ndahen në tri grupe:

1. Gjallesat, të cilat nuk kanë gjak, siç janë karkaleci, miza, buburreci, bleta etj. Mishi i këtyre gjallesave është haram, me përjashtim të karkalecit, mishi i të cilit është i lejuar-hallall. Mishi i kësaj kategorie gjallesash konsiderohet ushqim i fëlliqur, arsye për të cilën konsiderohet haram:

“...dhe ua ndalon juve ushqimet e fëlliqta...” (El-A’raf:157).

2. Gjallesat që kanë gjak, por që gjakun e kanë aq të pakët sa nuk rrjedh kur priten. Këto gjallesa janë: gjarpëri, krimbi, akrepi, parazitët tokësorë, etj. Mishi i gjithë këtyre gjallesave konsiderohet haram dhe përfshihet në kategorinë e ushqimeve të fëlliqta.

3. Gjallesa që kanë shumë gjak, i cili u rrjedh kur pre-

1. Xhumhuri (malikitet, shafi’itet dhe hanbelitet) janë të mendimit se gjallesat e detit në përgjithësi janë të lejuara (hallall), përveç atyre gjallesave të detit në të cilat vërehet ndonjë sëmundje. Për këtë, xhumhuri marrin si argument ajetin: “Ju është lejuar gjahu në det dhe ushqimi i tij, begati për ju dhe për udhëtarët...” (El-Maide:96). Sipas xhumhurit fjala (صيد)- gjahu i përfshin të gjitha gjallesat e detit dhe me këtë nënkuptohet se të gjitha këto gjallesa konsiderohen hallall për t’u ngrënë. Po ashtu, këta marrin si argument edhe hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili kur është pyetur nëse lejohet marrja abdest me ujë deti, është përgjigjur: “Uji i tij është i pastër dhe cofëtina e tij lejohet të hahet”.

3. Të munduarit e shtazës gjatë prerjes, si për shembull thyerja e qafës; prerja mbi qafë; tërheqja zvarrë deri te vendi i prerjes; prerja e ndonjë shtaze përpara shtazës, e cila do të prehet më pas etj.

4. Prerja e devesë ashtu siç prehet delja konsiderohet mekruh. Devja duhet therur duke iu shpuar zgavra e grykës.

### ÇKA NUK LEJOHET TË HAHET PREJ SHTAZËS SË THERUR APO TË PRERË?

Sipas hanefitëve, pjesët e trupit të shtazës së therur apo të prerë që nuk duhet të hahen janë shtatë:

1. Gjaku i derdhur,
2. Organi gjenital i kafshës mashkull,
3. Organi gjenital i kafshës femër
4. Prostata,
5. Fshikëza e tëmthit,
6. Fshikëza e urinës,
7. Pjesa e përparme e vendit të organeve gjenitale,

Imam Ebu Hanife (r.a.), ngrënie e këtyre pjesëve, e konsideron si mekruhi tahrimen, me përjashtim të gjakut që rrjedh, i cili konsiderohet haram për t’u ngrënë.

hen. Në këtë grup gjallesash bëjnë pjesë kafshët e buta-shtëpiake dhe kafshët e egra.

Prej kafshëve shtëpiake të lejuara janë deveja, lopa, delja. Për këtë kemi si argument ajetin:

*“Edhe kafshët Ai i krijoi dhe në sajë të këtyre ju mund të mbroheni (nga të ftohtit), keni edhe dobi të tjera dhe prej tyre hani.”* (En-Nahl:5)

*“Ju janë lejuar kafshët shtëpiake, më përjashtim të atyre që po ju lexohen (në këtë kaptinë si të ndaluara)...”* (El-Maide:1)

Mishi i mushkës dhe i gomarit janë haram, ndërsa mishi i kalit konsiderohet hallall. Sipas Ebu Hanifes edhe mishi i kalit konsiderohet mekruh.

Shpezët shtëpiake, të cilat nuk kanë kthetra, nëse theren sipas ixhmait konsiderohen hallall. Këto janë: pula, pata, rosa etj.

Shtazët e egra, që janë grabitqare, si luani, ujku, arusha etj., por edhe shpezët që kanë kthetra, si shqiponja, huti, orli etj., të gjitha këto konsiderohen haram.

Shtazët e egra, të cilat nuk janë grabitqare, si dreri, kaprolli, bizantat etj., lejohet të hahen. Gjithashtu përmendet se Pejgamberi (s.a.v.s.) ka lejuar të hahet edhe mishi i lepurit. Po ashtu lejohet të hahen edhe shpezët e egra që nuk kanë kthetra, siç janë pëllumbi, bilbili, si dhe sorra që ushqehet vetëm më drithëra e të mbjella, etj.

c. Gjallesat që jetojnë në tokë e në ujë (ujëtokësorët) . Si ujëtokësorë mund të përmendim bretkocën, krokodilin, qenin e ujit, breshkën e ujit, karkalecin e madh të detit (karavidhen), gjarpërin, etj. Sa i takon vlerësimit të kësaj kategorie gjallesash, dijetarët ndahen në tri grupe:

Ujëtokësorët nuk lejohen të hahen ngase bëjnë pjesë në ushqimet e fëlliqëta.

*Mishi i shtazëve që ndalohen me tekst:* mishi i shtazëve të ndaluar me tekst është përcaktuar me tekstin e ajetit e 3 të kaptinës el-Maidetu:

*“U është ndaluar juve (t’i hani): ngordhësira, gjaku, mishi i derrit, ajo që theret jo në emrin e Allahut, e furmjia, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara (nga briri i tjetrës), ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therrni (para se të ngordhë), ajo që është therur për idhuj...”*

Sipas ajetit të mësipërm vërejmë se janë të përmendur:

1. Ngordhësira.
2. Gjaku. Me këtë nënkuptohet gjaku, i cili ka rrjedhur pasi është prerë shtaza.
3. Mishi i derrit.

4. Ajo që theret jo në emër të Allahut.

5. E furmjia .

6. E mbytura.

7. E rrëzuarja.

8. E shpuarja (nga briri i tjetrës).

9. Ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therrni përpara se të ngordhë.

10. Ajo që është therrur për idhuj.

Me hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.) është i ndaluar mishi i shtazëve grabitqare dhe e shpezëve që kanë kthetra *“Pejgamberi (s.a.v.s.) e ka ndaluar ngrënien e shtazëve shkyese dhe të shpezëve që kanë kthetra”*. Po ashtu, me hadith është e ndaluar të hahet copa e këputur nga gjallesa e gjallë *“Ajo pjesë, e cila është këputur prej shtazës së gjallë konsiderohet cofëtinë (nuk lejohet të hahet)”*.

Gjallesat që ushqehen me ndytësira pavarësisht a është deve, lopë, dele etj. *“Pejgamberi (s.a.v.s.) e ka ndaluar të përdoret për t’u hypur shtaza që ha ndytësira. Po ashtu ka ndaluar edhe ngrënien e mishit të saj.”*

Me ajete të Kuranit (a.sh.) janë të ndaluara të gjitha ushqimet që janë të fëlliqta:

*“...dhe ua ndalon juve ushqimet e fëlliqëta...”* (El-A’raf:157)

Sipas disa dijetarëve, shtazët për të cilat Pejgamberi (s.a.v.s.) ka urdhëruar të mbyten nuk lejohet të hahen. Gjithashtu, nuk lejohet të hahen as ato shtazë, të cilat Pejgamberi (s.a.v.s.) i ka ndaluar të mbyten. Për shembull, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka urdhëruar që të mbyten sorra, qifti (lloj zogu grabitqar), akrepi, miu, qeni i tërbuar. Pejgamberi (s.a.v.s.) ka ndaluar të mbyten bleta, buburreci, pupëza, saredi (lloj zogu kokëmadh) dhe bretkosa.

*Mishi i shtazëve të cilat janë lënë në heshtje nga Ligjdhënësi* : Mishi i shtazëve, që Ligjdhënësi i ka lënë në heshtje konsiderohen hallall për t’u ngrënë, bazuar në rregullën **“në bazë çdo gjë është e lejuar”**. Për këtë mund të përmendim ajetin:

*“Ai është i Cili ka krijuar për ju gjithçka që është në tokë...”* (El-Bekare: 29).

Në lidhje me këtë mund të përmendim edhe hadithin: *“Hallall është ajo që e ka lejuar Allahu në Librin e Tij dhe haram është ajo që e ka ndaluar Allahu në Librin e Tij. Sa për atë që e ka lënë në heshtje, ajo është e lejuar për ju.”*

#### **Shënim:**

Mishrat që importohen prej viseve joislame lejohen të hahen nëse plotësojnë dy kushte:

1. Të jenë prej mishrave të lejuar me shariat.
2. Të jenë të therura sipas shariatit.

# Si ta shfrytëzojmë kohën siç duhet

**K**oha (jeta) është dhunti e madhe e Allahut (xh.sh.), prandaj shfrytëzoheni këtë dhunti.

Shtrohet pyetja: Si ta shfrytëzojmë kohën?

Dijetari i madh Ibnul Kajim el-Xhevziye ka thënë: “O njeri! Nëse dëshiron ta shfrytëzosh kohën ashtu siç duhet, atëherë plotëso këto pesë vepra: 1. Kushtëzimi i vetvetes, 2. Kontrollimi i vetvetes, 3. Mundimi, 4. Vetëllogaritja, 5. Dënimi”. Në këtë shkrim, do të trajtojmë vetëm dy të parat; kushtëzimin e vetvetes dhe kontrollimin e saj.

**1. Kushtëzimi i vetvetes.** Myslimani duhet ta kushtëzojë vetveten për arsye se, si rezultat i nefsit (egos) natyra e tij anon nga e keqja, duke qëndruar larg së mirës. Allahu (xh.sh.) ka thënë: “**Me të vërtetë nefsi (uni) të urdhëron për të keq...**” (Jusuf, 53)

Në lidhje me nefsin, Imam Shafiu ka thënë: “*Nefsi është si një kafshë mbi të cilën hipën njeriu; nëse (njeriu) arrin t’i marrë frerët në dorë, e komandon atë dhe e shpie nga të dojë ai, por nëse nuk arrin t’i marrë frerët, atëherë ai (nefsi) e çon atë nga të dojë vetë.*”

Prandaj myslimani duhet të përgatitet me të gjitha forcat për të mposhtur egon, duke u treguar i vendosur në luftën kundër pasioneve dhe epsheve. Kështu, nëse ajo kërkon rehati, ai duhet ta lodhë atë; nëse ajo dëshiron kënaqjen e ndonjë epshi, ai duhet ta privojë; nëse ka mangësi në kryerjen e ndonjë pune të mirë, ta detyrojë t’i plotësojë mangësitë, etj. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë:

**“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”** (Shems, 9-10)

Muslimi transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kur besimtari bën një gjynah, i bëhet një pikë e zezë në zemër. Nëse

pendohet, ajo pikë i hiqet dhe zemra ndriçohet. Nëse bëhet i vazhdueshëm në kryerjen e gjynaheve, pikat e zeza shtohen dhe e mbulojnë krejt zemrën, derisa të bëhet siç thotë Allahu (xh.sh): **“Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat.”** (Mutaffifin, 14)

Ibn Tejmije ka thënë: “Gjynahi në zemër (iman) është si plaga në trup. Nëse trupi plagoset shpesh (shumë), rrezikon të vdesë. Po ashtu edhe zemra e njeriut, nëse ndotet shumë me gjynahe rrezikon që të mbesë pa iman.”

Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë:

**“Frikësoju Allahut kudo që të jesh. Veprën e keqe pasoje me të mirë, që ta fshijë atë (te keqen), dhe sillu mirë me njerëzit.”** (Tirmidhi)

Ndërsa Allahu i Lartmadhëruar ka thënë:

**“Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija.”** (Hud. 114)

Abdullah ibn Mubareku, ka thënë: “Përderisa nuk e angazhon nefsin tënd me të vërtetën, atëherë ai do të angazhohet me të pavërtetën.”

Ja si e angazhonin sahabet nefsin e tyre në punë të mira:

Aliu (r.a.) kur fliste për shokët e Muhamedit (a.s.) thoshte: “*Pasha Allahun, unë i kam parë shokët e Muhamedit (a.s.) . Atyre nuk u ngjan askush. Në mëngjes gdhieheshin flokëpri-shur, të pluhurosur, të zbehtë. E kalonin natën në sexhde dhe në këmbë (duke u falur), si dhe duke lexuar librin e Allahut (xh. sh.). Kur përmendej Allahu (xh.sh.), ata gjunjëzoheshin sikurse përthyhen pemët nga furtuna, ndërsa sytë u lotonin aq sa u lageshin rrobat.*”

**2. Kontrollimi i vetvetes.** Myslimani duhet ta kontrollo-



*“... Ja dini se Allahu e di ç’ka në zemrat tuaja, andaj ruajuni prej Tij...”*

*(Bekare, 235)*

jë vazhdimisht vetveten, për të ditur nëse egoja e tij është duke plotësuar kushtet që Allahu i Lartmadhërueshëm kërkon prej saj. Ta shtrëngosh veten që të ndihet nën mbikëqyrjen e Allahut (xh.sh.). Në Kuranin famëlartë thuhet:

*“...Ta dini se Allahu e di ç’ka në zemrat tuaja, andaj ruajuni prej Tij...”* (Bekare. 235)

*“Allahu është mbikëqyrës për çdo gjë.”* (Ahzab.52)

Ndërsa Hazreti Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

*“Ta adhurosh Allahun sikur e sheh. Edhe pse ti nuk e sheh Atë, dije mirë se Ai të sheh ty.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Kjo është rruga që zgjodhën myslimanët e parë të devotshëm, të cilët e mposhtën dhe e edukuan egon, derisa arritën gradën e bindjes së plotë dhe të afërsisë ndaj Allahut të Madhëruar.

Mes të parëve tanë ka pasur prej atyre që kur dilnin prej xhamisë dhe u shkante syri në haram. Atëherë ata e godisnin syrin duke thënë: “O syri im! Këtë dritë (syrin) me të cilën po shikon, ta ka dhënë Allahu; a nuk frigohesh që mund të ta marrë, apo ta ka krijuar këtë dritë që të shikosh haram?!”.

Sufjan Theuriu ka thënë: “Duhet ta ndjesh mbikqyrjen e Atij, të Cilit nuk i fshihet asgjë. Duhet të shpresosh tek Ai që e plotëson premtimin. Duhet të kesh kujdes nga Ai që ka në dorë dënimin.”

Abdullah ibn Mubarek i tha dikujt: “Ruaju nga Allahu”. Ai e pyeti: *E si të ruhemi nga Allahu?* Ibn Mubareku iu përgjigj: “Përpiqu të ndihesh gjithmonë sikur po e sheh Allahun e Madhëruar.”

Tregohet se një besimtar i devotshëm kaloi pranë një grupi njerëzish që po bënin garë në hedhjen e shtizës. Më tej pa një burrë që po qëndronte i vetëm larg tyre. Iu afrua atij

dhe deshi t’i fliste, por ai foli i pari dhe i tha: **përmendja e Allahut është më e ëmbël.**

A je vetëm? - e pyeti besimtari i devotshëm.

Burri ia ktheu:

- Jam me Zotin dhe me dy melekët e mi.

Besimtari:

- Kush po fiton në këtë garë që po zhvillohet?

- Ai, i cili ka merituar mëshirën dhe faljen e Allahut të Lartmadhëruar.

- Nga është rruga?

Njeriu i vetmuar bëri me shenjë nga Qielli, e pastaj u çua dhe iku.

Abdullah ibn Dinari tregon: “U nisa me Omer ibn Hattabin (r.a.) për në Meke dhe në një pjesë të rrugës u ulëm për të pushuar. Aty hasëm një bari delesh. Omeri (r.a.) i tha: O bari! Na shit ndonjë dele nga tufa jote! Bariu i tha se ai ishte skllav. Për ta provokuar, Omeri e këshilloi që t’i thoshte padronit të vet se delen e kishte ngrënë ujku. Por skllavi i tha: Po Allahut? Omeri qau, ndërsa të nesërmen e bleu këtë skllav dhe i fali lirinë.”

Thuhet se kur ngeli vetëm me Jusufin (a.s.) Zylejhaja e mbuloi fytyrën e idhullit që adhuronte. Jusufi i tha: A po turpërohesh se mos të sheh ajo gjë e pajetë dhe pret që unë të mos turpërohem nga mbikqyrja e Sundimtarit Madhështor, Allahut (xh.sh.)?!

*“Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të.”* (Junus, 61)

# Teknologjia e Fizikës

Ma. Artur Tagani

## TEKNIKA E ORËVE NË ISLAM

Teknika e ndërtimit të orëve në botën Islame fillon që në hapat e para të historisë së saj. Janë shpikur orë të ndryshme, fillimisht ato që punonin me ujë, ndërsa më pas orët mekanike. Tani, le t'i hedhim një sy këtyre teknikave:

### 1. Teknika e orëve të ujit

Sipas librit “*Kitabu'l-Hajavan*” të **el-Xhahidhit**, myslimanët janë marrë që prej shumë kohësh me krijimin e orëve. Kjo është e vërtetë, pasi dihet se ora e parë e ujit që kanë bërë myslimanët është ajo e Medresesë Mustansirijje, që daton në vitin 633. Sado që disa thonë se ajo mund të jetë orë mekanike, mundësia më e madhe është të jetë orë uji. Kjo bazohet në fjalët e **Ibn el-Futi-t** i cili, duke folur për Medresenë në fjalë, përmend faktin se **Nureddin Ali Taglub es-Saati** (vd. 638) kishte shpikur një orë uji. Po ashtu edhe fizikani **Adurrahman el-Erbili**, në veprën e tij “*Hulasatu'dh-Dhehebi'l-Masbuk*” e përmend si një orë uji. Kjo mënyrë e punimit të orës në botën Islame vazhdoi edhe në periudhat e mëvonshme me **el-Muradiun**, **ez-Zerkaliun** dhe **el-Hazinin**.

Ndërtimet e orëve që funksiononin me ujë ekzistojnë edhe në qytetërimet paraislame. Mirëpo këto orë u ndërtuan në periudhën Islame e kësajsoj perëndimorët u njohën me ato orë nëpërmjet myslimanëve të Andaluzisë.

### 2. Teknika e orëve mekanike dhe e lavjerrësve

Historia ka treguar se shpikësit e parë të orëve mekanike e të lavjerrësve janë myslimanët. Shembullin e parë të kësaj lloji ore e shohim midis viteve 706 – 714 në xhaminë Umejje (Damask/Siri). Shumë historianë dhe udhëtarë si **Benjamin et-Tatili** dhe **Ibn Xhabir** e dëshmojnë me ëndje atë orë.

As shpikjen e parë të lavjerrësit nuk e bëri Galileu, sikurse njihet prej perëndimorëve. Lavjerrësin e zbuloi ose **Ibn Junus el-Erbili** ose **Ibn Junus el-Misri** (vd. 1009), disa shekuj para Galileut. Më pas, një tjetër person që njihet historikisht se ka punuar me lavjerrësit është Kemaleddin Ibn Muhammed el-Akili **el-Musuli** (vd. 1232).

### Orët e rërës

Pothuajse të gjithë historianët e shkencës bien dakord njëzëri se orën e rërës e kanë zbuluar të parët mys-



limanët. Astronomi i shquar **el-Fergani** është një prej shpikësve të parë të orës me rërë, e cila quhet ndryshe “Ruhama”.

### Orët e diellit

Në kohët kur nuk gjendeshin apo nuk ishin përhapur ende orët mekanike, ato të rërës apo të ujit, në botën Islame krahas astrolabëve përdoreshin edhe orët e diellit për përcaktimin dhe llogaritjen e kohës.

Ora e diellit është një mjet i përbërë nga një shtizë e përgatitur në mënyrë specifike dhe nga një gur i bërë po ashtu në mënyrë specifike, të cilat vendosen mbi një mermer apo mbi një bosht metalik. Sipas lëvizjes së diellit, shtiza lëshon hijen e saj mbi bosht. Koha përcaktohet mbi bazën e lëvizjes së hijes mbi vizat e bëra që më përpara, të cilat tregojnë orën, gjysmën e orës dhe çerekun e orës. Përgjithësisht orët e diellit janë përdorur



nëpër xhamia dhe vendoseshin në vendet ku mundësia e kontaktit me diellin ishte më e madhe.

Me lindjen e qytetërimit Islam orët e diellit pësuan një progres të madh. U shpikën orë dielli të ndryshme. Që prej asaj kohe, orët e diellit nuk ishin thjesht mjete që përcaktonin kohën, por patën edhe funksione të tjera. Ato u bënë edhe tregues të stinëve, të solsticëve, madje edhe të shenjave të horoskopit. Orëve të diellit u janë vënë emra të ndryshëm, si Basita, Mizvele dhe Mikat.



### MAKINAT E PARA FLUTURUESE

Provat e para të fluturimit dhe makinat e para fluturuese janë bërë nga makinistët myslimanë. Ishte shkencëtari andaluzian **Ibn Firnasi**, i cili ka jetuar në shekullin IX, ai që bëri provat e para në historinë e shkencës.

**Ibn Firnasi** shpiku një makinë fluturuese me dy krahe dhe arriti të fluturonte me sukses, duke u hedhur nga një kodër afër Kurtubës. Por, në kohën e zbritjes, për arsye se makina e tij nuk kishte bisht, ai u përplas përtokë duke pësuar vetëm disa plagë. Dy shekuj më vonë ishte **El-Xhevheri** (vd. 1002) ai që e pasoi **Ibn Firnasin** (vd.888). Ai përgatiti një makinë fluturimi më të plotë dhe nisi të fluturonte nga minarja e xhamisë së vjetër të Nishaburit. Pas el-Xhevherit, një tjetër që ndoqi këtë rrugë ishte shkencëtari i Perandorisë Osmane **Hezarfen Ahmed Çelebi**.

Hezarfen Ahmed Çelebi është mekanisti më i rëndësishëm i periudhës së Muratit IV. Duke ndjekur idetë e Ibn Firnasit dhe të el-Xhevherit, në fillim të shekullit të XVII-të ai shpiku një raketë me reaktor baruti, pothuajse e njëjtë me raketat e sotme. Gjithashtu, ai fluturoi me sukses që nga Kulla e Galatës (në Stamboll) deri në zonën Doğancılar.

Shkencëtarët myslimanë dhanë një kontribut të rëndësishëm për pasurimin e teknologjisë së fizikës. Krahas teknikës së orëve dhe të mjeteve fluturuese, ata kanë pasur arritje të mëdha edhe në shpikjen e peshoreve të përdorura për matje të lehta, në shpikjen e pasqyrës konkave, mullirit me erë etj. Gjithashtu, ata zotëronin një teknikë mjaft interesante për ndërtimin e anijeve, si dhe kanë shpikur nilometrin etj.



## Ebu Mansur Maturidiu

**E**bu Mansur Maturidiu ishte themelues i një prej shkollave të teologjisë sistematike islame. Emri i tij i plotë ishte Ebu Mansur Muhamed bin Muhamed bin Mahmud. Ashtu siç ndodhte zakonisht, ai u bë i njohur me emrin Maturidiu, emri i vendit ku kishte lindur, por në literaturën e shkruar njihet me emrin Ebu Mansur el-Maturidiu. Maturidi ka qenë një lagje apo fshat në Semerkant në Transaksonia. Deri para sulmeve shkatërruese vandale të hordhive që vinin nga Azia e Largët, Transaksonia qe një ndër zonat më të kulturuara dhe të zhvilluara të qytetërimit islam. Burimet historike nuk japin të dhëna të mjaftueshme në lidhje me jetën dhe familjen e Ebu Mansur Maturidiut.

Për një kohë të gjatë emri i tij dhe i shkollës maturidije nuk njihet apo përmendet me të madhe në literaturën klasike islame, ndërsa të dhënat për të gjendeshin të shkapërdara aty-këtu nëpër burimet historike. Në periudhën midis dy luftërave botërore, fluksi i madh i punimeve orientaliste dhe prezantimi i orientalistit Joseph Schacht do të bënin të mundur që Maturidiu dhe

shkolla e tij të fillonte të zinte një vend të rëndësishëm në studimet akademike. Ky interesim studimor rreth Ebu Mansur Maturidiut, rreth shkollës dhe literaturës së saj, do të rritej shumë pas viteve 1990.

Dita e lindjes së Maturidiut nuk dihet në formë të përcaktuar dhe të saktë, ndërsa si datë të vdekjes së tij të gjithë historianët arabë shënojnë vitin 944 (333 H). Studiuesit klasikë të literaturës bibliografike nuk flasin as edhe një rresht të vetëm për figurën e Maturidiut. Jo vetëm ata, por as dijetarët e mëvonshëm që mbrojtën pikëpamjet e kësaj shkolle nuk folën rreth tij. Kjo na lë të mendojmë se Maturidiu nuk numërohej si themelues i ndonjë shkolle teologjike sistematike islame, por si një pasues i thjeshtë i botëkuptimit teologjik islam të shpallur nga ana e Ebu Hanifes.

Periudha kur jetoi Maturidiu përkon me periudhën kur shteti Abasi fillon të dobësohet dhe si rezultat në skenën e historisë politike islame fillojnë të dalin në pah një numër i madh principatash islame. Si rezultat i kësaj procesi, krahas principatave të tjera të fuqishme, në

Transaksoni u themelua edhe principata Samani. Kjo principatë u themelua nga vasalët e dikurshëm që varreshin nga kalifi abasi Memuni, por që në vitin 261 H arritën të shkëputen nga sundimi abasi dhe brenda një kohe të shkurtër të krijonin një principatë të fuqishme në këtë rajon. Dinastia Samani u zhduk nga skena politike në vitin 389 H, duke mos mundur t'u bënte ballë sulmeve dhe inkursioneve të fuqishme të principatave turke që e rrethonin.

Dinastia Samani kreu shërbime të mëdha qoftë ndaj shkencave tradicionale islame, qoftë ndaj gjuhës dhe letërsisë arabe, duke i zhvilluar ato me sa kishte mundësi. Zhvillimi i kulturës islame nga ana e kësaj dinastie lëvdohet me të madhe nga ana e historianëve klasikë arabë. Si rezultat i përkrahjes së madhe që gëzonin dijetarët nën sundimin Samani, në këtë trevë u zhvilluan së tepërmi shkencat klasike islame si tefsiri, hadithi, fikhu, tasavufi, selami dhe letërsia.

Maturidiu u rrit dhe u edukua në këtë ambient të qetë, larg çdo lloj intrige politike dhe lufte të hapur apo të fshehtë për pushtet, ku shkencat islame qenë zhvilluar në shkallën më të lartë për kohën. Kjo situatë bënte që veprimtaritë shkencore dhe studiuese të zhvilloheshin dhe përhapeshin në një shkallë të gjerë.

Burimet historike na mundësojnë të pohojmë se Maturidiu u edukua nga një rreth dijetarësh islamë, zinxhiri i njohurive të të cilëve shkonte pas deri tek studentët e Ebu Hanifes e madje deri tek ai vetë. Prandaj ai u mbrujt me mësimet dhe botëkuptimin islam duke mbrojtur pikëpamjet e Ebu Hanifes në çështjet ku ai mbante qëndrim të ndryshëm nga dijetarët e tjerë islamë.

Dijetarët islamë nga të cilët ai mori njohuri rreth shkencave bazë islame qenë Ebu Nasr Ijadi, Ebu Bekr Xhuzxhani, Muhamed bin Mikatil Razi dhe Nusajr bin Jahja Belhi. Nuk mund t'i përmendim këtu të gjithë dijetarët që jetuan dhe punuan në këtë rajon gjatë viteve kur jetoi Maturidiu, dijetarë me të cilët ai ka pasur kontakte që synonin zhvillimin e njohurive, ndaj u mjaftuam vetëm me emrat e dijetarëve të mësipërm, të cilët për nga rëndësia janë të njohur për lexuesit dhe studiuesit e kësaj fushe.

Mes nxënësve të Maturidiut njihen Hakim Semerkandi, Ebu Muhamed Pezdeviu, Ebu Lejs Buhariu dhe Ebu Hasan Rustugfani, të cilët e përcollën dhe e sistematizuan akoma më shumë mendimin teologjik të shkollës maturidite. Figura e dytë pas Maturidiut dhe



sistematizuesi i kësaj shkolle që pa dyshim Ebu Muin Nesefiu me veprën e tij *Tefsiretu'l-Edille*.

Maturidiu, i cili ia kishte dedikuar jetën e tij diturisë fetare dhe mbrojtjes së akaidit të ehli sunetit ve'l-xhematit, për ta ruajtur atë të pa ndikuar nga rrymat e ndryshme që përpiqeshin të përhapeshin në Transaksoni. Ai pati shkruar vepra të vjera e të pakrahasueshme me të tjerat në këtë fushë, vepra të cilat dëshmojnë qartë dhe konkretisht se çfarë autoriteti i madh që hartuesi i tyre. Përveç veprave që kanë mbërritur deri në ditët tona Maturidiu shkroi edhe mjaft të tjera, por të cilat ne i njohim vetëm nëpërmjet burimeve bibliografike. Deri më sot jo e gjithë vepra e Maturidiut është botuar e plotë, me përjashtim të dy veprave të tij bazë, të cilat janë *Kitabu't-Tevhid* dhe *Tevilatu'l-Kuran*. *Kitabu't-Tevhid*, *Libri i Monoteizmit* përbën themelin e shkollës së mendimit teologjik islam të Ebu Mansur Maturidiut. Kjo veper u botua në vitin 1970 nga Fethullah Hulejf, i cili për botimin e kësaj vepre u bazua në kopjen e këtij libri që ruhet në bibliotekën e Cambridge-it, me nr. 3651. Vepra ka 206 faqe me përmasa mesatare, çdo faqe ka 21 rreshta dhe është kopjuar në vitin 1150 hixhri. Një botim i fundit i kësaj vepre, pas një edicioni kritik të bazuar në kopjet e ndryshme të këtij libri, u realizua nga Bekir

Topallogllu dhe Dr. Muhamed Aruçi.

Në veprën Tevilatu'l-Kuran, ndërsa sqaron nënkuptimet e ajeteve kuranore, Maturidiu përdor një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë, duke shmanhur kështu detajet e panevojshme dhe duke i trajtuar nga këndvështrimi i ehli sunetit temat e teologjisë dhe besimit që përmbajnë ato ajete. Megjithatë, përkrah përgjigjeve me të cilat synon të argumentojë saktësinë e pikëpamjeve të ehli sunetit, sa herë që e sheh të nevojshme ai përmend edhe pikëpamjet e shkollave dhe të fraksioneve të tjera islame.

Nëpërmjet veprave të tij, Maturidiu synonte të argumentonte pavërtetësinë e pikëpamjeve të shkollës Mutezile, pikëpamje që ishin shumë të përhapura në atë periudhë, veçanërisht gjatë sundimit të halifit abasi Memunit, i cili qe përkrahësi më i flaktë i kësaj shkolle. Në mënyrë të veçantë, Maturidiu sulmon pikëpamjet e Kabiut, që njihet si mbrojtësi më i madh i mendimit teologjik mutezili. Për më tepër, Maturidiu pati shkruar edhe libra të posaçëm kundër pikëpamjeve të këtij dijetari mutezili. Ai i pati luftuar me penë edhe pikëpamjet e mbrapshta të Karmative dhe të Rafidive.

Dijetarët që kanë hartuar literaturën teologjike sistematike, kanë numëruar nga 13 deri në 50 dallime midis shkollës së mendimit teologjik të Maturidiut dhe asaj të Eshariut. Shifra e fundit është vërtetë e ekzagjeruar, sepse ka të bëjë me prirjen për të numëruar si dallime edhe shprehjet e ndryshme të këtyre dy teologëve të mëdhenj islam në lidhje me një temë të caktuar, paçka se në thelb ata mbrojnë të njëjtën gjë. Si pikëpamje karakteristike me të cilat identifikohet mendimi teologjik i shkollës Maturidi mund të përmendim opinionin se vullneti i pjesshëm që ndodhet tek njeriu (irade xhuzije) është i pavarur, se e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara njihen me anë të mendjes dhe të logjikës; edhe po të mos kishte ardhur shpallja hyjnore, zbritja e së cilës është shprehje e mëshirës së Zotit për njerëzit, njeriu në thelb të qenies së tij është i mbrojtur me nevojën për besimin tek Zoti. Prandaj, njeriu do të jetë përgjegjës për këtë gjë, edhe nëse nuk ka dëgjuar për shpalljen hyjnore, atributi krijim (tekvin) i Allahut është i pavarur. Një nga kushtet e Pejgamberëve është që ai të jetë mashkull. Mosbesimtarët nuk kanë si të jenë të ngarkuar me kryerjen e rregullave të fesë për sa kohë nuk besojnë, kështu që në jetën tjetër do të dënohen vetëm për mosbesimin e tyre. Imani as nuk shtohet dhe as nuk pakësohet, sepse imani është i ndarë

nga veprat. Këto të fundit shtohen dhe pakësohen duke treguar shkallën e devotshmërisë, por jo atë të besimit të një njeriu.

Analiza e veprës kryesore të Maturidiut, Kitabu Tevhid, vepër që ka mbërritur deri në ditët tona, nxjerr në shesh faktin se ai i jep rëndësi të madhe si traditës së hadithit dhe Kuranit, po ashtu edhe mendjes, duke përdorur stilin e diskutimit dhe debatit.

Konservatorizmi që duket tek Maturidiu në specifikën e interpretimit të shprehjeve metaforike krahas përvetësimit në një dimension të madh të metodës së kelamit, duket edhe tek Eshariu.

Ekziston një ndryshim i madh mes racionalizmit mutezili dhe racionalizmit maturidi. Ky i fundit, në dallim prej të parit pranon si pjesë të besimit pranimin me mendje e zemër të dogmave fetare si: rujetullah (parja me sy e Zotit në botën tjetër), shefaati (ndërmjetësimi i profetit dhe i njerëzve të mirë për mëkatarët në botën tjetër), ura e Siratit, peshorja (mizan), të cilat mutezilët nuk i pranojnë ngaqë pretendojnë se këto bien në kundërshtim me logjikën e shëndoshë. Përgjigja e Maturidiut është se ato u përkasin situatave të përjetësisë, ku mendjes nuk i takon të luajë ndonjë rol ndikues, sepse tekstet e shenjta të fesë islame (Kurani dhe hadithi) mjaftojnë për të treguar vërtetësinë e tyre.

Tek Mutezilët mendja është diku gjykuese dhe diku pikënisje, ndërsa sipas Maturidiut mendja është në funksion të së vërtetës absolute që na mësohet nëpërmjet Kuranit dhe hadithit.

Shkolla e mendimit maturidi ka qenë e përhapur në mënyrë paralele me shkollën juridike të hanefitëve. Ndonëse gjatë sundimit osman në medrese studioheshin vepra të esharitëve, Osmanët e njihnin shkollën maturidie si një shkollë tradicionale prej së cilës vareshin. Kjo situatë bëri që një pjesë e dijetarëve osmanë të përpiqeshin të pajtonin me njëra-tjetrën pikëpamjet e Eshariut me të cilat edukoheshin nëpër shkolla dhe ato të Maturidiut, duke gjetur ndonjëherë zgjidhje të ndërmjetme që janë intriguese për logjikën. Kështu, myslimanët e Ballkanit, shqiptarët dhe boshnjakët, i përkasin tradicionalisht shkollës maturidite, e cila nuk është gjë tjetër përveç se një tërësi argumentimesh logjike në mbështetje të parimeve të ehli sunetit dhe xhematit, që mbështeten në Kuran dhe në hadith.

## Raporti i Ahmet Xhevdet pashës mbi Shkodrën, drejtuar sulltan Abdulhamitit II

**A**hmet Xhevdet pasha konsiderohet si një nga figurat më të shquara në historinë e administratës osmane. Veprimtaria e tij arriti kulmin me detyrën e tij si kryetar i komisionit të hartimit të Mexhele-s, Kodit Civil Osman që u zbatua për shumë kohë dhe në shumë vende. Ky nëpunës i lartë osman pati përmbledhur raporte të ndryshme në formë kujtimesh, të cilat ia pati paraqitur sulltan Hamidit II. Raporti (tezkire) numër 18 flet për detyrën e tij si komisar fuqiplotë në sanxhakun e Shkodrës. Ai pati kryer edhe një inspektim në Bosnjë, detyrë gjatë së cilës pati marrë me vete si përkthyes Pashko Vasën, i cili nga ana e tij pati botuar librin “La Bosnie et l’Herzégovine pendant la mission de Djevdet Efendi, Constantinople 1865”, që lidhet me kujtimet e tij gjatë kohës kur kryente këtë detyrë.

Sa i takon rrafshit politik e të dhënave ekonomike që ofron, raporti i Ahmet Xhevdet pashës pati tërhequr vëmendjen e historianit gjerman Konrumpf, i cili pati botuar edhe një artikull studimor në lidhje me këtë çështje. Prandaj, ne do të ndalemi më shumë tek ato që janë lënë pa përmendur në atë artikull.

Më 26 shtator të vitit 1861 (21 rebiulevel 1278 H) këshilli ministror vendosi të dërgonte si komisar të jashtëzakonshëm Ahmet Xhevdet pashën. Shkaku që situata e fundit e krijuar mes popullit të Shkodrës dhe valiut të Shkodrës, Abdi pashë Cerkezit. Tokat shqiptare nuk ishin të panjohura për këtë zyrtar të lartë osman, sepse funksioni i tij i parë parë në administratën shtetërore osmane pati qenë detyra e kadiut në kazanë e Përmetit.

Kur mbërriti në Shkodër, Xhevdet pasha u habit me panoramën që iu shfaq përpara. Dy tabore me ushtarë



të rregullt në një anë dhe disa mijëra burra të armatosur në anën tjetër ishin vënë kundër njëri-tjetrit, gjë që tregonte se situata në Shkodër nuk ishte aspak e mirë. Pas një konsultimi me të gjitha palët, Ahmet Xhevdet pasha arriti në përfundimin se mytesarifi Abdi pasha, duke mos qenë asnjëherë nëpunës administrate por ushtarak, por dhe duke pasur parasysh faktin se çështjeve të shumta ushtarake që kishte për të zgjidhur u qenë shtuar edhe problemet administrative, ishte mbytur aq shumë në punë sa e kishte humbur fare toruan, ndërkohë që edhe nëpunësit e tij po i shkaktonin shumë humbje financiare. Qëndrimi i tij refuzues ndaj çdo këshille kishte bërë që në Bajramin e Kurbanit të atij viti situata

të degjeneronte si mos më keq.

Shqiptarët kanë dëshirë të hanë bukë misri (koko-roz), ndërsa bukën e grurit e konsiderojnë si çyrek, por meqë në këto kohë nuk gjendet bukë tjetër përveç bukës së grurit, ushtarët e rregullt shqiptarë kanë paraqitur ankesat e tyre, të cilat i qenë dërguar këshillit të vilajetit nga ana e bylykbashëve. Vetëm sjellja e sasive të mëdha të bukës së misrit nga Korfuzi bëri që ata të qetësohen.

Në këtë kohë, kryetari i këshillit qe haxhi Muhtar aga, për të cilin thuhej se kur Napoleon Bonaparti pushtoi Venedikun, qe takuar me Bonapartin në rangun e përfaqësuesit të parisë pasanike të Shkodrës, duke bashkëbiseduar me francezët për disa punë të tijat. Ai i pati shtuar pasuritë që kishte me vete nëpërmjet çmimeve të larta, duke vënë kështu shumë para. Këto gjëra Muhtar pasha i tregonte me gojën e tij.

Të shëtisësh rrugëve të Shkodrës pa armë në brez konsiderohet turp për meshkujt, por meqë Muhtar aga është shumë i thyer në moshë, askush nuk ia merr për turp kur shëtit pa armë. Ai shëtit duke mbajtur një shkop në dorë, pa patur frikë se hasmët mund të qëllojnë mbi të, sepse këtu konsiderohet turp të shtiesh kundër njeriut të paarmatosur. Ai është person i zgjuar dhe bamirës i madh.

Malazetët i vrasin myslimanët që hasin, por ndodh edhe t'i lënë gjallë pasi u presin hundët dhe veshët. Për këtë arsye, në qytetin e Shkodrës mund të shohësh shumë ushtarë dhe nëpunës të dëmtuar në hundë dhe veshë.

Ura e Bunës që zgjatej deri në lagjen Gallata, ishte rrënuar deri në atë pikë sa që tundej kur mbi të kalonin edhe njerëzit. Kësisoj u vendos që të mblidheshin para për meremetimin e saj. Për këtë gjë kontribuoi e gjithë paria dhe populli i Shkodrës. Gjatë qëndrimit në Shkodër përfundoi edhe meremetimi i kësaj ure.

Xhevdet pasha regjistron një shprehje të malësisë së Oroshit që është: "ta bësh bakrin teneqe". Kjo shprehje kishte lindur nga fakti se në pjesën e poshtme të bajrakëve maja mbështillej me teneqe në Shqipëri, me përjashtim të malësisë së Oroshit, të cilët e mbështillnin fundin e shtizës së bajrakut me bakër. Këtë gjë ata e shpjegonin si një privilegj që u ishte njohur qysh nga koha e sulltan Muratit. Shprehja në fjalë nënkuptonte heqjen dorë nga

një pozitë e veçantë që kishe për një pozitë më të ulët.


Megjithëse dëshironte të kthehej në Stamboll, Xhevdet pashës i vjen shkresa nga sadrazam Ali pashës, i cili i kërkonte që të qëndronte në Shkodër për të kryer disa shërbime, një prej të cilëve kishte të bënte edhe me gjetjen e gjuhës së përbashkët mes' të krishterëve e myslimanëve. Xhevdet pasha e lexon i habitur këtë shkresë dhe pastaj i shkruan sulltanit: "Sa për gjetjen e gjuhës së përbashkët mes të krishterëve dhe myslimanëve, dijeni se shumica e të krishterëve në Shkodër janë katolikë dhe dashuria e uniteti mes tyre dhe myslimanëve është në shkallë të paparë në krahasim me ndonjë vend tjetër. Ata përsëriten me njëri-tjetrin miqësisht. Katolikët shkojnë në beteja pas bajraktarëve myslimanë, ashtu sikundër edhe myslimanët shkojnë pas bajraktarëve katolikë. Në luftë sillen si një trup i vetëm. Të vrarët në betejë i respektojnë duke i qujtur të gjithë dëshmorë (shehid). Në fshatrat e përziera, katolikët kontribuojnë në pagën mujore të hoxhallarëve, ashtu si edhe myslimanët kontribuojnë në pagën e priftërinjve... Porta e Lartë më tërheq vëmendjen dhe më urdhëron që të gjej gjuhën e përbashkët mes të krishterëve dhe myslimanëve, ngaqë nuk ka dijeni dhe nuk e njeh mirë situatën e popullit të këtushëm."

Mes të tjerash, Xhevdet pasha inspekton edhe shkollën ruzhdije, duke përmendur faktin që ka emëruar një nxënës të nivelit të parë në detyrën e mësuesit të dytë, si dhe flet rreth inspektorit të arsimit Davud efendi Borçit, në bashkëveprim me të cilin hartojnë planin për ngritjen e xhamive dhe të shkollave fillore nëpër fshatrat e malësive me popullsi myslimane.

Sa për nxënësin në fjalë, ai është Kraja, siç na bën të ditur Hamdi Bushati në monografinë e tij "Shkodra dhe Motet", i cili i kishte rënë në sy Xhevdet pashës për aftësitë e tij në bukurshkrim. Kur ishte në moshë të thyer, ky person zbukuroi me shkrime kaligrafike mjedisin e brendshëm të xhamisë së Parrucës.

*"Shqipëria, do të shkruante Xhevdet pasha, është sedd-i sedid për Rumelinë, ndërsa sanxhaku i Shkodrës është origjina dhe kyçi i Gegërisë që përbën një pjesë të madhe të Shqipërisë."*

Gjatë qëndrimit në Shkodër, Xhevdet pasha përgatiti një hartë për sanxhakun e Shkodrës, si dhe disa raporte rreth situatës gjeografike të këtij sanxhaku dhe kufirit



me Malin e Zi, të cilat pastaj ia paraqiti Portës së Lartë.

Në raportin drejtuar padishahut, Xhevdet pasha na paraqet shifra të përafërta, sepse, siç shkruan ai, ende nuk është bërë një numërim i prerë në lidhje me numrin e banesave (haneve) që ka çdo kaza e sanxhakut të Shkodrës, pra Shkodra, Tivari, Shpuzi, Podgorica, Gucia dhe Plava, Lezha, Ulqini, Dukagjini. Sipas përllogaritjeve të tij, në sanxhakun e Shkodrës ndodheshin 16'650 hane shqiptarësh (totali përllogaritej të ishte 23'266 hane), nga të cilët mund të organizohej një forcë ushtarake prej 35'250 meshkujsh të aftë për t'u thirrur nën armë, të cilët ishin të njohur si ushtarë të vërtetë për të mbrojtur vendet e tyre.

Ai shkruan edhe rreth tyrbes së Bali Babait që ndodhet pranë kalasë së Zhabjakut, nga e cila ka marrë emrin Balije zona përreth. Në vitin 1861 malazezët e sulmuan këtë vend, duke djegur edhe ato pesë banesa që gjendeshin aty.

Lagjja më e populluar në atë kohë ishte ajo e Terzihanes, që ndodhej pranë liqenit.

*Ulqini është fillimi i Shqipërisë për nga vija detare,* - shkruan Xhevdet pasha. Sipas tij, ulqinakët janë njerëzit më të butë, sepse në dallim me banorët e malësive, ata merren me peshkim dhe tregti. Numri i anijeve tregtare që ata kanë, kap shifrën 80, por në stinët e dimrit ata i lidhin anijet e tyre në Shëngjin, sepse në këtë periudhë të vitit është e vështirë të ankorosh anije në Ulqin.

Xhevdet pasha flet edhe për emigrimin e banorëve të malësive, veçanërisht "në kohën e të mirënjohurit Skënderbe". Me këtë rast ai përmend faktin se, mbështetur në fermanin e datës 840 H (1436) kadiu i Zadrimës që varej nga Dukagjini, Hasan efendiu u caktoi banorëve të Mirditës hapësirën mes Fandit të madhe dhe të vogël, duke i pajisur edhe me aktin juridik hyxhet. Gjetja e këtij hyxheti përbën dokumentin më të vjetër të hartuar nga një zyrë kadiu në trevat shqiptare.

Teksa shkruan për bajraqet, ai regjistron faktin se "bajraqet kanë një rregull të brendshëm të mirënjohur, për të cilin ata thonë se ka origjinë shumë të moçme."

Bib Dod pasha pretendonte se rridhte nga gjaku i Skënderbeut dhe për këtë kërkonte nga murgjërit që t'ia dokumentonin. Pasi kjo arriti të argumentohej, ai pretendoi se rridhte nga gjaku i Lek Dukagjinit, madje pati bërë edhe një vulë personale me mbishkrimin Dukagjini, me të cilën vuloste shkresat personale. Por mbarë Shqipëria e di që ai nuk ka lidhje gjaku as me njërin, as me tjetrin.

Raporti i Xhevdet pashës është vetëm një nga buri- met e shkruara në gjuhën osmane, që hedhin dritë mbi jetën politike, ekonomike, kulturore dhe fetare të trevave shqiptare gjatë sundimit osman. Studimi i tyre ka shumë gjëra për t'i ofruar historisë në lidhje me shoqërinë dhe popullin shqiptar.




## Luanesha mëmë

*N*ë kushte normale, ndjenja e dhembshurisë nuk e lejon një nënë as të nervozohet e as të hidhërohet me fëmijët e saj. Kjo ndjenjë madhështore që nuk vërehet vetëm tek njerëzit, por edhe tek kafshët, është sigurisht një reflektim i Fuqisë Hyjnore. Sipas një vrojtimi të realizuar me kamera në një nga parqet natyrore në Kenia, u vu re një ngjarje e çuditshme.

Mes datës 21 dhjetor 2001 dhe 2 janar 2002 në rrethana ende të panjohura, një luaneshë mëmë dhe një këlysh drenushe shihen të qëndrojnë në shoqërinë e njëra tjetrës, në një lidhje miqësore të pashpjegueshme. Në vëzhgimin e parë me kamera, vihet re se drenusha është ende e pafuqishme për të qëndruar në këmbët e saj. Duket sikur luanesha mëmë e ka kuptuar vetminë e këtij këlyshi të pambrojtur dhe e ka "birësuar" pa u menduar gjatë. Nga ana tjetër, as drenusha e vogël nuk i ndahet nënës jo-natyrore. Edhe pse nuk mund të ushqehet me qumështin e saj, ajo mundohet të qëmtojë ca gjethe

në tokë e të ushqehet me to. Kur luanesha mëmë shikon drenushën e vogël të ushqehet me gjethe, e kupton fare mirë që ajo nuk është prej familjes së saj, por tashmë ajo i ka shtrirë krahët e mëshirës ndaj një "vogëlushi" të braktisur e të pambrojtur.

Papritmas, në skenë shfaqet drenusha mëmë, e cila kishte kohë që po kërkonte të voglin e saj. Kur sheh se i vogli po qëndronte pranë luaneshës habitet, tërhiqet dhe vështron. Nuk mund të largohet prej aty, prandaj fillon t'i dërgojë sinjale drenushës së vogël përmes disa zhurmave të çuditshme. Dhe kështu, më në fund, nëna me të voglin afrohen, përqafohen dhe çmallen me njëri tjetrin, por e gjithë kjo ndodh nën "kontrollin" e luaneshës-mëmë, e cila tashmë i kish dalë për zot drenushës së vogël, arsye për të cilën e kishte shumë të vështirë të ndahej prej saj. Edhe pse nuk nxjerr zë kur drenusha-mëmë i afrohet të voglit, ajo prapëseprapë nuk lejon që ajo ta marrë me vete



këlyshin. Tashmë drenusha e vogël është bërë pjesë e luaneshës mëmë, e cila mundohet ta lehtëtojë e të luajë me të sikur të ishte pjella e saj.

Por, pas disa kohësh, luanesha-mëmë e kupton se tashmë ka ardhur koha që ato të ndahen, sepse nëna kupton nënën...

Para së të ndahen përfundimisht, ajo i afrohet, i merr erë, i fërkon lëkurën me lëkurën e saj dhe ikën...

Drenusha-mëmë dhe drenusha e vogël largohen të lumtura, bashkë me ëndrrën për të mos u ndarë kurrë më, por ato nuk mund t'u shpëtojnë syve të mprehtë të luanit, i cili pa humbur kohë vërsulet mbi "gjahu e pambrojtur". Kur luanesha-mëmë sheh këtë skenë hidhërohet tej mase. Ajo i merr erë gjakut në vendin ku drenusha e vogël nuk pati mundur t'u shpëtonte syve të luanit dhe në sytë e saj shihen lot.

Kjo ngjarje e pazakonshme e vëzhguar

nga kamerat e parkut natyror, sigurisht që bart me vete mesazhe të thella. Dhembshuria e nënës, kjo ndjenjë e lindur njëherësh me të, u mundësoi dy specieve të kundërta të lidheshin bashkë me një dashuri të pashpjeguar. Kjo nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një argument i Krijuesit Hyjnor, një mrekulli e reflektuar në dhembshurinë e nënës.

Nëna nuk mund të jetë e tillë vetëm nga tiparet fizike, por mbi të gjitha nga ato shpirtërore. Nëse një nënë do t'i humbishte këto tipare të brendshme, ajo nuk do ishte më një përmendore dhembshurie, por një gjahtarë e pamëshirshme që do t'i shkatërronte fëmijët e saj. Për këtë arsye, pa humbur për asnjë çast ndjenjën e të qenit nënë, të gjitha gratë duhet të dinë të lartësohen mbi krijesat e tjera. Duhet të dinë t'i edukojnë fëmijët e tyre përmes edukatës fetare, në mënyrë që ata të jenë nga të shpëtuarit në Ditën e Gjykimit.





## Fara e zezë dhe dobitë e saj (Nigella Sativa)

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thotë: I Dërguari i Allahut, Muhamedi (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) ka thënë: "Përdoreni rregullisht këtë farë të zezë, (Habbetus Seuda) sepse ajo përmban në vete ilaç për çdo sëmundje, përveç vdekjes". (Transmeton imam Ahmedi, Tirmidhiu, En Nesaiu, Ibni Maxhe, Imam Albani thotë hadithi është i vërtetë). Gjithashtu, Ebu Hurejra transmeton se i dërguari i Allahut ka thënë për farën e zezë: "Në Farën e Zezë ka shërim për çdo sëmundje, përveç vdekjes." (Transmeton Buhariu në kapitullin e mjekësisë, Muslimi në kapitullin e selamit.)

Fara e Zezë përmban vaj acidik të pangopur, vaj me eter, vitamina dhe një sërë substancash të tjera të domosdoshme për organizmin. Tashmë është vërtetuar se vaji acidik i pangopur që gjendet te Fara e Zezë ndikon pozitivisht mbi metabolizmin e trupit, rrit imunitetin dhe ndalon alergjinë. Fara përmban përafërsisht 38% karbohidrate, 35% vajra të ndryshëm, 21% albuminë, ndërsa pjesa tjetër përbëhet prej më shumë se njëqind substanca të ndryshme. Për t'u përmendur janë: vajrat acidike të pangopura, acidi Linolein, acidi alfa-Linolein, vajrat me eter (nigellon, alfa-pinen etj.), vitaminat (B1, B2, B6, Acidi Folik, Niacina), mineralet (hekur, kalcium, magnez, zink, etj.) dhe aminoacidet.

*Veçoritë e vajrave acidikë të pangopur:*

- Ndhimjnë metabolizmin e trupit.
- Shërbejnë për rritjen, zhvillimin dhe përtëritjen e qelizave.
- Ndhimjnë në zhvillimin e hormoneve dhe në formimin e një sistemi nervor dhe hormonal-mbrojtës të shëndetshëm.
- Pengojnë shtimin e substancave që dërgojnë sinjale alergjike.
- Pengojnë qelizat mbrojtëse (imunitare) të punojnë më shumë se ç'duhet.
- Kthejnë në nivele normale kolesterolin në gjak.
- Pengojnë bllokimin e damarëve, duke rregulluar strukturën e tyre, por njëkohësisht ndikojnë në shpejtësinë e qarkullimit të gjakut.
- Ulin tensionin dhe reduktojnë rrezikun e ashpërsimit të damarëve e të infarktit në zemër
- Ndhimjnë në përmirësimin e shpejtë të plagëve.
- Trupi i njeriut nuk i prodhon këto vajra, kështu që është



i detyruar t'i marrë nga jashtë, 1gram nga vaji i Farës së Zezë është i mjaftueshëm për nevojat ditore.

Vajrat me eter si Nigellon dhe alfa-Pinen zgjerojnë rrugët e frymëmarrjes, lehtësojnë kollitjen, pengojnë qelbëzimin dhe ndalojnë dhimbjen. Nëse përdoren rregullisht, ato ulin sheqerin në gjak. Vitaminat B1, B2 dhe B6 luajnë rol në prodhimin e enzimave dhe forcojnë sistemin mbrojtës. Acidi Folik redukton rrezikun e tensionit dhe të sëmundjeve të zemrës, por gjithashtu është i nevojshëm edhe për përtëritjen e qelizave. Antioksidantët si vitaminat A, E, C dhe Beta-Karetin forcojnë sistemin mbrojtës të trupit.

Përveç efektit që jep në sistemin imunitar, në metabolizmin dhe në zhvillimin e hormoneve, Fara e Zezë pastron njëkohësisht trupin nga substancat e dëmshme të quajtura Toxin, përforcon qarkullimin e gjakut, ndihmon në funksionin e zorrëve dhe rrit shkëlqimin e flokëve e të lëkurës. Ul tensionin e temperaturën dhe kryen funksionin e antibiotikëve. Është mjaft efektiv ndaj sëmundjeve alergjike si Astma dhe alergjia ndaj polenit. Për efektin që ka në sistemin imunitar, përdorimi i saj është i këshillueshëm edhe në sëmundje si AIDS, kanceri etj.

Me gjithë këto të mira që përmban, është e vështirë që Fara e Zezë të qëndrojë jashtë vëmendjes së botës perëndimore. Vitet e fundit, në Europë dhe në SHBA vërehet të ketë kërkesë për këtë farë, ndërsa në farmacitë gjermane Fara e Zezë është e pranishme tashmë në formën e saj origjinale si farë, vaj ose tabletë.

## Roboti ndihmës infermier



Shkencëtarët japonezë kanë shpikur një robot ndihmës-infermier, të quajtur ndryshe edhe “Actroid-F”, me qëllim që ai të dialogojë me të sëmurët dhe t’i qetësojë ata.

Roboti Actroid-F të cilit i është dhënë pamja e një infermiereje femër, do të përdoret nëpër spitale për t’i

dhënë moral pacientëve të vetmuar. Actroid-F, i cili është prodhuar në Institutin e Industrisë së avancuar dhe Teknologjisë në Tokio, i ngjan një vajze japoneze rreth të njëzetave.

Roboti i cili me shikimin, mimikën dhe shprehjen e fytyrës i ngjan një njeriu të vërtetë, në sajë të një kamere të veçantë është i aftë të kuptojë dhe t’i përgjigjet fjalëve të njeriut që ka përballë. Me veçoritë e tij të mahnitshme, ky robot mund të tundë kokën, të marrë frymë, të buzëqeshë, të përshëndesë, të lëvizë vetullat e buzët.

Përkundër komenteve të disa mediave japoneze që u shprehën se roboti duket i “frikshëm dhe shqetësues”, ekspertët e Institutit deklaruan se ky robot, i cili është 1.4 metra në gjendje të ulur, mund të përdoret jo vetëm në spitale, por edhe në azilet e pleqve e në shkolla.

## Telefoni celular më rezistent në botë

“JCB Toughphone Sitemaster” duket se ka fituar titullin si telefoni celular më rezistent në botë. Por a është vërtetë kështu?

Sipas një lajmi të Daily Mail, ky telefon mund të qëndrojë rreth 8 orë nën ujë, mund të durojë të nxehtin deri në 75 gradë dhe të ftohtin deri në minus 30 gradë. Ai mund të punojë pavarësisht goditjeve dhe shtypjeve të tepërta që mund të marrë.

Megjithëse pikësnyimi i JCB Toughphone janë punëtorët e ndërtimit, bujqit, fermerët dhe njerëz të tjerë që punojnë jashtë e në kushte të vështira, kjo nuk do të thotë se veçoritë e tij nuk janë të mira. Telefoni mund të luajë muzikë e video, ka radio FM dhe Bluetooth.

Tani le të shohim testet që ka kaluar me sukses ky telefon:

1. Edhe pse mund të jetë në fund të një pishine, cilësia e zërit është e mirë dhe bën të mundur një bisedë të gjatë edhe nën ujë.
2. Ai punon edhe pas 10 minutave banjë me avull.
3. Megjithëse zëri vjen pak i mbytur, ai arrin të rezistojë



edhe në saunë.

4. Edhe pse mbi të mund të kalojë 4-5 herë një automjet 1.6 tonësh, përveç një gërvishtjeje të vogël telefonit nuk i ndodh asgjë.

5. Edhe nëse e hedhim prej një lartësie rreth 8 metra, telefoni nuk thyhet.

6. Ai punon normalisht edhe pas një qëndrimi dy orësh në pjesën ngrirëse të frigoriferit.

7. Ndonëse arriti t’u rezistonte gjithë këtyre torturave, ky telefon u dorëzua kur u hodh në lavatriçe. Ç’të bënte? Pas gjithë këtyre torturave edhe ai do të zbutej më në fund.

## Zgjedhjet e para në Kosovën e pavarur

Prishtinë 12 dhjetor 2010. Në shtetin më të ri të Ballkanit, në Kosovë u zhvilluan zgjedhjet e para pas pavarësisë që fitoi në vitin 2008. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte rreth 47,80%, pra 779.400 votues. Megjithëse disa prej partive pjesëmarrëse kanë paraqitur ankesa për procesin e zgjedhjeve, BE dhe EULEX i kanë cilësuar zgjedhjet si të kënaqshme dhe me standard të mirë. Pjesëmarrja më e lartë u vu re në kryeqytetin Prishtinë me 55,2%, në Prizren me 44,33%, në Deçan me 43,43%, në Gjakovë me 40,30%. Ndërsa sa i përket pakicave serbe, ka pasur një bojkot të dukshëm nga ana e tyre. Zgjedhjet e para në Kosovën e pavarur përfunduan me një garë të ngushtë mes dy partive në pushtet, që e shpallën shkëputjen nga Serbia. Partia Demokratike e Kosovës e cila në qeverinë e mëparshme ishte partnere e pushtetit, mori 34% të votave.



Ajo ndiqet prej Lidhjes Demokratike të Kosovës me 26% dhe Vetëvendosja me 13% të votave.

## Pa viza në Evropë



Ëndrra e vjetër e shqiptarëve për një udhëtim të lirë drejt Evropës tashmë u realizua. Kështu që, prej orës 00:01 të 15 dhjetorit, hyri në fuqi vendimi i shumëpritur për heqjen e vizave.

Tashmë të gjithë shqiptarë që posedojnë një pasportë biometrike, sigurim shëndetësor dhe eko-

nomik, vendqëndrim dhe bileta kthimi, mund të shkojnë ku të duan në një nga 27 vendet Evropiane që ndodhen në zonën Shengen. Konkretisht: Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Gjermani, Holandë, Hungari, Islandë, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Norvegji, Poloni, Portugali, Qipro, Çeki, Rumani, Sllovakia, Spanjë, Suedi dhe Zvicër. Vetëm në dy prej vendeve të BE-së, si Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk janë të përfshira në marrëveshjen Shengen, prandaj për të shkuar në këto vende duhet pajisja me vizë.

Ashtu sikurse është thënë edhe më parë, qëndrimi në secilën prej vendeve të mësipërme mund të zgjasë deri në tre muaj. Pas këtij afati çdo kush që shkel rregullin mund të dëbohet nga vendi ku ndodhet e për pasojë mund t'i humbasë e drejta për të udhëtuar në të gjitha vendet për 5 vite ose mund të gjobiteni deri në tre mijë euro. Përveç afatit 90 ditor, çdo shtetas nuk mund të kërkojë punë, nuk mund të studiojë, nuk duhet të shkaktojë probleme për sigurinë publike, nuk duhet të kërkojë strehim, etj.

